602	Mallra dhe sherbime te tjer	1,905	4,827			820	679	-2,431	
603	Subvencione								
604	Transferta korrente te brendshme								
605	Transferta korrente te huaja								
606	Trans per buxh, fam & individ							0	
609									
651									
166									
Nentotali	Shpenzime korrente								
230	Kapitale te patrupzuara								
231	Kapitale te trupazuara								
232	Transferta kapitale								
Nentotali	Shpenzime kapitale me financim te brendshem								
230	Kapitale te patrupzuara								
231	Kapitale te trupazuara	70	862					0	
232	Transferta kapitale								
Nentotali	Shpenzime kapitale me financim te huaj								
Totali	Shpenzime kapitale								
	Totali (korrente+ kapitale)	9,907	36,921	938	1,758	19,488	13,685	-5,803	
Drejtuesi i Ekipit	Emri	Kryetari I Njesisë Vetëqeverisjes Vendore		Emri					
Menaxhues i Programit	Firma			Firma					
	Data			Data					

Treguesit e realizimit të Buxhetit të Shtetit (Fonde të Kushtëzuara)

Kop.	EMERTIMI	TOTALI			600			601			602			604		606		231		
		Plan	Limit	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	
1170	Qëndrues Civilie	17,440,000	13,266,000	11,405,236	14,944,000	13,266,000	9,771,629	2,496,000	1,633,607											
1170	Shpenzimet tjera	0	0	0																
10430	Investimet	518,282,000	566,829,724	406,268,312							566,829,724				518,282,000	406,268,312				
10430		0	0	0																
10430	Bëhima ekonomike	44,576,000	0	32,439,684											44,576,000	32,439,684				
10430	Dendra e shëndetit	3,971,724	0	1,800,274											3,971,724	1,800,274				
9240	Arsimi profesional	0	0	0																
4130	U.K.E.	0	0	0																
9240	Burrat	10,337,880	10,337,880	9,995,343																
9130	Arsimi 9 vjeçar	78,699,501	36,659,001	7,119,500						1,321,000	10,337,880	1,201,983						71,580,001	26,777,001	
9230	Arsimi i mesëm	2,762,500	0	2,762,100						7,119,500	9,882,000	7,119,500								
6180	Shpenzimet	0	0	0						2,762,500	2,762,100									
6170	Investime	225,228,390	225,228,390	21,392,230														225,228,390	21,392,230	
6250	Zhvillimi	0	0	0																
6220	Fshir	0	0	0																
6220	Fshir	0	0	0																
910		27,421,667	27,421,667	5,890,206																
6190	Mirëbajtje	9,870,340	9,870,340	0						27,421,667	27,421,667	5,890,206								
4240	Ujta dhe kulturi	31,863,735	0	0														31,863,735	0	
1620	Zgjedhjet	0	0	0																
4520	Shpenzimet	0	0	0																
6180	Shpenzimet	0	0	0																
	TOTALI	970,453,737	889,613,000	499,072,885	14,944,000	13,266,000	9,771,629	2,496,000	1,633,607	11,203,000	604,133,391	11,083,583	27,421,667	5,890,206	575,846,604	446,301,630	235,098,730	235,098,730	21,392,230	

Kop.	EMERTIMI	TOTALI			600			601			602			604		606		231		
		Plan	Limit	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Limit	Fakt	
10430	Investimet	518,282,000	566,829,724	406,268,312							566,829,724				518,282,000	406,268,312				
10430	Bëhima ekonomike	44,576,000	0	32,439,684											44,576,000	32,439,684				
10430	Dendra e shëndetit	3,971,724	0	1,800,274											3,971,724	1,800,274				
9240	Arsimi profesional	0	0	0																
4130	U.K.E.	0	0	0																
9240	Burrat	10,337,880	10,337,880	9,995,343																
9130	Arsimi 9 vjeçar	78,699,501	36,659,001	7,119,500						1,321,000	10,337,880	1,201,983						71,580,001	26,777,001	
9230	Arsimi i mesëm	2,762,500	0	2,762,100						7,119,500	9,882,000	7,119,500								
6180	Shpenzimet	0	0	0						2,762,500	2,762,100									
6170	Investime	225,228,390	225,228,390	21,392,230														225,228,390	21,392,230	
6250	Zhvillimi	0	0	0																
6220	Fshir	0	0	0																
6220	Fshir	0	0	0																
910		27,421,667	27,421,667	5,890,206																
6190	Mirëbajtje	9,870,340	9,870,340	0						27,421,667	27,421,667	5,890,206								
4240	Ujta dhe kulturi	31,863,735	0	0														31,863,735	0	
1620	Zgjedhjet	0	0	0																
4520	Shpenzimet	0	0	0																
6180	Shpenzimet	0	0	0																
	TOTALI	1,000,883,737	889,613,000	528,450,407	14,944,000	13,266,000	9,771,629	2,496,000	1,633,607	11,203,000	604,133,391	11,083,583	27,421,667	5,890,206	575,846,604	446,301,630	235,098,730	235,098,730	21,392,230	

Realizimi total i buxhetit të shtetit gjatë periudhës janar-gusht 2024 siç paraqitet dhe në pasqyrën e mësipërme është 52.4%.nga të cilat:

Fondi i pagave rezultojnë 76.5%

Fondi i sigurimeve shoqërore rezultojnë 77.2%

Fondi i shpenzimeve operative rezultojnë 81.1%

Fondi i ndihmave dhe përkrahjeve rezultojnë 78%

Fondi i transfertave 78%

Fondi i investimeve rezultojnë 9 %

Drejtoria E Burimeve Njerëzore

Me VKB nr. 92, datë 24.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara – 2024” me ndryshime, është miratuar numri i punonjësve i cili është:

Në administratën e Bashkisë Vlorë – 406 pozicione, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike - 396 pozicione, në Qendrën Kulturorë - 28 pozicione, në Teatrin Petro Marko - 30 pozicione, në Klubin Shumësportësh “Flamurtari” - 18 pozicione, në Qendrën e Zhvillimit PAK - 22 pozicione, në Ndermarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane - 39 pozicione, në Qendrën e Shërbimeve me Baze Komunitare për Femijet me Aftësi të Kufizuara - 11 pozicione.

Pjesë e kësaj strukture janë edhe funksionet të transferuara në Bashkinë Vlorë pas Reformës Territoriale: Arsimi parashkollor / punonjësit jomësor (sistemi 9 vjeçar) - 355 punonjës,

Arsimi i mesëm punonjes jomesimor - 51 punonjes, Sektori Bordit të Kullimit - 17 punonjës, Sektori e Pyjeve dhe Kullotave - 6 punonjës, Sektori e Rrugëve rurale - 5 punonjës, Sektori i MNZSH - 50 punonjës.

Me VKB nr. 26, datë 28.03.2024 “Për një ndryshim në VKB nr. 92, datë 24.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2024” janë bërë ndryshime me qëllim ristrukturimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Bazuar në nenin 64, pika j, të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, me vendim të Kryetarit të Bashkisë janë miratuar 3 Struktura për vitin 2024:

Vendim Nr. 1, datë 30.01.2024 i Kryetarit të Bashkisë Vlore “Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve vartëse dhe funksioneve të deleguara – 2024”,

Vendimi Nr. 42, datë 18.04.2024 “Për disa ndryshime në Strukturën organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve vartëse dhe funksioneve të deleguara – 2024”.

Vendimi Nr. 133, datë 09.09.2024 “Për disa ndryshime në Strukturën organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve vartëse dhe funksioneve të deleguara – 2024”.

Në këto struktura ka pozicione të Shërbimit Civil, ndihmës/mbështetës dhe funksionarë politik.

Bazuar në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” për periudhën 01.01.2024 – 30.08.2024 janë shpallur 17 procedura konkurimi për pozicione të Shërbimit Civil të cilat kanë përfunduar me fitues dhe disa prej tyre janë ende në procedurë. Në përfundim të procedurave janë kryer 21 emërimë si nëpunës civil me procedura konkurimi sipas Ligjit të Shërbimit Civil, prej të cilëve 16 emërimë në pozicione të kategorisë ekzekutive, 2 emërimë në pozicione të kategorisë së ulët drejtuese, 1 pozicion i kategorisë së mesme drejtuese dhe 2 emërimë në pozicione në nivelin e lartë drejtues.

➤ **Sektori I Arsimit, Rinisë Dhe Sportit**

Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit funksionon në bazë të Ligjit nr. 69/2012 i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, V.K.M. nr.666, dt 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, VKM 511 dt. 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa të VKM 666”, Udhëzimit nr. 26, dt 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, VKB-ës nr.97, dt 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligjit nr.9863, dt 28.01.2008 “Për ushqimin”, Udhëzimit, nr.22, dt 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligjit nr.74/2013, dt 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin

nr. 9863, dt 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, Ligjit nr.79/2017 “Për Sportin” (i ndryshuar) me ligjin 105/2020 dt.29.07.2020, Ligji nr.79/2019 dt 04.11.2019 “Për Rininë”.

-Bazuar në VKB-në nr.97, datë 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë” janë kryer kontrole të paplanifikuara në kopshtet dhe çerdhet në territorin e Bashkisë Vlorë për zbatimin e orarit të punës, menaxhimin, kujdesin ndaj fëmijës.

- Staf për organizimin dhe mbarëvajtjen e çdo evenimenti të “Vlora, Qyteti European I Sportit 2024”.

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligjin nr.9863, dt 28.1.2008 “Për ushqimin”, Udhëzim, nr.22, dt 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligjin nr.74/2013, dt 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, dt 28.01.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar janë kryer ndryshime në dokumentacionin mbi të cilin bazohet procesi i monitorimit të kopshteve në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë Administrative për zbatimin e kritereve të ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit arsimor parashkollor, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Ngritja e një grupi pune brenda sektorit për analizën e situatës në kopshtet e Bashkisë Vlorë.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm nr.4 dt 10.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit edukativ individual për fëmijët me aftësi të kufizuar”, komisioni ka përditësuar planin PEI për 44 fëmijë me aftësi të kufizuar në kopshtet e bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me mësueset mbështetëse (përditësimi çdo 3 muaj).

- Pjesë e grupit të punës në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë–Himarë dhe finalizimi i veprimtarisë së festës së mësuesit. U nderuan 38 mësues me titullin “Mirënjohje e Qytetit”.

- Pjesë e grupit oranzues të aktivitetit “Dita e Verës”.

-Është zhvilluar procesi i mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bonusit financiar të nxënësve ekselentë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme që aplikojnë në Bashkinë Vlorë. Janë trajtuar për vitin shk. 2023-2024 me bonus financiar 134 nxënës në shkollat 9- vjeçare publike dhe 128 nxënës në shkollat e mesme të përgjithshme publike.

-Pjesëmarrje në grupin e punës me Urdhër të Brendshëm nr 285 dt 22.08.2023 “Mbi ngritjen e grupit te punës per inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të Sektorit te Prokurimeve”

-Mbledhje, përpunim dhe sendërzim të të dhënave mbi problematikat infrastrukturore dhe bazë materiale në IA-të dhe çerdhet e bashkisë Vlorë

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKB-ës nr.97, dt. 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, ndiqet procesi i regjistrimit të vazhdueshëm në kopshte dhe çerdhe, si dhe adresimi i problematikave.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm Nr.450, dt. 11.12.2023 “Për një ndryshim në Urdhërin nr.3 dt 07.01.2020 mbi ngritjen e komisionit për kolaudimin e mallrave ushqimorë, industriale dhe elektrike” është kryer kontroll ditor i ushqimit për çerdhet, kopshtet pranë magazinës së Qendrës Ekonomike.

-Pjesë e grupit “Për ngritjen të punës, për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit të tenderit Blerje- Ushqimore” në bazë të Urdhërit të brendshëm nr.48, dt. 22.02.2024

- Kthim përgjigje institucioneve të ndryshme.

-Pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete të ndryshme që organizojnë drejtori të tjera të bashkisë Vlorë.

-Trajnime dhe aktivitete për rritjen e kapacitetit të KVR-s.

- Ngritja e një database mbi situatën e të rinjve në territorin e bashkisë Vlorë.

- Ngritja e një database “Të rinjtë dhe sporti” në territorin e bashkisë Vlorë.

-Përditësim të dokumentacionit për kryerjen e procesit të monitorimit në kopshtet e bashkisë Vlorë në bazë të Urdhërit nr. 199 dt. 07.05.2024 " Për miratimin e kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit" dhe "Udhëzuesit metodologjik për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit” nga MAS

-Projekti “Thuaja Kenges Rini” në bashkëpunim me Ministrinë për Rininë dhe Fëmijët, Fondacionit Qendra Evropiane dhe AKR .

- Kryerjen e procedurave për aplikim, regjistrim të qytetarëve të cilët aplikojnë për fëmijët e tyre për herë të parë në kopshtet dhe çerdhet e bashkisë Vlorë si dhe për transferim nga një institucion në tjetrin

➤ **Procedura e aplikimit për regjistrimin në çerdhe**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall njoftimin për fillimin e aplikimeve për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe së bashku me dokumentacionin përkatës. Aktualisht aplikimi për t’u regjistruar në çerdhe do të kryhet brenda afateve të përcaktuara nga institucioni. Aplikimi do të kryhet vetëm për fëmijët të cilët nuk kanë frekuentuar më parë çerdhet publike të Bashkisë Vlorë. Dosjet e aplikantëve do të shqyrtohen nga SARS.

Dokumentet që duhet të dorëzohen në momentin e aplikimit në çerdhet e Bashkisë Vlorë

Procedura e regjistrimit në çerdhe:

- a. Prindërit dorëzojnë dokumentet për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe. Afati i dorëzimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve është 8 korrik- 31 gusht;
- b. Çerdhja merr dokumentet e dorëzuara nga prindërit për çdo fëmijë dhe ia dërgon Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (SARS). Dokumentet për çdo fëmijë mund të dërgohen nga çerdhja deri në 2 ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit;
- c. Sektori Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (SARS) merr vendimin bazuar në dokumentet e secilit prej fëmijëve dhe listën që disponon me fëmijët në moshë çerdheje dhe i dërgon

kësaj të fundit listën e fëmijëve të regjistruar dhe listën e fëmijëve që nuk u është pranuar aplikimi së bashku me arsyet. Afati për marrjen e vendimit është deri në 6 shtator.

- d. Në rastin kur një aplikim për regjistrim refuzohet, prindërit njoftohen nga përgjegjësja e çerdhes mbi arsyet pse është refuzuar aplikimi dhe i sugjeron çerdhen në të cilën fëmijës i takon të regjistrohet;
- e. Pasi regjistrimet përfundojnë sipas udhëzimeve të SARS-it përgjegjëset e çerdheve mund të takojnë prindërit të cilët nuk kanë regjistruar ende fëmijët, për të identifikuar arsyet e mos regjistrimit dhe informuar prindërit mbi rëndësin e regjistrimit nëpër çerdhet e Bashkisë Vlorë.

Për çerdhet nuk zbatohet rajonizimi.

Procedura e transferimit të çerdhes

Për të kryer transferimin e çerdhes qytetari paraqitet fizikisht në institucion dhe plotëson një kërkesë për transferim të çerdhes. Kërkesës për transferim i bashkëngjitet vërtetimi, i cili lëshohet nga Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe nënshkruhet nga Përgjegjësja e Çerdhes dhe Përgjegjësja e Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

Procedura e aplikimit për regjistrimin në kopshte

Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall njoftimin për fillimin e aplikimeve për regjistrimin e fëmijëve në kopshte së bashku me dokumentacionin përkatës. Aktualisht aplikimi kryhet pranë kopshteve brenda afateve të përcaktuara nga institucioni. Aplikimi do të kryhet vetëm për fëmijët të cilët nuk kanë frekuentuar më parë kopshtet publike të Bashkisë Vlorë

Procedura e regjistrimit në kopsht:

1. Prindërit përpos dokumentave që dorëzojnë për regjistrimin e fëmijëve në kopsht, duhet të dorëzojnë dhe vërtetimin e vendbanimit. Fëmijët të cilët aplikojnë për herë të parë duhet të regjistrohen sipas zonës së banimit për kopshtet pa drekë nuk zbatohet rajonizimi. Afati i dorëzimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve është 9 korrik – 31 gusht;
2. Kopshti merr dokumentet e dorëzuara nga prindërit për çdo fëmijë dhe ia dërgon Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Dokumentet për çdo fëmijë mund të dërgohen nga kopshti deri në 2 ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit;
3. Sektori I Arsimit, Rinisë dhe Sportit merr vendimin bazuar në dokumentet e secilit prej fëmijëve dhe listën që disponon me fëmijët në moshë kopshti dhe i dërgon kopshteve listën e fëmijëve të regjistruar dhe listën e fëmijëve që nuk u është pranuar aplikimi së bashku me arsyet. Afati për marrjen e vendimit është deri në 6 shtator.
4. Në rastin kur një aplikim për regjistrim refuzohet, prindërit njoftohen nga drejtuesi i kopshtit mbi arsyet pse është refuzuar aplikimi dhe i sugjeron kopshtin në të cilin fëmijës i takon të regjistrohet;
5. Pasi regjistrimet përfundojnë, sipas udhëzimeve të SARS, drejtuesit/mësuesit e kopshteve mund të takojnë prindërit të cilët nuk kanë regjistruar ende fëmijët, për të

identifikuar arsyet e mos regjistrimit dhe informuar prindërit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmija.

Për kopshtet me drekë nuk zbatohet rajonizimi.

Procedura e transferimit të kopshtit

Për të kryer transferimin e kopshtit, qytetari paraqitet fizikisht në institucion dhe plotëson një kërkesë për transferim të kopshtit. Kërkesës për transferim i bashkëngjitet vërtetimi, i cili nënshkruhet nga Drejtuesi i Kopshtit dhe Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit .

- Komision i inventarit fizik të shkollave 9-vjeçare në bazë të Urdhërit të brendshëm nr. 131 datë 02.05.2024 **“Për Ngritjen e Komisionit për Inventarizimin dhe Vlerësimin e Aktiveve Afatgjata dhe Inventarit në Përdorim për Vitin 2023”**

- Anëtar i komisionit të inventarit fizik të shkollave të mesme dhe konviktit të shkollës Industriale në bazë të Urdhërit të brendshëm nr.201 datë 07.06.2024 **“Për Ngritjen e Komisionit për Inventarizimin dhe Vlerësimin e Aktiveve Afatgjata dhe Inventarit në Përdorim për Vitin 2023”**

-Pjesë e komisionit për ndjekjen e procedurave të përzgjedhjes së subjekteve fizikë/juridikë që do të zhvillojnë aktivitete në kuadër të projekteve Vlora, Qyteti European i Sportit 2024 në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.66 dt.11.03.2024 **“Për ngritjen e komisionit të vlerësimit për procedurat në kuadër të aktiviteteve të Vlora Qyteti European i Sportit”** dhe Urdhërin e Brendshëm nr.70 dt 18.03.2024 **“Për një ndryshim në Urdhërin e Brendshëm nr.66 dt.11.03.2024”**,

-Pjesë e komisionit të ekspertizës në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.10 dt.10.01.2024 **“Për ngritjen e komisionit të ekspertizës”**

-Pjesë e grupit të punës në bazë të Urdhërit të Brendshëm nr.295 dt.24.07.2024 **“Për ngritjen grupit të punës për kryerjen e evidentimit, hartimit, ndjekjes gjatë zbatimit të punimeve të problematikave infrastrukturore në institucionet e arsimit parauniversitar në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë Administrative”**

Sektorit I Protokoll-Arkivës

Veprimtaria në Zyrën e Protokollit, bazohet në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, **“Për Arkivat”**.

Vendimin Nr. 4 datë 19.06.2017, të Këshillit të Lartë të Arkivave **“Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”**.

“Norma tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- Në protokoll cdo ditë janë kryer veprimet për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës;
- Është kontrolluar zbatimi i kërkesave që duhet të përmbushë dokumenti;

- Janë hapur dosjet sipas pasqyrës emërtuese të celjes së tyre dhe vendosen e sistemohen në to dokumentat vazhdimisht;
- Është siguruar dorëzimi i plotë dhe në kohë i dokumenteve që krijohen dhe hyjnë në institucion;
- Janë plotësuar kërkesat për shfrytëzim operativ të dokumenteve nga drejtoritë e Bashkisë, duke bërë evidencimin e tyre;
- Pranimi i dokumenteve hyrës është bërë në Sektorin e Protokoll - Arkivës, cdo ditë nga punonjësit e zyrës së protokollit.
- Të gjithë dokumentet hyrës, cdo ditë pasi janë protokolluar, janë dorëzuar tek Nënkryetare e Bashkisë. Pasi kthehen dokumentet me nënshkrim, shënohen në kolonën përkatëse në regjistrin e korespondencës mod.1 dhe u shpërndahen drejtorive përkatëse kundrejt firmës, sipas librit të dorëzimit të dokumenteve nga sekretaria në sektorë dhe anasjelltas, Mod 4/1.
- Dokumentet e hyra në Bashkinë Vlorë, cdo ditë iu shpërndahen Drejtorëve.
- Dokumentet dalëse janë protokolluar cdo ditë dhe pas protokollimit, janë mbyllur dokumentet në zarfe, është plotësuar zarfi, dhe janë rregjistruar ato në librin e dorëzimit mod. 4. më pas është kryer cdo ditë shërbimi postar.
- Për periudhën Janar – Gusht, numri i protokollit në regjistrin e korespondencës ka arritur në 13.496, pa përfshirë numrat e protokollit me fraksion.
- Cdo ditë nisen me shërbimin postar mesatarisht 100 zarfe.

Drejtoria Juridike

- Drejtoria juridike përkatësisht specialistët e saj sikurse ka proceduar në vijmësi edhe në periudhën e vitit 01.01.2024-31.08.2024 është përqëndruar në realizimin e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Organizimit dhe të Funkcionimit të Administratës së Bashkisë. Gjithashtu është angazhuar edhe në zgjidhjen e problematikave që dalin gjatë praktikës së përditshme të punës qoftë të Drejtorisë por edhe në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë.
- Gjatë kësaj periudhe 8– mujore janë përgatitur akte administrative si Vendime për vendimarrje të Këshillit të Bashkisë si dhe Vendime ose Urdhëra sipas rastit të Kryetarit të Bashkisë të cilat kanë qënë të lidhura vecanërisht me Drejtorinë Juridike. Gjithashtu është verifikuar ligjshmëria dhe janë sigluar akte administrative të përpiluara nga Drejtoritë dhe zyrat e tjera të Bashkisë ose Institucionet e tjera të varësise. Për të gjitha këto akte referuar argumentimit ligjor është konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë.
- Mund të themi se pavarësisht diskutimeve për akte të ndryshme të Këshillit të Bashkisë, Kryetarit ose Administratës të konfirmuara nga Drejtoria Juridike në asnjë rast këto

akte nuk janë shfuqizuar nga gjykata si akte të miratuara në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

- Konkretisht referuar të dhënave në mënyrë të koncentruar theksojmë se gjatë periudhës 01.01.2024-31.08.2024 Drejtorisë Juridike janë përgatitur rreth 10 Projekt- Vendime për Vendimarrje të Këshillit të Bashkisë, objekti i të cilave është i lidhur drejtëpërdrejt me Drejtorinë Juridike ose iniciuar prej saj, gjithashtu janë asistuar nëpërmjet konsulencës ligjore përfaqësisht 15 projekt-vendime për Këshillin e Bashkisë.
- Janë përgatitur gjithashtu dhjetëra urdhëra dhe vendime të Kryetarit të Bashkisë për problematika të ndryshme të cilat lidhen me Drejtori dhe sektorë të tjerë të Bashkisë si dhe rregullore të ndryshme në funksion të realizimit të procedurave të veprimtarisë së administratës së Bashkisë me autorizimin e Kryetarit të Bashkisë nga specialistët e Drejtorisë Juridike është përfaqësuar Bashkia Vlorë dhe institucionet e varësisë së saj në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit në cilat është thirrur si palë e paditur si dhe janë përgatitur kërkesë paditë kur vet Bashkia Vlorë ka inicuar proceset gjyqësore vecanërisht në zbatim të detyrave të lëna nga KLSH ose Institucione të tjera të Auditimit. Gjatë vitit 2024 kanë nisur procedurat gjyqësoret për 40 çështje kryesisht të inicuar nga palët e treta kundër bashkisë Vlorë ose Institucioneve në varësi të saj të cilat janë ndjekur rregullisht nga specialistet e drejtorisë juridike. Gjithashtu janë mbi 200 çështje të tjera gjyqësore në vijim nga vitet e kaluara në shkallë të ndryshme të gjyqësorit të cilat datojnë që prej vitit 2009. Edhe keto procese gjyqësore janë ndjekur rregullisht nga Drejtoria Juridike.
- Sikurse trajtuam veç çështjeve të filluara gjatë këtij viti janë ndjekur nga Drejtoria Juridike të viteve të kaluara shumë çështje të cilat janë duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit ose Gjykata e Lartë që presin të shqyrtohen si dhe çështje që pasi janë ankimuar janë risjellë përsëri për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Civile ose Administrative.
- Mund të themi se Drejtoria Juridike i ka ndjekur me përgjegjësi gjithë seancat gjyqësore dhe shkallët e gjyqimit me qëllim mbrojtjen e interesave të Bashkisë. Në asnjë rast nuk është konstatuar neglizhenca e specialistëve të Drejtorisë Juridike të Bashkisë në ndjekjen e procedurave gjyqësore.
- Fakti që theksuam më lart sipas të cilit shumë çështje janë në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë si dhe shumë çështje janë ankimuar ose janë kthyer për rigjykim mbi bazën e ankimit të Bashkisë dhe vazhdojnë prej shumë vitesh për një vendim përfundimtar e konfirmon këtë konstatim. Duhet të theksojmë se nuk ka çështje gjyqësore të cilat janë për të kundërshtuar akte të drejtëpërdrejta të organeve vendimarrëse të Bashkisë dhe të kenë sjellë pasoja financiare për Bashkinë Vlorë.
- Objekt i çështjeve gjyqësore ka qënë lidhur me problematika të ndryshme si kundërshtim vlere shpronësimi nga projektet e shumta në infrastrukturë, marrëdhënie pune, shlyerje detyrimesh për procedurat tatimore etj. Nga këto më të vështira për tu mbrojtur kanë qënë çështjet e vlerës së shpronësimit të pasurive pronë private të prekura nga projektet në Infrastrukturën Publike si dhe marrëdhëniet e punës.
- Kjo pasi gjatë procedurës së shpronësimit llogaritja e vlerave përkatëse është bërë sipas çmimeve të references bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ndërkohë që nga pronarët

pasuritë e të cilëve janë shpronesuar është kërkuar nëpërmjet gjykatës llogaritja e vlerës sipas çmimeve të tregut. Mund të themi se ka pasur raste që gjykatat kanë pranuar paditë pavarësisht pretendimeve tona. Theksojmë se në procedurat e shpronësimit Bashkia ka kryer vetëm vlerësimin paraprak pasi vendimi përfundimtar është i Ministrisë përkatëse. Theksojmë se Vendimet e Gjykatës me detyrime financiare për Bashkinë janë në tërësi vendime të Gjykatës së Apelit pasi në çdo rast vendimet e Gjykatës së shkallës së Parë janë ankimuar.

- Gjithashtu rëndësi e veçantë i është kushtuar korespondences me Institucionet e tjera shtetërore si dhe përgjigjet mbi kërkesat dhe ankesat e qytetarëve drejtuar Bashkisë të cilat kanë pasur lidhje me Drejtorinë Juridike si dhe atyre në platformën “Shqipëria që Duam”.
- Në punën e Drejtorisë Juridike vëmëndje të veçantë ka pasur korrespondenca dhe komunikimi me Institucione të tjera shtetërore dhe përgjigjeve për kërkesat e qytetarëve sipas problematikës për të cilën është adresuar për zgjidhje Drejtoria Juridike. Në të gjitha rastet përgjigja ka qenë e përgjegjshme bazuar dhe në dispozitat ligjore në fuqi si dhe brënda afateve të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e informimit”.
- Mund të themi se nga mbi 30 kërkesa dhe ankesa të adresuara Drejtorisë Juridike gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur çështje të pasqaruara për të cilat qytetarët t’i jenë drejtuar gjykatës ose organeve të tjera shtetërore në lidhje me Bashkinë Vlorë pasi kanë komunikuar direkt me Drejtorinë Juridike .
- Gjithashtu i është dhënë përgjigje në kohë çdo çështjeje që lidhet me Drejtorinë Juridike portalit të bashkëqeverisjes si dhe është bashkëpunuar me Drejtoritë, Sektorët si dhe institucionet e tjera të varësisë për përgjigjet e ankesave drejtuar këtij portali.
- Në përgjigjen e dhënë qytetarëve për kërkesat e tyre është zbatuar sikurse theksuam më lartë procedura e parashikuar në ligjin ”Për të drejtën e informimit”.
- Veç përgjigjeve për kërkesa dhe ankesa janë pajisur qytetarët mesatarisht çdo ditë rreth 10 vërtetime ose konfirmime të ndryshme sipas problematikës së paraqitur prej tyre. Në raste të tilla është synuar të pajisen në çast edhe pse afatet mund të ishin disa ditore.
- Theksojmë se puna ditore e specialistëve të Drejtorisë Juridike është kryer në bashkëpunim, edhe me Drejtoritë të tjera për plotësimin e dokumentacionit shkresor sipas problematikës së krijuar rast pas rasti.
- Ndërkohë janë hartuar urdhëra për ngritjen e grupeve të punës për realizimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit të parashikuara në buxhetin e vitit 2024 dhe është duke vijuar puna për realizimin e tyre.

Drejtoria e Urbanistikës

Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Vlorë, prej periudhës Janar-Gusht 2024 ka kryer punën si më poshtë vijon:

➤ Sistemi e-Lejet Janar – Gusht 2024

- Gjatë periudhës Janar – Gusht 2024, në sistemin elektronik e-Lejet rezultojnë **580** aplikime, nga të cilat **520** janë vlerësuar pozitivisht dhe kanë përfunduar procedurën.
- **Të ardhura nga Taksa e Infrastrukturës**

Gjatë punës në sektorin e kontrollit të lejeve të ndërtimit është bërë i mundur arkëtimi i vlerës **totale 85.000.000 lekë** si taksë e ndikimit në infrastrukturë për çdo leje ndërtimi të miratuar, përkatësisht si më poshtë:

- Muaji Janar 3882208.31 lekë
- Muaji Shkurt 4286632.6 lekë
- Muaji Mars 4374455.73 lekë
- Muaji Prill 1707874.82 lekë
- Muaji Maj 12927785.80 lekë
- Muaji Qershor 31099977.50 lekë
- Muaji Korrik 1375667.35 lekë
- Muaji Gusht 28401794.14 lekë
- Ku përfshihen llojet e lejeve si më poshtë:
 - Certifikatë Përdorimi
 - Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250m²
 - Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni
 - Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250m²
 - Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250m²
 - Leje për ndryshim aktiviteti/funksioni
 - Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit

➤ **Projektet Publike Infrastrukturore, Shkolla dhe Kopshte Bashkia Vlorë**

A-Janë përfunduar këto projekte:

- Rikonstruksioni i tualeteve të shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali”

- Vlera ~ 2 202 608 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi).

 - Rikonstruksioni i tualeteve të shkollës 9-vjeçare “15 Tetori”

Vlera ~ 3 324 661 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi).
- Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Jani Minga”,

Vlera ~ 7 500 000 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi).
- Rikonstruksioni i tualeteve të kopshtit Nr.5 , pranë shkollës “Teli Ndini”

Vlera ~ 1 551 603 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi).
- Rikonstruksioni i kopshtit Nr.10

Vlera ~ 39.000.000 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi).
- Rikonstruksion i kopshtit Nr.14 (pranë shkollës “Ibrahim Kushta”)

Vlera ~ 9 991 155 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi).
- Rikonstruksion i tregut të shumicës Bashkia Vlorë

Vlera ~ 13.627.115 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi).
- Lulishte dhe muri rrethues shkolla “Ali Demi” Bashkia Vlorë

Vlera = 3.050.755 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksion i rruges “Petro Marko” shkolla Tregtare seg 1

Vlera = 18.881.563 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksioni i rrugeve “Tartar Memushi”, “Fejzi Micolli”, “Elmaz Deri”, “Agim Shuku”, “Dora Distria”, etj

Vlera = 29.381.530 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksioni i rrugës “Ded Gjon Luli”

Vlera = 14.690.139 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksion i rrugës përballë shkollës “Naim Frasheri”, Bashkia Vlorë

Vlera = 2.431.701 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksioni i rrugës “Mëno Gjoleka”- “Harun Panaja”, Bashkia Vlorë

Vlera = 4.773.535 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)

- Projekti i rrugës mbrapa Bashkisë Vlorë
Vlera = 3.993.049 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksion i rrugës “Malo Beqari”, Bashkia Vlorë
Vlera = 1.934.425 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksion i rrugës ‘Donika Kastrioti’, Bashkia Vlorë
Vlera = 6.049.169 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Asfaltimi i rrugës “Gani Bejkosala”, Bashkia Vlorë
Vlera = 16.981.450 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksion i rrugës “Shtjefen Gjeçovi”- “ Haxhi Xhyheri”, Bashkia Vlorë
Vlera = 13.030.308 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rrjeti rrugor pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë
Vlera = 12.681.000 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Vendosje Barriera Mbrojtëse në rrugën “Transballkanike” dhe “Ali Demi” Vlorë
Vlera = 27.700.000 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rehabilitimi i kanalit në fshatin Mifol
Vlera = 3.500.000 lekë (dorëzuar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksioni i rrugëve te Fabrika e Cimentos, Faza 1
Vlera = 136.000.000 lekë (dorëzuar projekti, në pritje të oponencës teknike)
- Rikonstruksioni i rrugëve ne lagjen “Kushtrimi”, Faza 1
Vlera = 60.000.000 lekë (dorëzuar projekti, në pritje të oponencës teknike)
- Rikonstruksioni i Galerisë së Arteve, Vlorë
Vlera = 16.000.000 lekë (përfunduar projekti, në proces tenderimi)
- Rikonstruksioni i fushave të sportit në Lungomare, Vlorë
Vlera = 10.000.000 lekë (përfunduar projekti, në proces tenderimi)

- Vijëzimi i 4 parkimeve në qytetin e Vlorës
(përfunduar projekti, dorëzuar pranë NSHP - së)
- Projekti i parkimit publik në hapsirën hyrëse për tek ura e ishullit në fshatin Zvërnec.
(përfunduar projekti, dorëzuar pranë FSHZH – së për financim)
- Rikonstruksioni i ambjenteve të Teatrit “Petro Marko”
(përfunduar projekti, përfunduar investimi)
- Rikonstruksioni i ambjenteve të brendshme të Pallatit të Sportit “Flamurtari”
(përfunduar projekti, nuk u realizua investimi)
- Rrugët e brendshme në fshatin Fitore

Vlera = 15.300.000 lekë (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)
- Rrugët e brendshme në fshatin Mifol

Vlera = 8.200.000 lekë (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)
- Rrugët e brendshme në fshatin Aliban

Vlera = 34.509.000 lekë (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)
- Rikonstruksioni i rrugës në Fshatin Babicë e Madhe

Vlera = 9.500.000 lekë (përfunduar projekti, nuk u përfshi në buxhetin 2024)
- Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme në fshatin Xhyherinë

Vlera = 29.000.000 lekë (përfunduar projekti, nuk u përfshi në buxhetin 2024)
- Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Xhyherinë (segmenti lidhes Rruga Nationale SHA 76 - Xhyherinë Qëndër)

Vlera = 30.000.000 lekë (përfunduar projekti, nuk u përfshi në buxhetin 2024)
- Rikonstruksioni i rrugës Sali Dibra (shkolla Tregtare segmenti 2)

Vlera = 32.000.000 lekë (përfunduar projekti, nuk u përfshi në buxhetin 2024)
- Thirrje për aplikim nga FSHZH - Riasfaltimi i disa akseve rrugore në qytetin e Vlorës dhe në Njësitë Administrative
(përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)

- Thirrje për aplikim nga FSHZH - Rikonstruksioni i fasadave të objekteve të banimit në qytetin e Vlorës të ndërtuara përpara viteve 90' (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)
- Thirrje për aplikim nga FSHZH - Eco City, levizja dhe mobiliteti urban (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)
- Thirrje për aplikim nga FSHZH - Ndërhyrje rigjeneruese zonat rurale (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)
- Thirrje për aplikim nga FSHZH - Materjale dhe lëndë e parë (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim, janë përfituar 5 thirrje pozitive, duke përfshirë këtu stola, kosha, shtylla ndricimi, pllaka trotuari etj)
- Thirrje për aplikim nga FSHZH – Transformimi i aseteve të degraduara (përfunduar projekti, dërguar pranë FSHZH – së për financim)
- Rehabilitimi i trotuareve në Lungomare për personat me aftësi ndryshe (përfunduar projekti, nuk u krye realizimi për shkak të marrjes në dorëzim të shetitores bregdetare Lungomare)
- Rikonstruksioni i rrugës Abaz Gjermani (Nj. A. Orikum)

Vlera = 17.000.000 lekë (përfunduar projekti, nuk u përfshi në buxhetin 2024)

➤ **Janë në proces këto projekte:**

- Lulishte dhe hapsira të gjelbra në qytetin e Vlorës

Vlera = 12.000.000 lekë (hartuar projekti i arkitekturës, në proces hartimi i preventivit të punimeve)

- Rikonstruksioni i tualeteve në teatrin “Petro Marko”, Vlorë

Vlera = 837.000 lekë (përfunduar projekti, në proces hartimi i preventivit)

- Rikonstruksioni i palestrës së shkollës “4 Heronjtë”, Vlorë

Vlera = 40.000.000 lekë (përfunduar projekti arkitektonik, në proces hartimi i projekteve inxhinierike dhe preventivit)

- Rikonstruksioni i rrugës së Varrezave në fshatin “Kaninë”, (Nj. A. Qëndër)

Vlera = 37.700.000 lekë (përfunduar projekti, në proces hartimi i preventivit)

- Rikonstruksioni i rrugëve në fshatin “Tragjas”, (Nj. A. Orikum)

Vlera = 50.000.000 lekë (përfunduar projekti, në proces hartimi i preventivit)

- Shkallare te kompleksi i tek moli i Naftës, Vlorë

Vlera = 15.500.000 lekë (në proces hartimi i projektit dhe preventivit)

- Zgjerimi i varrezave në qytetin e Vlorës (përfunduar projekti, në proces hartimi i preventivit)

- Dhoma e serverit

Vlera = 18.500.000 lekë (përfunduar projekti, në proces hartimi i preventivit)

➤ **Hartimi i PDV-ve**

Gjate periudhës Janar-Gusht , Drejtoria e Urbanistikës ka përfunduar fazën e parë të hartimit të Planit të Detajuar Vendor sipas njësive strukturore si më poshtë:

- VL.UB.6.1384

➤ **Korrespondenca shkresore**

Gjate periudhes Janr-Gusht prane Drejtorise se Urbanistikës janë administruar dhe trajtuar **960** shkresa nga institucione, qytetarë dhe subjekte fizike dhe juridike.

➤ **Sistemi i adresave(Adresari)**

Gjate muajve Janar- Gusht janë paraqitur mesatarisht 18-22 qytetarë në ditë, duke përfshirë edhe disa qytetarë me kombësi të huaj. U është ofruar shërbimi për saktësim adrese apo konfirmim adrese për ndryshim vendbanimi. Gjithashtu në bashkëpunim të vazhdueshëm me Gjendjen Civile ndërhyjmë në rregullimin e pasaktësive në Sistemin e Adresave.

Policia Bashkiake

Me fillimin e vitit Policise Bashkiake ju be nje riorganizim i ri duke krijuar tre sektore . Sektori i kontrollit te territorit , Sektori qarkullimit , Sektori i shërbimeve mbështetëse dhe administrimit të sistemit E-Gjoba.

Per mbarvjatjen e sezonit turistik kemi bere propozimit konkrete Komisionit dhe drejtorive perkatese si me poshte.

- 1- Rishikimi i stacioneve te furgonave ,duke i larguar ata nga qendra dhe rruget me fluks te larte levizje dhe duke i cuar ne pikat hyrese te qytetit . (Nuk eshte bere)
- 2- Reduktimi I orareve te furnizimit te bizneseve nga furgonat gjate sezonit turistik (eshte bere)
- 3- Vendosja e sinjalistikes rugore sidomos ne akset kryesore te qytetit cilindra plastike/tabela (nuk eshte bere)

- **Për Plazhet**

Në zbatim të Planit të masave të Bashkisë Vlorë, “Për kontrollin dhe monitorimin e hapësirave publike dhe private si stacion plazhi” Nr 4883. Prot datë 25.04.2023, Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr 127 datë 25.04.2023, “Për kontrollin e hapësirave publike si Stacion Plazhi”, Policia Bashkiake ka marr në monitorim të gjithë vijën bregdetare në territorin e Bashkisë Vlorë, duke e ndarë atë në pesë sektorë dhe duke e mbuluar me kontrolle të përditshme gjithë territorin.

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr 82 datë 04.04.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për manaxhimin e hapësirave publike për stacione plazhi dhe përgatitjen e plan-vendosjeve përkatëse për cdo parcelë”, në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë Aseteve është bërë matja në terren e sipërfaqes që do të shfrytëzohet si stacion plazhi. Ky proces nuk ka mbaruar ende edhe pse afatet ligjore janë tejkaluara.

Në zbatim të VKM Nr.1172 datë 24.12.2020 për disa ndryshime në VKM Nr.171 datë 27.03.2019, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar Neni 14 pika 8 gërma a “Dorëzimi i hapësirës së plazhit bëhet, si më poshtë vijon”. a) Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat e stacionit të plazhit dhe njofton Policinë Bashkiake për monitorimin e veprimtarisë.

Aktualisht, Policia Bashkiake i është dorëzuar një numër i vogël stacionesh plazhi. Për të parandaluar cdo ngjarje të jashtëzakonshme, prej datës 17.06.2024 Policia Bashkiake ka filluar kontrollin në të gjithë stacionet e plazheve përgjatë gjithë vijës bregdetare nga Hidrovori Akërrni deri te Postoblloku në Pashaliman, ku po bëjmë një kontroll të gjendjes fakt të kushteve të sigurisë në stacionet e plazhit. Nga kontrollet tona kemi konstatuar se një numër jo i vogël i stacioneve të plazheve nuk i plotëson kushtet e sigurisë. Në këto kushte shërbimet e Policisë Bashkiake kanë mbajtur Akt – Kontrollet përkatëse duke lënë detyrat dhe afatet për të plotësuar cdo mangësi. Për mospërbushjen e këtyre detyrave janë masat administrative sipas VKB Nr.76, date 30.09.2022 neni 9 pika 2 ne 15 raste.

Te gjitha hapsirat e parashikuara për plazh publik në gjithë vijën bregdetare janë mbajtur të lira përgjatë gjithë sezonit turistik.

Vija bregdetare është ndarë në pesë sektorë.

Spektori Hidrovori (Akërrni) ushtrojnë aktivitet 3 stacione plazhi.

Spektori Hundë Plakut (Zvërrnec)- Plazhi i Vjetër ushtrojnë aktivitet 58 stacione plazhi .

Spektori Lungomare – Jonufër ushtrojnë aktivitet 67 stacione plazhi .

Spektori Jonufër - Moli Bacit (Radhimë) ushtrojnë aktivitet 58 stacione plazhi.

Spektori Moli Bacit – Postoblloku Pashalimanit ushtrojnë aktivitet 61 stacione plazhi.

Gjithsej, përgjatë vijës bregdetare në territorin e Bashkisë Vlorë janë duke ushtruar aktivitetin 245 stacione plazhi.

Janë konstatuar mungesa të kullave (pikave) të vrojtimit apo kompletimi i tyre, mungesa e vendosjes së tapave kufizues .

Falë kontrolleve të vazhdueshme të gjithë subjektet stacion plazhi ka bërë që në vijën bregdetare të Bashkisë Vlorë të mos ketë asnjë ngjarje të jashtëzakonshme gjatë kësaj periudhe (humbje jete) .

- **Në fushën e mjedisit**

Policia Bashkiake është e angazhuar me shërbim 24 orë për evidentimin e zjarreve të qëllimshme, apo në riaktivizimin e tyre në pikën e grumbullimit të mbetjeve urbane , ku dihet vështirësia pasi sipërfaqja e pikës së grumbullimit të mbetjeve është e madhe. Pothuajse përditë, konstatohet aktivizimi i shumë vatrave të zjarrit, ku është punuar nga të gjitha strukturat për fikjen e tyre .

Vëmendje të shtuar Policia Bashkiake sidomos përgjatë sezonit turistik ka pasur ndaj subjekteve apo individëve që hedhim mbetje jashtë koshave të mbetjeve urbane , duke u bërë një shqetësim i vazhdueshëm për komunitetin dhe shërbimet e pastrimit . Për këtë në zonat me prioritet turistik ku dhe rrisku i këtij fenomeni është më i lartë kontrollet e shërbimeve të Policisë Bashkiake kanë qënë pothuajse përgjatë 24 orëve. Ndaj rasteve të konstatuar për subjekte dhe qytetarë të ndryshëm janë marrë 75 masa administrative.

Muzika e lartë sidomos nga bizneset që operojnë në zonën bregdetare është një nga prioritetet e Policisë Bashkiake përgjatë sezonit turistik. Kemi nderhyrë me drejtorinë e mjedisit për çdo ankese të ardhur apo problematik të konstatuar.

- **Hapësirat Publike**

Prioritet i punës tonë ka është kontrolli i territorit të Bashkisë sidomos shfrytëzimi i hapësirave publike. Në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë në periudhën Mars-Gusht në bashkëpunim me inspektorët e DAV është bërë matja reale e sipërfaqes në terren. Janë bërë kontrolle të përditshme vetëm ose në bashkëpunim me Inspektorët e DAV , ku për shkeljet e konstatuara kemi marrë masa administrative përkatëse në 19 raste. Për subjektet që nuk përmbushin detyrimet ligjore për shfrytëzimin e hapësirave publike apo dhënia e tyre cënon lëvizjen e këmbësoreve apo krijojnë problematika të ndryshme i kemi drejtuar DAV për moslidhje kontrate.

Lirimi hapësirave publike të zëna nga tregtarët ambulant, nga subjektet që operojnë në katet e para të pallateve apo ndërtesa në rrugët kryesore të qytetit dhe njësive administrative etj ka qënë një detyrë e përditshme dhe është ndërhyrë në mbi 240 raste.

- **Qarkullimi**

Me integrimin e Policisë Bashkiake në sistemin E - Gjoha është zgjidhur përfundimisht problematika e hasur prej vitesh në këtë drejtim . Prej datës 20.02.2024 e në vazhdim gjokat e Policisë Bashkiake janë pjesë e këtij sistemi. Aktualisht, për këtë periudhë 20.02.2024-

06.09.2024 janë maturuar 17655 masa për kundravajtje rrugore. Janë marrë 23 masa administrative për sigurinë rrugore. Rezultatet në këtë drejtim janë të dukshme ku parkimet , qëndrimet e gabuara të mjeteve janë ulur ndjeshëm .

Menaxhimi trafikut pranë shkollave ka qenë një detyrë e përditëshme e Policisë Bashkiake deri në përfundimin e vitit shkollor .

Një problematikë e pazgjidhur ende është për mjetet që parkohen në rrugët e qytetit për qëllime biznesi (makina që shiten apo jepen me qira), problematikë që kohët e fundit është shtuar shumë . Kodi Rrugor i RSH nuk parashikon masa administrative për raste të tilla, VKB e trajton si zënie të hapësirës publike . Për lirim të kësaj hapësire duhet që të kemi një shërbim karroatreci dhe një pikë bllokimi të sigurtë për këto mjete .

- **Te ndryshme**

Janë zgjidhur në kohë të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarët , Policia e Shtetit si dhe Platforma e Bashkëqeverisjes në rreth 500 raste .

Eshtë ndërhyrë si strukturë apo në mbeshtetje të IMT, njësisve administrative e rajoneve për parandalimin e ndërtimeve pa leje apo prishjen e tyre në 35 raste.

Eshtë mbuluar me shërbim Tregu në Novoselë cdo ditë të enjte .

Eshtë bërë siguri i mbarëvajtjes së aktiviteteve të ndryshme social kulturore që ka organizuar Bashkia Vlorë përgjatë kësaj periudhë në jo më pak se 280 raste sidomos të aktivitetet në kuadër të “ Vlora Qyteti European i Sportit” dhe ato te sezonit turistik.

Eshtë bërë siguria e aktiviteteve sportive që Klubi Sportiv “ FLAMURTARI ” dhe “ORIKU” kanë zhvilluar sipas kalendarit sportive të tyre.

Policia Bashkiake është angazhuar në krijimin e kushteve optimale për punën që kryejnë firmat zbatuese të projekteve të shumta që kryhen në qytet. Gjithashtu kemi bashkëpunuar cdo ditë me drejtoritë e Bashkisë UK , NSHP , DIP, sipas kërkesës së tyre duke ndërhyrë në largime mjeteve që bëhen pengesë për punime dhe bllokime segmentesh rrugore në vartësi të proceseve të punimeve.

DREJTORIA PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Gjatë 8 mujorit të parë të vitit 2024 nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve objektivat për periudhën 01.01.2024 – 31.08.2024 janë si më poshtë:

1.Në sektorin e inventarizimit dhe regjistrimit të Pronave të Paluajtshme

Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, ushtron veprimtarinë e saj, përse i përket pronave të paluajtshme të shtetit, bazuar në ligjin nr.8743 datë 22.02.2001 ”Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, ligjit nr.8744 datë 22.02.2001 ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” si dhe vendimeve të Këshillit të

Ministrave “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të njesive vendore”, udhëzimit nr.1, datë 15.02.2002 “Për plotësimin e formularit për inventarizimin dhe transferimin e ambjenteve administrative në pronësi të njesive të qeverisjes vendore“, Udhëzimit Nr.2 datë 30.04.2002 ”Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit dhe plotësimin e formulatëve”, Udhëzimit nr.3 datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njesitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimit nr.15, datë 30.05.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njesitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

Në Urdhërin e Brendshëm Nr.371 datë 11.09.2024, protokolluar me Nr.14036 prot datë 11.09.2024, “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit të pronave shtetërore”, janë ngritur grupet e punës, të cilat do të vijnë me hartimin e dokumentacionit ligjor e teknik për procedurën e inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore, në pronësi të Bashkisë Vlorë.

Grupet e punës do të hartojnë planimetritë dhe planvendosjet e objekteve në KRRGJSH, pjesë përbërëse e dokumentacionit për përgatitjen e materialeve për procedurë për certifikimin e pronave. Dosjet e përgatitura nga grupet e punës do të dorëzohen te firmosura, të protokolluara dhe në 2 CD, pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për vijimin e praktikës. Materiali përfundimtar do të shqyrtohet nga komisioni përkatës që do të vijojë me korespondencën me institucionet e treta ASHK Vlorë, aplikimi në sistemin e-albania, për pajisjen me dokumentacion pronësie në favor të Bashkisë Vlorë të pronave të inventarizuara, përgatitjen e materialit për Këshillin e Bashkisë, korespondencën me Agjencinë e Inventarizimit të Pronave Publike (AITTP), plotësimin e formularëve sipas modelit të miratuar me udhëzimin nr.1, datë 15.02.2002 të AITTP-së për përgatitjen e kërkesës për miratimin e listës përfundimtare pranë AITTP-së.

Pronat e inventarizuara janë të përmbledhura ne tabelën e mëposhtme:

Nr	Bashki/ Njesi administrative	VKM miratim liste	VKM transferimi	Nr pronash	Regjistruar ose jo
1	Bashkia Vlorë	VKM 639 datë 29.09.2007	vkm 1643 datë 17.12.2008	825 +25 +23 +1 = 874	24
2	Njesia Administrative Qendër	vkm 1528 datë 19.11.2008	vkm 572 datë 28.05.2009	1265	1
3	Njësia Administrative Novoselë	vkm 729 datë 07.11.2007	VKM 361 datë 13.05.2011	765	
4	Njësia Administrative Shushicë	vkm 1381 datë 17.10.2008	VKM nr 478 datë 25.07.2012	1325	
5	Njësia Administrative Orikum	vkm nr.1026 datë 15.12.2010	vkm 937 datë 26.12.2012	2992	

Puna do të fillojë me përgatitjen e dosjeve për fushat e veprimtarive të mëposhtme:

- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.

- Prona që përdoren për realizimin e programeve social kulturore e sportive.
- Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve ne fushën e shëndetësisë.
- Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve ne fushën e shërbimit social.
- Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve ne fushën e administratës.

Objektivi është që, deri në datën 31.12.2024, të kemi përgatitur dosjet ligjore për prezantim në Këshillin e Bashkisë për:

- pronat që përdoren për realizimin e programeve arsimore
- Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve ne fushën e shëndetësisë.

Në zbatim të VKM 389 datë 13.05.2000 "Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve", çdo aplikim në ASHK, shoqërohet me kryerjen e pagesave sipas llojit të shërbimit.

Duke përllogaritur që, DPPMA mund të realizojë aplikimin për 250 praktika për kalim pronësie (certifikatë pronësie, kartelë të pasurisë së paluajtshme dhe fragment të hartës kadastrale) lutemi të planifikoni në buxhet fondin prej 1,000,000.00 lekë.

Për realizimin e kësaj detyre , kërkojmë nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit fondin 500 000 leke për aplikimet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastres Vlorë deri në datën 31.12.2024.

2.Në sektorin e shpronësimeve

Spektori i shpronësimeve funksionon në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar dhe VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar. Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve harton dosjen me dokumentacionin e nevojshëm, për të paraqitur më tej kërkesën për shpronësim publik, pranë ASHSH Tiranë.

Janë në proces dosjet ligjore me kërkesat për shpronësim pranë ASHSH Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për shpronësim për projektet:

- Kërkesë për shpronësim për shtesa të VKM-së nr.20 datë 24.01.2024 "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar" Vlore
- Kërkesë për shpronësim për shtesa të VKM-së nr.414, datë 27.05.2020 "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës", Bashkia Vlorë.
- Krijimi i database për fillimin e punës për projektin "Lungomare 3" që fillon nga tuneli dhe përfundon në Orikum.

3.Sektori i plazheve

Në mbështetje të VKM 171 Datë 27.03.2019 si dhe Udhëzimeve të AKB “Mbi procesin administrativ ”Për menaxhimin e sezonit turistik për vitin 2025

Objektivi është:

- Brenda datës 20.09.2024 do të përgatishim listën e plazheve dhe hartën përfundimtare. Faza I (1-20 shtator)
- Rakordimin e hartave Bashki - Ministri –Agjensi Kombetare e Bregdetit Faza II (20-30 shtator)
- Respektimi I të gjitha afateve të tjera që kërkon VKM-ja e mësipërme deri në lidhjen e kontratave për subjektet e interesuara për stacione plazhi.
-

4. Sektori i tokave bujqësore

Në zyrën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës të DAMT të Bashkisë Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së 1182, datë 24.12.2020, “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”; VKM-së 1174 të VKM –së Nr.1174, datë 24.12.2020, “Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”; është punuar në raport me praktikat e fermerëve duke plotësuar dhe dërguar në ASHK, Dv-Vlorë dosjen përkatëse të cdo fermeri.

Situata e praktikave të aplikuara nga fermerët dhe të trajtuara nga kjo zyre është si më poshtë:

Nr	Njesitë Administrative	Numri i praktikave			Shenim
		Dërguar në ASHK		Pa	
		Pronesi	Perdorim	dërguar	
1	Ish Bashkia Vlore	Pa info	306	55	
2	Nj.Administrative Novoselë	528	164	164	
3	Nj.Administrative Qendër	1022	121	734	
4	Nj.Administrative Orikum	455	86	45	Shto praktikat e derguara nga Nj.Ad.Orikum
5	Nj.Administrative Shushicë	259	19	28	
6	SHUMA	2264	696	1026	

Këto praktika që janë pa dërguar në ASHK , janë aplikime që janë bërë nëpër njësitë Administrative në zbatim të VKM-së 994/2015 që nga viti 2015 e në vazhdim.

4. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT

Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe turizmit përbëhet nga tre sektore kryesor:

- Sektori i Zhvillimit Ekonomik
- Sektori i Zhvillimit të Tregjeve
- Sektori i Turizmit

Normalisht funksionon vetëm sektori i turizmit në këtë drejtori dhe si sektor turizmi përgatit analizën vjetore mbi realizimin e detyrave që ajo ka zhvilluar. Sektori i Turizmit është shtuar si strukturë për 2024 dhe me dy specialist turizmi, duke e çuar numrin në 4 specialist. Struktura është e përbërë nga: Drejtori i drejtorisë dhe 4 Specialist.

1. Nje draft – plan mbi Prioritetet e turizmit në Vlorë

- Promovimi i qytetit si një qytet turistik dhe me potencial, duke synuar turizmin e qendrueshem dhe për një të ardhme bazuar në ai elitare. Promovimi i qytetit jo vetëm si qytet bregdetar, por që ofron dhe turizmin malor, kulturor, kulinare, ekoturizmin, turizmin rural, agroturizmi, turizmin malor dhe të aventurës etj, pra gjithëpërfshirës.
- Ofrimi i një mjedisi të pastër, si dhe mbrojtja dhe përmirësimi i tij. Përmirësimi i shërbimit në shtetore të ndryshme të turizmit.
- Mbështetja e zhvillimit të ekonomisë së qëndrueshme dhe në rritje.
- Modeli i integruar i turizmit kulturor – natyror-bregdetar duke u munduar për të dalë në një logo dhe slogan të përbashkët, të unifikuar si Bashki.
- Krijimi i produkteve të reja inovative, kulturore dhe bregdetare
- Tërheqja e një numri sa më të madh të vizitorëve dhe të turistëve në qytet dhe në rrethinat e saj.

Plani i veprimit për turizmin synon të kontribuojë në rritjen e zhvillimit ekonomik të Vlores, synon në promovimin e zones si dhe në eksperiencat cilësore e të qëndrueshme të vizitorit nëpërmjet:

- 1- Marketingu konsumator presupozon maksimizimin e përfitimeve ekonomike të turizmit nga qyteti dhe rrethinat e tij me anë të ndarjes së sezonit turistik sipas periudhave kohore të ndryshme, pra shtrirjes së sezonit të vizitorëve dhe sidomos inkurajimit për të qëndruar më shumë nëpërmjet një marketingu efektiv dhe të targetuar.
 - i. Kërkimi marketing është një mjet shumë i nevojshëm për tu informuar mbi tendencat e tregut dhe performancën e tij
 - ii. 2- Brandimi është një tjetër aspekt i cili realizohet duke punuar për krijimin e një brandi të fortë, të identifikueshëm dhe qartësisht të dallueshëm për turizmin
 - iii. Publikimet
 - iv. Marketingu i qëndrimit të vizitorëve.

v. Shërbimet e Zyrave të Informacionit Turistik (Info Point).

2- Zhvillimi i destinacionit

1-Promovimi për turizëm jo vetëm detar por edhe ai malor duke e kthyer Vlorën në një qytet turistik gjithë vitin.

Përmiresimi i faqes së web-it dedikuar turizmit, duke ofruar aty informacion turistik të gjithanshëm dhe të përditësuar.

2- Promovimi i dallueshmërisë lokale dhe zhvillimi i projekteve lokale.

3- Sfidat specifike:

- Nevoja për një integrim më të madh të planifikimit të turizmit dhe destinacioneve turistike.
- Adresimi i dobësive në lidhje me gamën dhe cilësinë e produkteve turistike
- Zhvillimi i një mjedisi më të favorshëm ligjor dhe institucional për përthithjen e investitoreve të huaj dhe vendas.
- Nevoja për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe strategjike në lidhje me turizmin, për qëndrueshmërinë dhe sigurimin e të ardhuravë, mundësinë e punësimit.

4- Pikat kryesore për punën e zyrës së turizmit bazuar në planin e masave 2024

➤ *Statistika*

Grumbullimi i të dhënave për strukturat akomoduese, agjensi turistike dhe subjekte të tjera turistike. Grumbullimi i të dhënave për numrin e turistëve në bashkëpunim me DAV, Drejtorinë e tatimeve rajonale, agjensinë e zonave të mbrojtura, Drejtoria rajonale e kufirit dhe emigracionit, muzetë dhe qendrat historike etj.

➤ *Eventet*

Koordinojmë kalendarin e bashkisë mbi ngjarjet tradicionale dhe kulturore. Hartimi i kalendarit të festave lokale 2024. Promovimi i kalendarit kombëtar të eventeve TEA.

➤ *Materialet Promovuese*

Përmirësojmë rrjetin e informacioneve turistike dhe pajisjen në vazhdimësi me materiale promovuese. Publikimi i materialeve dhe përditësimi i web page mbi informacionet e turizmit. Përgatitja paraprake me materiale për panairt e turizmit.

➤ *Struktura*

Përgatitja e një projekti në bashkëpunim me biznesin për një informacion sa më të plotë kulturor, historik dhe turistik. Puna në grup për ngritjen dhe identifikimin e INFO Point në territorin që mbulon Bashkia Vlore.

➤ *Bashkëpunimi*

Bashkëpunimi me drejtoritë e tjera për të vendosur në dispozicion të pushuesve numra telefoni në struktura të ndryshme për ankesa apo shërbime të munguara ndaj tyre. Promovimi i artizanëve dhe produkteve lokale në Bashkinë Vlore

2. Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme :

- a. Ne kader te thirjeve te reja te programit Europa Krijuese 2021 – 2027. Sesion trajnues me teme: Shkrimi i projekt propozimeve- Ngritje kapaciteteve dhe udhezime praktike ne kuader t eprogramit “CeDESK ne Shqiperi” Salla Tefta Tashko Koco Tirane data 09.11.2023. Organizuar nga Ministria e Kultures e Shqiperise .
- b. Puna ne grup nga Shtatori 2023 per Inventarizimin dhe Arkivimin e dokumentacionit te sektorit te prokurimeve, me urdher Nr 329, date 27.09.2023.
- c. Puna në grup në komisionin e prokurimit e njoftimeve dhe kronikave televizive. Mbështetur në nenin 7, pika 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), V.K.M nr 1195 datë 05.08.2008 kreu II pika 6 “ Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkprodhimin e programeve, a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizive ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetore”
- d. Puna në grup me urdhër të brendshëm Nr 316, dt 20.09.2023. Për ngritjen e komisionit të prokurimit për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike, kulturore.
- e. Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 31.01 – 1.02.2024 Panairi i Turizmit në Pallatin e Kongreseve”Tourism&Travel show Albania”
- f. Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 26 – 29.02.2024 Panairi i Turizmit në Bari (Itali)
- g. Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 04 – 7.03.2024 Panairi i Turizmit në ITB Berlin (Gjermani)
- h. Puna për përgatitjen dhe pjesëmarrjen dinjtoze në panair. 11 – 13.02.2024 Panairi i Turizmit në Prishtinë (Kosovë)
- i. Pjesëmarrja në konferencen “THE FUTURE OF THE ADRIATIC PAST” Kotor, Mali i Zi, 13 Prill 2024
- j. Puna ne grup per Masat e sezonit Turistik 2024. Urdher nr 72, dt 20.03.2024
- k. Puna për përgatitjen e panairit dhe hapjen e Sezonit Turistik.10.05.2024 .
- l. Kthim pergjigje per cdo shkrese dhe dokumet te derguar ne Drejtori, si nga emaili edhe nga protokolli.
- m. 9-10-11 Maj 2024. Shkolla pranverore ”Përmirësimi i shërbimeve në nivel lokal për të rinjtë dhe kontributi i tyre në komunitet”. Prezantimi i zyres me temen: Bashkëbisedim me te rinjte për promovimin e Vlorës si qytet turistik. Pallati i Kulturës “Labëria”
- n. Më datë 30 maj 2024, Kolegji Universitar Qiriazhi, në bashkëpunim me partnerët e tij, organizoi një konferencë ndërkombëtare mbi turizmin dhe hotelerinë. Me këtë rast, ne beme një prezantim online.

- o. Në datë 30 Maj 2024, ora 09:00- 15:30, te Vlora International Hotel, ndoqëm trajnimin me temë "Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë". Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizuan në Vlorë këtë trajnim.
- p. Trajnimi i trajnerëve u zhvillua në Trieste (Itali) dhe në Piran (Slloveni) nga data 10 deri më 14 qershor 2024. Projekti TRUE BLUE, bashkëfinancuar nga OGS dhe Iniciativa e Evropës Qendrore - CEI, përmes Programit të Shkëmbimit të njohurive (KEP), i cili është një instrument mbështetës i projekteve dhe programeve të fokusuara në transferimin e njohurive dhe praktikave më të mira nga Shtetet Anëtare të BE-së në CEI jo të BE-së. Ky projekt financohet me kontributin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Cooperazione Internazionale të Republikës Italiane.
- q. Trajnimet nga ASPA QERSHOR 2024.
- r. Përgatitja e materialeve për mbledhjen e prefektures (Përgatitja e dokumentacionit për të gjitha drejtorite e bashkisë)
- s. Pjesëmarrja dhe ndihmesa në organizimin e Show veror në Orikum, 7 Gusht
- t. Pjesëmarrja dhe ndihmesa në organizimin në datën, 17 gusht 2024 DJ Steve Aoki në Lungomare.
- u. Pjesëmarrja dhe ndihmesa në organizimin e aktiviteteve të tjera në aktivitete e Bashkisë për gjatë sezonit turistik veror 2024.

3. Statistika te Perpunuara nga zyra:

3.1 Investimet e reja në fushën e turizmit

Në vitet e fundit vihet re një bum rritje e investimeve në fushën e turizmit. Gjatë këtij viti rritja nuk mund të shprehet më në %, por disa herë më e madhe se viti paraardhës. Interesimi i qeverisë shqiptare, i biznesit në këtë fushë duket si nga numri dhe sipërfaqja e ndërtimit, por dhe nga vlera e investuar.

Investime reale në fushën e turizmit që i kanë dhënë një hov qytetit dhe një fuqizim ekonomik të vazhdueshëm.

- Lungomare 1,2 dhe vazhdimi Lungomare 3 dhe zona e Radhime -Orikum
- Sheshi i Flamurit
- Zona historike – Muradie
- Investime në lagje të qytetit
- Bypassi i Vlores nje investim gjigand.
- Sheshi përpara Muzeut Pavaresi
- Tyneli i Llogarase
- Aeroporti i Vlorës. Etj
-

3.4 Subjektet Turistike Të Certifikuara Dhe Licensuara për Bashkinë Vlorë

- **Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së të ardhurave Vendore**

Aktivitete ne fushen e turizmit 16; Akomodime 17; Piceri 22; Apartamente dhoma me qera 14; Dhoma Plazhi 24; Agroturizem 1; Bar Bufe 7; Beach Bar 4; Fast Food 35; Operator Turistik 12; Guide Turistike 4; Akomodime te tjera 7; Sherbime te ndryshme turistike 29; Stacione Plazhi 27; Struktura Akomoduese 13; Guida, Udherrefyes Turistik 7.

- **Bazuar në të dhënat e Drejtorisë Rajonale të tatim taksave**

Agjensi Detare 5; Agjensi Turistike 38; Hoteleri 14; Akomodime 15; Apartamente ,dhoma me qera 14; Dhoma Plazhi 24; Agroturizem 1; Aktivitete ne fushen e Turizmit 16; Piceri 22; Bar Kafe 2358; Bare Restorante 116; Bar Bufe 7.

3.3 Të dhënat të vizitorëve për perjudhen Janar – Korrik 2024 sipas institucioneve të poshtëshënuara:

Porti Vlorë (+ Gushti) 74 777

Policia Kufitare Dvkm 404993

Drejtoria Rajonale E Trashëgimise Kulturore

Kalaja E Kaninës 1615

Parku Arkeologjik Orikum 1238

Agjensia E Zonave Te Mbrojtura

Pk Llogara 36223

Pkd Karaburun-Sazan (+ Gushti) 32123

Pn Karaburun (+ Gushti) 28772

Pm Pish-Poro Narte (+ Gushti) 47081

Muzeu Kombetar I Pavaresise (+ Gushti) 3502

Muzeu Historik Arkeologjik - Ska Të Dhëna

Muzeu Etnografik - Ska Të Dhëna

DREJTORIA E INFRASTRUKTURES DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

1-SEKTORI I STREHIMIT

Gjatë 8 mujorit të parë të vitit 2024 nga sektori që mbulon çështjet e strehimit janë kryer të gjitha procedurat e përcaktuara për strehimin social në aktet ligjore në fuqi dhe në rregulloren e brendshme të bashkisë, mbi funksionet, përgjegjësitë dhe kompetencat e këtij sektori. Konkretisht,

1. Është përgatitur project-vendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë me Vendimin Nr.6, datë 29.01.2024 “Për miratimin e listës emërore të familjeve dhe

- individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen” Kushttrimi” tek ish-frigoriferi Vlorë”. Kopje të këtij vendimi i kemi përcjellë për vazhdimin e procedurave në kompetencë Entit Kombëtar të Banesave Drejtoria e Përgjithshme Tiranë dhe Drejtoria Rajonale Vlorë.
2. Është përgatitur project-vendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë me Vendimin Nr.13, datë 26.02.2024 “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe ta pafavorizuara”
 3. Është përgatitur project-vendimi, është paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë dhe është miratuar me VKB Nr.14, datë 26.02.2024 “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”
 4. Është hartuar projekti teknik, dosja me dokumentacionin e plotë të aplikimit dhe janë paraqitur pranë MEK&I në afatin e përcaktuar.
 5. Është hartuar project-vendimi dhe është paraqitur për tu miratuar në Këshillin e Bashkisë, me VKB Nr.12, datë 26.02.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit për çdo rast”. 16 familjet e para për vitin 2024, ku për hartimin e project-vendimit është plotësuar dhe shqyrtuar dokumentacioni i familjeve, verifikimi faktik në terren, është kaluar në komisionin e strehimit të bashkisë etj.
 6. Është hartuar project-vendimi dhe është paraqitur për tu miratuar në Këshillin e Bashkisë, me VKB Nr.36, datë 30.04.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit për çdo rast”. 7 familje dhe individë, grupi i dytë. Është plotësuar dhe shqyrtuar dokumentacioni i familjeve, verifikimi faktik në terren, është kaluar në komisionin e strehimit të bashkisë etj.
 7. Është përgatitur project-vendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë me Vendimin Nr.37, datë 30.04.2024 “Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara”.
 8. Është përgatitur projektvendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.59, datë 27.06.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.
 9. Është përgatitur projectvendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.68, datë 30.07.2024 “Për trajtimin me pagesat e qirasë sipas programeve për strehimin social të znj.Rukije Shabani, për shkak se banesa e saj preket nga zbatimi I projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë”.
 10. Është përgatitur projektvendimi dhe është miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë me Vendimin Nr.88, datë 26.09.2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.
 11. Është punuar sëbashku me rajonet administrative në qytet për mbledhjen e të dhënave për tregun e qirasë së banesave në qytetin e Vlorës gjatë këtij viti, në funksion të

- përgatitjes së projektvendimit për miratimin e qirasë mesatare në treg të lirë dhe subvencionit maksimal që përfitojnë familjet pa të ardhura.
12. Jemi në proces të evidentimit të banesave dhe të regjistrimit të kërkesave për përgatitjen e projekteve dhe të projektvendimit për programin “Përmirësimi I kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.
 13. Në bashkëpunim me rajonet dhe njësitë administrative bëjmë verifikimin në terren për të gjitha kërkesat e qytetarëve në lidhje me programet dhe projektet e strehimit
 14. Çdo ditë bëhet pritja e qytetarëve për kërkesë-ankesat e ndryshme, kthim përgjigje kërkesave me shkrim, komunikimi shkresor dhe verbal me institucionet për problematika të ndryshme të strehimit, etj.

2- SEKTORI I TRANSPORTIT

Sektori i transportit zbaton me përpikmeri të gjitha dispozitat për nxjerrjen e liçencave dhe certifikatave për transport rrethqytetes , qytetës ,taksi ,agjensi transporti dhe licencë tregtim karburanti.

Licensimi i subjekteve bëhet në bazë të Ligjit 8308 datë 18.08.1998 ”Për transportet rrugore” , i ndryshuar, VKM dhe udhëzimeve të MIE.

Në 8-mujorin e vitit 2024 është bërë licensimi i të gjithë atyre subjekteve të cilët kanë paraqitur kërkesat për licensim.

1-Taksi 4+1 janë licensuar 37 mjete dhe në proces 11 mjete.

2-Certifikata për transport mallrash për llogari të vet janë 75 copë, për transport mallrash për të tretë janë 33 copë, licence transporti mallrash për të tretë 1 copë, me afat 5-vjecar.

3-Certifikata mjetesh rrethqytetase 41 copë.

4-Agjensi transporti ndërkombëtar 1 copë.

5-Çertifikatë udhëtarësh për llogari të vet janë 8 copë.

6- Drejtoria DIIP pajis me licence tregtim karburanti subjektet të cilat tregtojnë karburant. Në 8-mujorin e vitit 2024 janë pajisur me licencë 5-vjecare 8 subjekte. Subjektet të cilat nuk u ka mbaruar afati i licensimit paraqiten në momentin e përfundimit të licences për tu pajisur me licencë. Ndërsa për subjektet që nuk janë të pajisura dhe nuk kanë shlyer detyrimin ndaj Bashkisë Vlorë si dhe detyrimet që ka lënë KLH janë bërë njoftimet përkatëse dhe i ka kaluar për trajtim sektorit të borxhit te Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

7-Sherbimi i transportit urban në qytet kryhet nga subjekti “Urban Trans Vlora”. Në këtë shërbim i është kushtuar vëmendje e veçante rritjes së cilësisë së transportit urban duke u shërbyer sa më mirë komunitetit.

8-Taksa e parkimit është vjelë nga të gjithë subjektet në momentin që subjekti pajiset me lic+certif, dhe vlefata e taksës parkimit bëhet në bazë të VKB .

Të gjithë subjektet të cilat kërkojnë parkim para subjekteve të tyre paguajnë taksën e parkimit me pagesë, në bazë të një kontrate të lidhur me Bashkinë Vlorë me një afat një vjecar dhe

pagesa sipas VkB, për 8- muajin e vitit janë lidhur kontrata me 77 subjekte dhe për trajtim janë 10 subjekte të tjera.

Për të bërë të mundur rritjen e të ardhurave nga transporti, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ka bashkëpunuar me Drejtorinë Tatim Taksave, dhe Policinë Bashkiake, po megjithatë këtu ka vend për përmirësime që këto kontrole të jenë më të shpeshta.

Sektori i transportit ka një korespondencë të mirë me institucionet përkatëse si me DRSHTRR Vlorë, MIE dhe institucione të tjera.

Puna në lidhje me qytetaret pathuajse ka qënë e mirë, është gjetur një bashkëpunim i mirë me ta, duke mos patur probleme në këtë drejtim dhe duke bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të tyre.

3- SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Sektori i Infrastrukturës dhe Investimeve Publike përfshin dy sektor, atë të Infrastrukturës dhe Investimeve. Gjatë periudhës 8-mujore janë kontrolluar nga sektori i Investimeve projektet e dorëzuara nga Drejtoria e Urbanistikës, Projekt-buxheti i Bashkisë.

- Janë hartuar proces-verbalet e argumentimit të kriterëve dhe përgatitur gjithë dokumentacioni që i është përcjellë njësisë së prokurimit për të vazhduar me procedurat e prokurimit. Konkretisht janë hartuar dokumentacionet për objektet si më poshtë:
 1. Rikonstrukion i rrugës së fshatit Radhimë
 2. Rikonstrukion i rrugës së fshatit Drithas
 3. Rikonstrukion i rrugës Petro Marko
 4. Rikonstrukion i rrugës Gani Bejkosala
 5. Rikonstrukion i rrugës Ded Gjon Luli
 6. Rikonstrukion i banesave të shtresave në nevojë
 7. Rikonstrukion i shkollës “Hasan Pulo”, “Jani Minga”, tualeteve të shkollave “Ismail Qemali”, “15 Tetori” dhe kopshtit 5, kopshtit Nr.14.
 8. Rikonstrukion i kopshtit Nr.10
 9. Blloku i banesave në lagjen “Partizani”
 10. Rikonstrukion i rrugëve të fshatrave ; Rruga e varrezave në fshatin Cerkovinë, “Petro Llambro” Skrofotinë, rruga e shkollës në fshatin Babicë e Madhe.
- Janë kontrolluar dhe është mbajtur korrespondenca me kontraktorët dhe supervisorët për objektet që janë në fazë punimesh konkretisht:
 1. Rikonstrukion i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”.
 2. Rikonstrukion i rrugëve të brendshme të Njesisë Administrative Orikum.
 3. F.vendosje ndriçimi në qytet
 4. Ndriçim i rrugës “Rruga e Pishave-Zvërnec-Manastir”.
 5. Rikonstrukion i Palestrës së qytetit Multifunkionale Flamurtari.
- Është mbajtur korrespondenca me institucionet dhe popullin për problematika të ndryshme në lidhje me infrastukturën dhe investimet.
- Gjate 4-mujorit, Maj-Tetor 2024 Sektori i Infrastruktures ka ushtruar funksionet e veta dhe në zbatim të kontratave të lidhura ka dorëzuar sheshet e ndërtimit kontraktoreve si më poshte:

1-Dorëzim i sheshit për segmentin rrugor "Ded Gjon Luli"

- 2-Dorëzim i sheshit për segmentin rrugor "Gani Bejkosala"
- 3-Dorëzim sheshi për segmentin rrugor "Petro Marko"
- 4-Dorëzim i sheshit të rrugës ish aks nacional Vlorë-Radhimë --Radhimë
- 5-Dorëzim i sheshit për investimin për përmirësimin e banevesave të shtresave në nevojë

Po ashtu, janë marr në dorëzim investimet si me poshtë:

- Rikonstrukcion i Palestres së qytetit
- Rikonstrukcion i kopshtit Nr.11, ne kuader te eficiences energjetike

Në proces, është marrja në dorëzim e ndriçimit për rrugën e Pishave Zvërnec-Nartë.

Gjatë kësaj periudhe është bërë verifikimi në terren , Korrik-Gusht për gjendjen e institucioneve arsimore të qytetit Vlorë dhe sipas problematikave të vecanta kemi qënë pjesë e grupit të punës për evidentimin e problematikave të konstruksioneve si shkolla 9-vjeçare Llakatundë, etj. pas verifikimit është hartuar raporti dhe i është përcjellë DU.

Gjatë kësaj periudhe, në zbatim të VKB, janë dhënë leje infrastrukturore OSSH dhe Ujësjiellës kanalizimeve sipas problematikave të ardhura në Bashkinë Vlorë.

Është mbajtur korrespondenca me institucionet.

Jemi pjesë e grupeve të punës për inventarizimin e pronave të Bashkisë Vlorë.

4-SEKTORI I PASTRIMIT

Në Njesinë Administrative Orikum nga dt.03.07.2023 shërbimi i pastrimit, realizohet nga kompania "Silver", e cila ka fituar tenderin 1-vjeçar për pastrimin e Njesisë Administrative Orikum me vlerë 23 651 889 (njëzetet e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh, ose 28 382 266 (njëzet e tetë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë me tvsh.

Nga ana e kompanisë realizohen keto shërbime:

1. Largim transport mbeturinash
2. Fshirje e rrugëve
3. Larje e rrugëve
4. Sistemim mbeturinash

Fshirja e rrugëve , trotuareve, shesheve dhe blloqeve të banimit kryhet 1 here ne 24 ore dhe 6 dite jave, ne nje siperfaqe prej 29 000 m² me punetor me fshesa dhe 68400 m² me autofshesë. Zbrazen koshat e vegjel ne shetitore dhe bulevard.

Çdo dite hiqen 10 t mbetje urbane e shperndara ne 200 konteniere ne rreth 120 pika grumbullimi. Mbeturinat hiqen 1 here ne 24 ore pas ores 22:00 ne 7 dite te javes. Gjate sezonit turistik mbeturinat urbane ne 50 pika ne zonen turistike largohen dy here ne dite, per te mos pasur konteniere te tejmbushur. Mbetjet e papranueshme (inerte, elektroshtepiake, krasitje

kopshtesh etj) prane konteniereve qe evidentohen edhe nga Njësia Administrative, largohen nga kompania e pastrimit. Kontrata ka përfunduar në dt.03.07.2024, dhe ky shërbim po kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Gjatë këtij 8 – mujori shërbimi i pastrimit është realizuar sipas kontratës dhe janë paraqitur çdo muaj situacionet e punës së kryer dhe akt kontrollet ditore të mbajtura nga supervizori.

5-SEKTORI I DEKORIT

Një shërbim që i ofrohet qytetarëve është dhe shërbimi i dekorit , me kontratën me objekt “Shërbimi i dekorit të qytetit “, i cili është realizuar nëpërmjet firmës “ **Endri Karaboja**” e kontraktuar nga Bashkia me afat 1(një) vjeçar dhe fond 2 986 900 (dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH,ose 2 986 900 (dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë me TVSH.

Ky shërbim është ofruar për qytetin e Vlorës dhe njësitë administrative që janë në varësi të Bashkisë Vlorë.

Firma “Endri Karaboja” e ka lidhur kontratën në datë 30.11.2023 e vlefshëme deri në 29.11.2024 .

Shërbimi është ofruar për të gjitha festat të cilat janë të parashikuara në kontratë dhe për çdo rast tjetër të kërkuar nga Kryetari i Bashkisë (në rastin e 100 vjetorit te vdekjes së Avni Rustemit në dt.23.04.2024).

Shërbimi i dekorit për këtë kontratë është realizuar,duke paraqitur për çdo muaj situacionet mujore dhe akt-kontrollet të cilat janë mbajtur nga mbikqyrësi i shërbimit në prani dhe të administratorit të firmës kontraktore.

6-SEKTORI I NDRIÇIMIT.

-Ndrichim i ri rruga “Ali Demi”, Lagjja “Partizani”, me llampa ekonomike, shtylla në të dy anët e rrugë, shtrim linje, pra investim total, gjithsej 60 shtylla me llampa Led.

- Rruga “Dush Strati”, Lagjja “Pavarësia”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 40 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Rruga “Jeronin De Rada”, Lagjja “28 Nëntori”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Wat me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 18 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Rruga “Fiqerete Musta”, Lagjja “28 Nëntori”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 13 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara dhe zëvendësimin e një shtylle të dëmtuar(të goditur).

-Rruga “Riza Salati”, Lagjja “Rilindja”, zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçuesa të rinjë Led, gjithsej 17 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara dhe zëvendësimin e dy shtyllave të dëmtuara.

-Rruga "Andrea Varfi", Lagjja "1 Maji", zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 50 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara dhe zëvendësimin e tre shtyllave të dëmtuara.

-Rruga "Miss Durhan", Lagjja "1 Maji", zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 40 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara .

-Rruga "Gjergj Araniti", Lagjja "Pavarësia", zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 80 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Zëvendësim i ndriçuesve Led të dëmtuar në lagjen "Pavarësia", ish-Kombinati, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 30 copë.

-Rruga "Hajredin Dervishi", Lagjja "1 Maji" & Rruga "Osman Haxhiu", Lagjja "24 Maji", zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 25 copë.

-Rruga "Gjon Boçari", Lagjja "24 Maji", zëvendësim i ndriçuesve Led të dëmtuar , me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 40 copë si dhe riparim të linjave të dëmtuara.

-Investim kapital, llogaria ekonomike, 231, në rrugën "Pisha-Zvërnec-Manastir", me vlerë 16.333.800 lekë, pa TVSH, që konstiston në infrastrukturë dhe vendosje të 300 shtyllave metalike me lartësi 8.8m e xinguar me krah 1m .

- Rruga kryesore në fshatin Nartë, Njësia Administrative Qendër, zëvendësim i ndriçuesve 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, gjithsej 70 copë.

-Vendosje e 35 ndriçuesish 250 Watt, llampë inkandeshente, rrugët e brendshme të fshatit Sherishtë, Njësia Administrative Qendër. Po në këtë qendër banimi, jemi në procesë pune për vendosjen e 12 shtyllave metalike (jo të reja, por në gjendje të mirë teknike, të hequra nga rruga "Pilo Begaj", lagjja "28 Nëntori").

-Vendosje të 50 ndriçuesve Led në Orikum, Njësia Administrative Orikum, si dhe vendosjen e ndriçuesve në fshatrat e kësaj Njësie sipas nevojës për zëvendësim, riparim.

-Zëvendësimin e 50 ndriçuesave 250 Watt me llampa inkandeshente, me ndriçues të rinjë Led, në Njësinë administrative Novoselë, rruga kryesore e fshatit Novoselë, aksi i ish-rrugës nacionale.

-Zëvendësimi i ndriçuesave Led të dëmtuar, në rrugët lidhëse që të nxjerrin në shëtitoren Lungomare, "Rushit Gorishova", "Mehmet Agalliu", "Reshat Osmani", Lagjia: "Ujë i Ftohtë", gjithsej 50 copë ndriçues Led.

-Investim kapital "Furnizim-Vendosje ndriçuesh në shëtitoren "Lungomare", në proces prokurimi. Sapo të mbarojnë procedurat ligjore dhe të lidhet kontrata, fillojnë punimet.

Riparime të ndriçuesave 250 Watt-ësh, në qytetin e Vlorës, sipas raportimeve të qytetarëve, apo strukturave të Rajoneve.

Në kuadër të Efiçencës Energjitike, uljes së konsumit të energjisë elektrike, synimi ynë ka qënë vendosje e ndriçimit Led, me kosto më të lartë investimi fillestar, por me kosto mirëmbajtje dhe shfrytëzimi rreth 60% më të ulët se ndriçimi inkandeshent.

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EVROPIAN DHE DIASPORËS

Drejtoria e Projekteve të Huaja Integrimit Evropian dhe Diasporës, bazuar në V.K.M-në Nr. 450, datë 16.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të Integrimit Evropian ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimit Nr.53, datë 23.07.2021 Për një ndryshim në vendimin nr. 101-datë 11.09.2018 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë” do të kryejë në vijmësi detyrat si më poshtë vijon:

Detyrat e drejtorisë do të konsistojnë në realizimin e aktiviteteve të projekteve në proces zbatimi, trajnimeve, aplikimeve, bashkaplikimeve dhe shprehjeve të interesit në partneritet me institucione ndërkombëtare si dhe në bashkrendim dhe koordinim me strukturat e bashkisë për përfshirjen sipas nevojave dhe thirrjeve të donatorit dhe fondeve.

Projektet në zbatim:

1.Projekti “ART4SEA”

Art për detin Melting Art, Creativity and Marine Sciences to foster Ocean Literacy in the Mediterranean area” nga programi Evropa Krijuese, financuar nga Bashkimi Evropian, me një kohëzgjatje 36 muaj, me Partner lider 3D RESEARCH SRL, Itali dhe Bashkia Vlorë si një ndër shtatë partnerët e përfshirë. Ngritja e grupit të punës në zbatim të Projektit “ART4SEA” me nr. 363 prot datë 13.10.2023 “Për disa ndryshime në grupin e punës të zbatimit të procedurave dhe aktiviteteve të projektit Art4sea”. Ngritjen e grupit të punës me Urdhër nr 362 prot datë 13.10.2023 “Për hartimin e termave të referencës për kontraktim eksperti”. Ngritjen e grupit të punës me Urdhër nr 365 prot datë 13.10.2023 “Për hartimin e termave të referencës për kontraktimin e kontratës së shërbimit si dhe hartimin e Procesverbaleve përkatëse dhe vlerësimin e ofertave nga grupi i punës”.

2.Projekti “Mbështetje e komunitetit rom dhe egjiptian nëpërmjet arsimit dhe punësimit në Bashkinë Vlorë”

Mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, OSFA. Synimi i përgjithshëm i këtij projekti është integrimi i qëndrueshëm në tregun e punës të 14 anëtarëve të minoritetit Rom dhe Egjiptian dhe nxitja e frekuentimit të procesit arsimor duke ofruar mbështetje me bursa për 30 nxënës frekuentues të shkollave të arsimit 9-vjeçar në territorin e Bashkisë Vlorë. Ngritja e grupit të punës për zbatimin e procedurave dhe aktiviteteve të projektit “Në

mbështetje të romëve dhe Egjiptianëve në arsim dhe punësim” me numër 374 datë 18.10.2023. Nisja e procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm në bazë të aplikimeve të ardhura në bashki; Hartimi i termave të referencës; Procesverbalet dhe vlerësimin e ofertave; Hartimi i Raportit ”Mbi vlerësimin përfundimtar të kandidatëve pjesëmarrës në konkurim”. Përgatitje dhe shpallje e procedurave të aplikimit për bursat shkollore për nxënësit e shkollave 9-vjeçare në zbatim të projektit.

3.Projekti WRECKS4ALL

Programi i BE, IPA III CBC me titull “Kapitalizimi duke transferuar në territore të reja modelin për mbrojtjen e trashëgimisë nënujore përmes dixhitalizimit dhe valorizimit të tij si një ofertë e re turistike” me partner lider Universitetin e Malit të Zi. Nëpërmjet sinergjisë së programit Interreg, projekti synon: nxitjen dhe përmirësimin inovativ kulturor dhe turistik si një pikë e fortë drejt zhvillimit lokal drejtuar në përmirësimin ekonomik të zonave bregdetare. Ky projekt do të zbatohet përgjatë vitit 2024 dhe Bashkia Vlorë përmes aktiviteteve të parashikuara si partnere, do të përfitojë nga rezultatet kryesore të projektit të tilla si plani i veprimit dhe qasje të re për aksesin publik në trashëgiminë kulturore nënujore. Ngritja e grupit të punës për Vlerësimin e ofertave. Përgatitjen dhe ndjekjen e procedurës për përzgjedhjen e agjensisë në kuadër të aktivitetit të projektit për vizitën në Kotor ku morën pjesë rreth 12 përfaqësues të bashkisë Vlorë.

4.Titull CIRCUS- Programi INTERREG IPA-ADRION

Strategjitë e ekonomisë qarkulluese, planet e veprimit dhe zgjidhjet për tranzicionin e sistemeve agrourbëzore në komunitetet bregdetare të zonës ADRION (Circular economy Strategies, action plans, and Solutions for agrifood systems transition in ADRION coastal communities)

Lead partner- Instituti Agronomik Mesdhetar Bari-Itali, Bashkia Vlorë është partnere.

5.Titulli PREVENT- Programi INTERREG IPA

Reduktimi i ndotjes dhe paralajmërimi i hershëm për ekosistemet vulnerabël në territoret Adriatik-Jon. Projekti trajton sfidën e përbashkët të ndotjes detare në rajonin Adriatiko-Jonian. Kjo sfidë përkeqësohet nga ndryshimet klimatike dhe përbën një kërcënim të konsiderueshëm për rajonin ekosistemet, komunitetet dhe ekonominë. Projekti synon të zhvillojë mjete inovative dhe metodat për zbulimin e hershëm, parandalimin dhe menaxhimin e mbeturinave detare.

6.Titulli “Resiliënca marxhinale – Hartimi i Planit për Vlerësimin e Potencialëve Territoriale të Qarkut Vlorë.

Promovimi i politikave të orientuara drejt zhvillimit që mbështesin aktivitetet produktive, krijimin e vendeve të punës, sipërmarrjen, kreativitetin dhe inovacionin, dhe inkurajojnë formalizimin dhe rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, gjithashtu përmes aksesit në shërbimet financiare. Urdhri i brendshëm me nr.69 datë 18.03.2024 “Për ngritjen e grupit të

punës për hartimin e termave të referencës dhe vlerësimit të ofertave për prokurimin për punime infrastrukture dhe pajisje”

Shkresat për informacion dhe raportime:

1. Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën nr 8775 prot datë 05.06.2024 Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe konkretisht specialistit të rinisë në lidhje me aktivitetet që drejtorja ka organizuar me të rintjë.
2. Komunikim mbi rishikimin e planit të transparencës për të cilat drejtorja është vënë në dijeni në lidhje me publikimin dhe përditësimin e informacionit për drejtorinë në faqen zyrtare.
3. Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën nr 8775 prot datë 05.06.2024 Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe konkretisht specialistit të rinisë, vënë në dispozicion nga koordinatori për Njoftim dhe Konsultim publik.
4. Në kuadër të ngritjes së grupit të punës për programin e transparencës është dërguar shkresë në DBNJ për publikimin në faqen zyrtare të internetit të procesverbaleve të konsultimeve publike.
5. Analizë e punës për hartimin e planit të integritetit të Bashkisë Vlorë nga Koordinator i Njoftimit dhe Konsultimit publik.
6. Mbyllja e raportimit dhe hedhja në sistem e informacionit të vëna në dispozicion nga drejtoritë përkatëse në kuadër të vlerësimit të performancës së Bashkisë për vitin 2023 që drejtorja ka bërë te AMVV-ja.
7. Raportime mujore në kuadër të Urdhrit të Brendshëm nr. 76 datë 28.03.2024 te nënkryetri Bashkisë.
8. Njoftimi dhe konsultimi publik për planifikimin e buxhetit afatmesëm 2025-2027 si dhe buxheti i vitit 2025 të Bashkisë Vlorë në datat 09-13 shtator 2024.

Aktivitete ndërgjegjësuere/informuese të realizuara dhe trajnime:

Janar

Urdhër pune në komisionin për vlerësimin e aplikimeve për “30 bursa shkollore të nxënësve nga Komiteti Rom dhe Egjiptian”

Shkurt 2024

Trajnim me temë “Ngritje kapacitetesh mbi menaxhimin e fondeve IPA II dhe IPA III.

Trajnim i organizuar nga ASPA dhe projekti “Bashkitë për në BE” me temë “Rregullat e procedurave të prokurimit dhe kushtet e kontratës”

Trajnim i organizuar nga ASPA dhe projekti “Bashkitë për në BE” me temë “Rrugëtimi drejt një shkrimi të suksesshëm sipas ciklit PCM”

Mars 2024

-Pjesëmarrje në sesion informues në kuadër të thirrjes së parë për project propozime për programin Interreg –Shqipëri 2021-2027 të organizuar nga SASPAC.

-Pjesëmarrje në tryezën me temë “Gruaja, paqa dhe siguria “

Prill 2024

-Pjesëmarrje në seminarin e organizuar nga shoqata “Internacionale për solidaritetin (SHIS) me titull “Promovimi i edukimit gjithëpërfshirës përmes edukimit të kombinuar për nxënësit Rom dhe Egjiptian “në Bashkinë Vlorë.

-Takim online në kuadër të aktiviteteve aktuale dhe të planifikuara për objektivat specifike të subgranteve në kuadër të projektit në zbatim “Mbështetja me bursa dhe punësim për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian.

-Pjesëmarrje në aktivitet për prezantimin e draft planit të përshtatjes klimaterike për Bashkinë Vlorë organizuar nga “UNDP”

-Pjesëmarrje në seminarin e parë të projektit “WRECKS4ALL” në të cilën Bashkia Vlorë është partnere, organizuar në Kotor.

Maj 2024

-Në kuadër të ngritjes së grupit të punës për programin e transparencës ku Albana Naci është pjesë, është dërguar shkresë në DBNJ për publikimin në faqen zyrtare të internetit të procesverbaleve të konsultimeve publike.

-Analizë e punës për hartimin e planit të integritetit të Bashkisë Vlorë nga Albana Naci si Koordinatore e Njoftimit dhe Konsultimit publik.

-Mbyllja e raportimit dhe hedhja në sistem e informacionit të vëna në dispozicion nga drejtoritë përkatëse në kuadër të vlerësimit të performancës së Bashkisë për vitin 2023.

-Aktivitet “Shkolla pranverore: Përmirësimi i shërbimeve në nivel lokal për të rinjtë dhe kontributi i tyre në Komunitet” (pjesëmarrës nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Vlorës). 9-10-11 Maj.

-Trajnim online në kuadër të thirrjes për Programin INTERREG EUROPE 2021-2027 organizuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) në bashkëpunim me Sekretariatit e Përbashkët, në datën 16 Maj.

-Pjesëmarrje në eventin kombëtar në Tiranë, “Aftësi për të gjithë” organizuar nga Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile për Javën e Shoqërisë Civile në datën 29 Maj.

-Pjesëmarrje në trajnimin në Vlorë me temë “Higjena Kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë” i organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit me qëllim njohjen me parimet bazë të sigurisë kibernetike dhe mënyrat për një përdorim të sigurt të internetit në datën 30 Maj

Qershor 2024

-Pjesëmarrje në konferencën për të drejtën e informimit të organizuar në Tiranë në datën 26.06.2024.

-Takim informues në Tiranë në kuadër të thirrjes për projekt propozime për projekte standarte në kuadër të Programit Interreg IPA South Adriatic (Itali – Shqipëri – Mali i Zi) 2021 – 2027 në datën 10 Qershor.

-Pjesëmarrje në aktivitet me temë: Tryezë konsultative e Bashkive për çështjet e Diasporës dhe Migracionit të organizuar në datën 26.06.2024, në Vlorë.

Korrik

-Pjesëmarrje në tryezën e parë të rumbullakët ndër-institucionale për arsimin gjithpërfshirës 9 Korrik 2024.

-Pjesëmarrje në seminarin e parë për programin e punëve publike në komunitet 11 korrik 2024.

Pjesëmarrje në aktivitetin prezantues të projektit, ËRECKS4ALL në Lecce, Itali. Vlerësimi i dixhitalizimit, inovacionit për trashëgiminë kulturore.

Gusht

Pjesëmarrje në trajnimin “Më shumë mundësi arsimimi dhe punësimi për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian në Bashkinë Vlorë”

Projekt aplikime në kuadër të thirrjeve për projekt propozime nga donator të ndryshëm

Aplikim në kuadër të thirrjes për grante për shërbime shoqërore me bazë komunitare nga Agjencia Kombetare e Rinisë

- Shprehje interesi për partneritet në kuadër të thirrjes IPA CBC disa bashkive të Greqisë
- Shprehje interesi për partneritet dhe asistencë në kuadër të thirrjes Adrion.

Detyra të tjera sipas Urdhrave të Brendshëm:

- 1.Ndjekje e procedurave të kërkesave për informacion drejtuar Bashkisë Vlorë
- 2.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm me nr. 81-datë 03.04.2024 “Për krijimin e komisionit të Bashkisë Vlorë për marrjen në dorëzim të dosjeve të Drejtorisë së Aseteve dhe Inventarizimi e dorëzimi i tyre.
- 3.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm me nr.473 datë 26.12.2023 “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të sektorit të prokurimeve”.
- 4.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm nr 218 datë 14.06.2024”Mbi krijimin e grupit të punës për zbatimin e rishikimit të programit të transparencës të Bashkisë Vlorë”.
- 5.Zbatimi i detyrave të përcaktuara në Urdhrin e Brendshëm nr 200 datë 06.06.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të Integritetit.

Matrica (Raporti i vlerësimit të performances për vitin 2024)

Me iniciativë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, realizon procesin e përvitshëm të vlerësimit të ecurisë së bashkive në drejtim të përmbushjes të detyrimeve në kuadër të kritereve politike, ekonomike dhe standardeve që lidhen me integrimin evropian duke hartuar raportin vjetor “Bashkitë në Procesin e Integritit Evropian të Shqipërisë”. AMVV-ja gjithashtu harton raportin e zbatimit të projekteve të financuara nga donatorët dhe të zbatuara nga bashkitë, i cili synon të prezantojë kapacitetet e bashkive në drejtim të aksesit të financimeve të huaja dhe të ofrojë transparencën lidhur me financimet e huaja në nivelin vendor.

Raportimi i performancës së drejtorive dhe sektorëve në bashki u realizua Brenda afateve së bashku edhe me të dhënat për procesin i aplikimit të bashkisë Vlorë në kuadër të thirrjeve të

shpallura nga ministritë dhe agjensitë qendrore. Hedhja e të dhënave u krye on-line nga Drejtoria e Integrimit Evropian nga informacioni i mbledhur nga drejtoritë nëpërmjet sistemit që Agjensia menaxhon me mbështetjen e Projektit “Bashkitë për në Evropë” të financuar nga Bashkimi Evropian.

DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtorja e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social në bashkinë e Vlorës ka në fokus tek shërbimet e kujdesit shoqëror nevojat sociale në rritje të kategorisë së grupeve në vështirësi ekonomike për të gjithë komunitetin, të jenë të mbuluara me shërbime ekzistuese dhe shërbime të reja sociale, për të qënë sa më pranë qytetarëve sipas modeleve dhe praktikave më të mira bashkëkohore.

Shërbimet ofrohen në përputhje me standartet dhe kornizën ligjore të shërbimeve sociale duke u bazuar në qasjen me individin , si prioritar në qendër të cdo shërbimi, duke ngritur një sistem të balancuar shërbimesh sociale të cilat do të kenë në fokus target grupet në nevojë, duke synuar një mbulim më të mirë të nevojave të tyre, një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të kujdesit shoqëror, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese dhe ndërtimit të shërbimeve të reja.

Sektori Financë-Statistikë

Numri i familjeve përfituesve në vështirësi ekonomike nga të ardhurat e bashkisë ka qënë afërsisht rreth 29 familje në muaj me një fond 4-mujor prej 827.500 Lek ne .

Emërtimi	Përfitues të ndihmes ekonomike 8-mujor 2024	
	Numër	Lekë
Bashkia	18	496.500
Njesia Shushice	2	72.000
Njesia Qendër	3	108.000
Njesia Novosele	3	91.000
Njesia Orikum	3	60.000
TOTALI	29	827.500

Ndërsa për numrin e përfituesve të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nga **fondi i kushtëzuar 6%** janë trajtuar 23 familje me një fond 516.833 .

Emërtimi	Përfitues te ndihmes ekonomike 8-mujori 2024	
	Numër	Lekë
Bashkia	23	516.833
TOTAL	23	516.833

Pagesat për të gjitha këto kategori e personave me aftësi të kufizuara kanë vazhduar pa ndërprerje edhe për personat që kanë mbaruar afatin e komisionimit për të mos krijuar probleme sociale dhe konkretisht:

Emërtimi	P.A.K + kujdestarë		Tetraplegjik+ kujdestarë		Verbëri kujdestari		Invalid		Total	
	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek	Nr.	000/Lek
P.A.K 24	1.928	162.183	553	98.145	661	85.272	2381	60.645	5523	406.245

NJËSIA E MBROJTJES DHE TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Për periudhën Janar-Gusht 2024, ka menaxhuar në total 81 raste dhe 44 janë raste të reja të fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipas problematikave si vlerësime social-ekonomike të familjes për monitorim të rastit, për vendosje në kujdestari alternative, raste të fëmijëve në konflikt me ligjin. Janë zhvilluar në total 22 vizita në banesë, 10 mbledhje të grupit teknik ndërsektorial. Janë zhvilluar takime të vazhduara 2 të shtuna në muaj mes nënës Sado Selmani me vajzën Nadia Selmani në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit.

Grupmosha e fëmijëve në nevojë për mbrojtje rezultojnë të jetë 0-3 vjeç. Sipas nivelit janë klasifikuar 30 raste me rrezikshmëri të mesme, 47 me rrezikshmëri të ulët dhe 4 raste me rrezikshmëri të lartë. Me vendim të Këshillit Bashkiak janë përfshirë 21 fëmijë në programin e kopësht dhe ccerdhe falas. Në bashkëpunim me Shërbimet Mbështetëse për fëmijën dhe familjen dhe SOS fshatrat e fëmijëve janë organizuar 10 ditë kamp veror për fëmijët. Pjesëmarrja e anëtarëve të GTN ka qenë e rregullt dhe janë marrë përsipër gjithë detyrimet e lëna për rastet e trajtuara.

Janë marrë masa për identifikim e fëmijëve në situatë rruge apo lypjeje nëpërmjet 5 skuadrave të terrenit që kanë funksionuar në periudhën maj-shtator , në bashkëpunim me qendrën Psikosociale Vatra dhe SHMFF.

NËPUNËSI PËR ÇËSHTJET E BARAZISË GJINORE

Për periudhën Janar-gUSHT 2024, nëpunësi i barazisë gjinore ka asistuar në mbështetje me shërbim sociale si dhe asistim në vlerësimin e nevojave të rasteve sociale si dhe referim pranë institucioneve ofruese shërbimesh falas. Ka qene pjesëmarrës në të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak. Nëpunësi gjinor ka qene pjesëmarrës edhe në tryezat konsultative mbi çështjet e barazisë gjinore, si dhe pjesëmarrës në trajtime të ndryshme nga OJF-të me fokus barazinë dhe drejtësinë gjinore. Ka asistuar në seanca gjyqësore në bashkëpunim me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve, për çështjet e fëmijëve me problematika socio-ekonomike si dhe ka asistuar në vlerësimet e nevojave të rasteve të dhunës në familje në bashkëpunim me Koordinatorin Vendor të Dhunës dhe ka qënë pjesëmarrës aktiv si në ETN ashtu dhe ne GTN e realizuara mbi çështjet e ndryshme dhe problematikat sociale të paraqitura pranë DNSHS-së.

NJËSIA E VLERËSIMIT DHE REFERIMIT TË NEVOJAVE TË RASTIT

Për periudhën Janar- Gusht 2024, Njesia e Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve ka zhvilluar një sërë aktiviteteve si:

Grupi Teknik Ndërdisciplinor është mbledhur tre herë për menaxhim rastesh të kategorisë së moshës së tretë dhe të personave me Aftësi të Kufizuar. Gjithashtu ka qene pjesemarrëse ne GTN/ETN e ngritura nga NJMF dhe KVDH.

Janë realizuar 50 vlerësime nevojash në bashkëpunim me koordinatorin vendor të dhunës në familje.

Janë realizuar 17 vlerësime nevojash në bashkëpunim me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve për rastet e fëmijëve me problematika sociale si dhe monitorimet përkatëse.

Janë realizuar 120 vlerësime nevojash të familjeve të cilët janë përfthues të sistemit Digjital të Ndihmës Ekonomike në rajonet e bashkisë Vlorë dhe Njësitë Administrative.

Specialisti i Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të nevojave ka qënë pjesëmarrës në trajnimet të ndryshme të zhvilluara nga Organizatat e shoqërisë civile.

NJËSIA PËR ÇËSHTJET KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Nga Koordinatorin Vendor i Dhunës në Familje për periudhën 8 mujore janar-gusht 2024 janë trajtuar gjithsej 96 raste në formën e vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë, përfshirë UMM-të dhe UM-të të paraqitura pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social, bashki. Këto raste dhune janë menaxhuar në bashkëpunim me Ekipin Teknik Ndërdisciplinor dhe në koordinim të përmirësuar mes aktoreve të këtij grupi, ku janë marrë edhe masat përkatëse për mbështetjen e plotë të viktimave.

Për periudhën janar-gusht 2024 janë realizuar 3 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor të dhunës në familje.

Rastet e paraqitura si me vendim gjykate ashtu edhe të vetëreferuara pranë Njesisë së Çështjeve Kundra Dhunës në Familje, janë menaxhuar në bashkëpunim me koordinatoren vendor dhe me antarët e Ekipit Teknik Ndërsektorial, duke u ofruar rasteve të dhunës, shërbime ligjore dhe psikologjike falas, shërbime këshillimi për burrat e dhunshëm në bashkëpunim me punonjës të Qendrës Psikosociale Vatra.

Rastet e pajisura me UM janë trajtuar me ndihmë ekonomike në masën 9900 lekë, duke kryer njëkohësisht monitorimet përkatëse në bashkëpunim me policinë vendore Vlorë, si dhe stafin e shërbimit Social, ndërmjetësim për punësim, informim dhe këshillim mbi të drejtat që ka një viktimë dhune në bazë të ligjit përkatës, si dhe ndërmjetësim për akomodim pranë strehëzave rezidenciale përkatëse.

- Gjatë periudhës Janar- Gusht 2024 çdo rast dhune është trajtuar me përparësi, sipas nevojave të identifikuara me bashkëpunimin e ngushtë të gjithë anëtarëve të MKR-së, si dhe janë monitoruar rastet me Urdhër Mbrojtje duke vlerësuar dhe adresuar nevojat e rastit.
- Gjatë periudhës Janar- Gusht 2024 janë drejtuar në mënyrë të vazhdueshme UMM-të prej gjykatës pranë zyrës së Shërbimit Social. Çdo rast dhune i paraqitur pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social ose çdo rast i referuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë është kontaktuar dhe është bërë vlerësimi i nevojave nëpërmjet një intervistimi mes koordinatorit të dhunës, punonjësit social të vlerësimit të nevojave si dhe viktimës.
- Pasi është vlerësuar nevoja e çdo rasti dhune, koordinatori ka informuar viktimën dhe e ka referuar në institucionet përkatëse.
- Gjatë periudhës Janar- Gusht janë referuar 90 raste dhune pranë Klinikës Ligjore “Vatra”
- Grate dhe vajzat janë target grupi më i marginalizuar nga fenomeni i dhunës.
- Statusi civil më i prekur nga fenomeni i dhunës në familje janë të martuar, më pas renditen kategoria e personave të divorcuar, si dhe dhuna e ushtruar në marrdhënien prind-fëmijë dhe më pak bashkëjetuesit.
- Niveli arsimor i ulet ka qenë më i prekur prej fenomenit të dhunës në familje dhe me pas niveli arsimor i mesëm kurse niveli arsimor i lartë ka qënë më pak i prekur prej dhunës për vitin 2024.

Aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen gjatë periudhës Janar - Gusht 2024.

Shërbimet bazë	Shërbimet e detajuara
Shërbime të kujdesit shoqëror si: monitorim i mirëqënies së qytetarit dhe lobim për realizimin e të drejtave të qytetarëve.	Takime me aktorë vendorë në lidhje me respektimin e të drejtave të qytetarëve dhe

	<p>sigurimin e aksesit në rrjetin e shërbimeve në komunitet:</p> <p>Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve (68 takime)</p> <p>Koordinatori Vendor për Dhunën në Familje (19 takime)</p> <p>Psikolog në Polici (18 takime në komisariat dhe 8 takime në GTN)</p> <p>Punonjës të shëndetësisë (35 takime, kryesisht e pediatër e mjek familje)</p> <p>Administratoret e Rajoneve dhe Njësive Administrative (63 takime)</p> <p>Zyra e punës (5 takime)</p> <p>Shërbimi Social Shtetëror Rajonal (8 takime)</p> <p>Zyra e Emigracionit (0 takime)</p> <p>Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (1 takime)</p> <p>Zyra arsimore (15 takime)</p> <p>Zyra për kopshtet e çerdhet (15 takime)</p> <p>Gjykata e Shkallës së parë, Vlorë (10 takime)</p> <p>Shoqërim i fëmijëve nga kujdestaret (95 shoqërim)</p>
<p>Shërbime të fuqizimit individual e familjar: administrativ dhe ekonomike</p>	<p>Vlerësim i thelluar i nevojave të individit/familjes (18 familje)</p> <p>Plan fuqizimi individual/familjar (18 plane fuqizimi familjarë)</p> <p>Orientim-shoqërim dhe advokim në institucione të ndryshme përmendura në pikën 1, në funksion të përmbushjes së planit të fuqizimit dhe plotësimit të nevojave.(rreth 220- takime në total me të gjitha institucionet</p>

	<p>e nevojshme në kuadër të përmbushjes së planit të fuqizimit të familjeve dhe menaxhimit të rasteve)</p> <p>Këshillime psikologjike; fëmijë (14 raste dhe 72 orë këshillimi) dhe të rritur (21 raste 88 orë këshillimi).</p> <p>Mbështetje direkte(paketa ushqimore-0 pako, veshmbathje-higjeno-sanitare 0 pako)</p> <p>Aktivitete për fëmijë me grupe të vogla realizuar në zyrat e SHMFF (75 fëmijë) dhe të rritur (3 aktivitete me grupe më të vogla me 5 gra pjesëmarrëse)</p> <p>Në total familjeve u janë ofruar shërbime të integruara që kanë ndikur në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rritjen e mirëqënies së fëmijëve e familjeve dhe parandalimin e institucionalizimit.</p>
<p>Shërbime të specializuara si kujdestaria në familje, psikoterapeutë, mësues special, logoped, fizioterapistë etje.</p>	<p>Shërbimi i specializuar që është ofruar është ai i kujdestarisë në familje me shërbimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> -organizimi i një rutine ditore të shëndetshme (3 familje) -asistim i nënës në kujdesin për foshnjën (0 familje) -Shoqërim në cerdhe-shkollë të fëmijëve(3 fëmijë) -shërbime për të plotësuar nevojat e përditshme të të moshuarvve.(2 familje) <p>Shërbimi i Logopedisë: – kanë marrë shërbim logopedie falas 6 fëmijë.</p> <p>Shërbimi i fizioterapisë: – kanë marrë shërbim fizioterapie falas 4 fëmijë.</p>

	Klasa pas shkolle: MUAJI JANAR: 13 fëmijë MUAJI SHKURT : 13 fëmijë MUAJI MARS : 10 fëmijë MUAJI PRILL : 11 fëmijë MUAJI MAJ: 7 fëmijë MUAJI QERSHOR: 0 fëmijë MUAJI KORRIK : 0 fëmijë MUAJI GUSHT : 0 fëmijë
Klasa prindërimi- këshillim mbi prindërimin pozitiv	Është ofruar këshillim për prindërimin pozitiv gjatë gjithë kohës sipas nevojës.(10 familje)
Qendër burimore për dhënien e informacionit, ofrimin e trajnimeve, mentorim drejt plotësimit të nevojave dhe shërbime të specializuara.	Bazuar në hartën e shërbimeve sociale janë orientuar përfituesit drejt shërbimeve për të cilat anë patur nevojë, duke iu dhënë informacionin dhe orientimin e duhur.

- Numri i përfituesve në total për periudhën Janar-Gusht 2024

Tabela statistikore e SHMFF për periudhën janar-gusht 2024		
Numri i familjeve të trajtuara	Kategoria	Numri i përfituesve
76	Fëmijëve të institucionalizuar dhe familjeve të tyre	1
	Familjeve në nevojë për shërbime shoqërore	76
	Fëmijëve në rrezik institucionalizimi	12
	Familjeve kujdestare dhe fëmijëve të vendosura në to	3
	Të moshuarit	9

- **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**

Misioni që ka Drejtoria e Mbrojtjes Civile për realizimin e detyrave synon në krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar përgatitur përballuar fatkeqësitë dhe për tu rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë elementet kryesor që përshkojnë planin për të bërë të mundur shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese.

Plani i Mbrojtjes Civile për Bashkinë Vlorë është i zbatueshëm për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, për përgatitjen, përgjigjen, rikthimin në gjendje normale dhe lehtësimin e pasojave në popullsi.

Sipas eksperiencës në vite Bashkia Vlorë vlerësohet si një rajon i mundshëm për një numër të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore ose veprimtaria njerëzore. Rreziku më i madh në Bashki nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tërmete të rëndë, përmbytjet, rrëshqitjet e tokës.

Baza ligjore ku mbështetet puna e D.M.C është ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe VKM Nr. 329 data 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Për periudhën 01.01 2024 - 31.08.2024 D.M.C ka verifikuar rreth 45 ankesa qytetarësh që kanë të bëjnë me problematika të ndryshme.

Disa prej ankesave kanë qënë djegje në banesë nga shkaqe të ndryshme të cilat janë verifikuar më pas u janë plotësuar dosjet me dokumentacionin përkatës duke bërë të mundur dëmshpërblimin financiar nga Bashkia Vlorë.

Gjatë vitit 2024 D.M.C ka bashkëpunuar me Institutin e Ndërtimit për rastet e Ëngjellush Rama, Erald Koka.

Në periudhat e rreshjeve me intensitet të lartë kemi hasur me problematika si shkarja e dherave dhe të inerteve, ku sëbashku me Ndërmarrjen e Shërbimeve është bërë e mundur hapja dhe qarkullimi i mjeteve.

Erërat e forta dhe stuhitë e erës kanë sjellë problematike me rënien e pemëve duke bllokuar rrugët, si në zonën e Orikum-Dukat si dhe në pyllin e sodës. Në bashkëpunim me Drejtorin e Pyjores është bërë e mundur prerja e pemëve dhe hapja e rrugës.

Për vitin 2024 D.M.C në bashkëpunim me M.Z.SH, Ndërmarrjen Pyjore dhe Policinë Bashkiake kemi hartuar Planin e Masave për Parandalimin e Zjarreve për periudhën pranverë 2024.

Në bazë të planit D.M.C ka zhvilluar takime sensibilizuese në Qendrat Administrative Orikum, Novosel, Qëndër dhe Shushucë.

Në këto takime ka pas përfaqësues nga Policia e Shtetit, Ndërmarrja Pyjore, M.Z.SH, si dhe Kryepleqtë e Fshatrave.

Në bazë të urdhërit të brëndshëm Nr.423prot datë 17.11.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë "Mbi ngritjen e grupit të punës për menaxhimin në vend-grumbullimin e mbetjeve urbane" Specialistët e D.M.C monitorojnë në orare të ndryshme gjatë ditës vend-grumbullimin e mbetjeve duke bërë të mundur eliminimin në kohë të vatrave të zjarrit.

Në datë 01.07.2024 mbasë marrjes së njoftimit për zjarr në zonën e Radhimës specialistët e D.M.C shkuan me urgjencë në vendin e zjarrit dhe në bashkëpunim me M.Z.SH bënë të mundur fikjen.

Datë 04.07.2024 rreth orës 16:30 u morrë njoftim për zjarr në zonën e Llogorasë pjestarët e D.M.C shkuan dhe në bashkëpunim me M.Z.SH, Zonat e Mbrojtura dhe me Ndërmarrjen e

Pyjores u bë e mundur vënia në kontroll dhe fikja e zjarrit rreth orës 01:00 dhe deri në orët e para të mëngjesit u mbajtë në kontroll nga M.Z.SH dhe D.M.C

Në datë 25.07.2024 ora 14:58 Drejtoria e Mbrojtjes Civile mori njoftim për vatër zjarri në vend-grumbullimin e mbetjeve të qytetit nga shërbimet zjarrëfikse me anë të telefonit. Në orën 15:00 specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes Civile të Bashkisë Vlorë shkuan në vend, u konstatua se zjarri kishte përmasa të mëdha dhe situata ishte tepër e rëndë për shkak dhe të erës së fuqishme e cila ndihmonte përhapjen e zjarrit dhe vërshtironte punën për fikjen e tij.

Në vend ishin duke punuar 3 mjete zjarrëfikse me personelin përkatës (10 veta) si dhe 2 mjete të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Volvo me zinxhir dhe fadroma e madhe me goma. Duke qënë se zjarri kishte përmasa të mëdha situata ishte e rëndë dhe nuk mund të përballohej vetëm nga shërbimet zjarrëfikse, personeli i Emergjencave Civile si dhe mjetet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, u vendosë të kërkohej ndihmë tek bizneset që ushtrojnë aktivitetet në qytetin e Vlorës.

Në vend-grumbullimin e mbetjeve rreth orës 18:00 erdhi z.Taulant Duka me një mjet me zinxhir sëbashku me manovratorin e tij dhe filluan punën për fikjen e zjarrit. Ndërkohë nga firma 2A që punon për ndërtimin e aeroportit të Vlorës erdhën 4 kamiona vetëshkarkues dhe 1 mjet me zinxhir. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Vlorë filluan punën dhe 2 kamiona 1 me dy akse dhe 1 me katër akse si dhe 2 skrepa me goma të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Rreth orës 20:00 mbasi u riparua me urgjencë filloi punën buldozieri i madh me zinxhir i z.Vladimir Deda.

Duke qënë se situata nuk po vendosej në kontroll dhe zjarri po përparonte në fushën e mbetjeve dhe tymi i çliruar nga mbetjet përbënte problem për qytetin u njoftua përgjegjesi i Mbrojtjes Civile në Prefekturë i cili këtë problematikë e raportoi në Drejtorin e Përgjithshme të Mbrojtjes Civile të cilët i bënë kërkesë Forcave të Armatosura për eskavator me zinxhir dhe kamiona.

Rreth orës 24:00 në zonën veri-perëndim të mbetjeve zjarri morri përmasa të mëdha dhe rrezikoheshin banesat që ndodheshin aty pranë. Në këtë zonë u instaluan menjëherë 2 mjete zjarrfikse të cilat për rreth 1 orë bënë të mundur uljen e zjarrit dhe largimin e rrezikut nga banesat. Për të garantuar sigurinë e banesave gjatë natës aty u qëndrojë 1 mjet zjarrfikës për të eliminuar ndonjë përhapje të mundëshme të zjarrit.

Datë 26.07.2024 rreth orës 06:30 filloi përsëri puna për fikjen e zjarrit ku përveç mjeteve që filluan punën në datën 25.07.2024 erdhën në ndihmë 2 kamiona vetëshkarkues të firmës Hanxhari si dhe 4 kamiona vetëshkarkues dhe 1 traktor i madhë me zinxhir i firmës Ankor.

Në datë 26.07.2024 u mbajt kontakt me mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe u bë i mundur shoqërimi i tyre pranë pikës së mbetjeve rreth orës 18:00, të cilët përbëheshin nga 2 kamiona vetëshkarkues dhe 2 buldozier me zinxhira. Në ndihmë erdhi dhe 1 mjet zjarrfikës i Alpetrol Fier si dhe 2 auto-bote të ujësjellsit përkatësisht 16 dhe 7 ton ujë secili. Nga firma Salillari erdhën dhe 3 mjete të cilët sollën material inert që u përdorën për stabilizimin e rrugës ku kalonin mjetet e tjera. Puna vazhdoi deri në orën 23:00 dhe qëndroj 1 mjet zjarrfikës në gatishmëri për ndonjë rrezik të mundshëm.

Datë 27.07.2024 ora 07:00 filloi përsëri operacioni për fikjen e zjarrit dhe kthimin në normalitet të situatës. Përveç mjeteve që punuan gjatë datës 25 dhe 26 korrik u shtuan 1 kamion dhe 1

skrep me goma nga Ministrisë së Mbrojtjes, po kështu nga bizneset që operojnë në qytetin e Vlorës u dërguan 2 kamiona vetshkarkues nga z.Ardian Skëndaj si dhe 2 kamiona të tjerë nga z.Flamur Isufi. Nga zoti Agron Hysenaj u sollën 6 kamiona vetshkarkues me inerte të cilat u përdorën për sistemimin e rrugës për të kaluar mjetet, po kështu nga firma Alb-Son u sollën 2 kamiona me lënd inert.

Megjithëse me kushte tejet të vështira, temperatura e lartë dhe tymi toksik i çliruar nga mbetjet, të gjithë personat dhe strukturat e angazhuara të Bashkisë Vlorë, në ndihmë erdhi dhe 1 zjarrëfikës i Alpetrol Fier dhe bizneset që operojnë në Bashkinë Vlorë punuan me intesitet të lartë dhe punë e pandërprerë duke bërë që zjarri të vihej në kontroll dhe vatra e zjarrit të zvogëlohej së tepërmi si dhe reja toksike të zvogëlohej në maksimum.

Datë 28.07.2024 ora 07:30 filloi përsëri puna me të gjitha mjetet e ndodhura dhe të ardhura në ndihmë për fikjen e zjarrit të cilave ju shtuan dhe 4 mjete nga z.Elidon Xhaferri. Ka vazhduar mbushja dhe shpërndarja me inerte nga fadromat dhe kamionat për të bërë të mundur izolimin e plotë të vatrave të zjarrit dhe të tymit. Puna vazhdoi pa ndërpreje deri në orën 20:00.

Datë 29.07.2024 ora 07:00 rifilloi puna për mbylljen përfundimtare dhe izolimin e plotë të vatrave të zjarrit dhe të tymit. Gjatë gjithë ditës u operua për kapsulimin e vatrave të zjarrit me dhera dhe inerte të cilat vazhduan pa ndërpreje gjithë ditën.

Në orën 18:15 vatra e zjarrit u mbyll, rreth orës 20:00 mjetet e ardhura në ndihmë u larguan nga pika e mbetjeve.

Në pikën e mbetjeve qëndroi 1 mjet zjarrfikës në gatishmëri për çdo situatë që mund të ndodhi.

Datë 30.07.2024 ora 08:00 mjetet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, mjetet e Ministrisë së Mbrojtjes si edhe 3 mjete nga kompania A2 vazhduan punën për të bërë kapsulimin e plotë të vatrave të vogla që mund të kishin mbetur si dhe depozituan material inert në fushën e mbetjeve me qëllim vazhdimin e punës për të shmangur çdo lloj aktivizimi të vatrave sa do të vogla që mund të ishin.

Në orën 14:00 mjetet e Ushtrisë si dhe mjetet e kompanisë A2 u larguan nga pika e mbetjeve. 2 skrepat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe manovratori i firmës Duka sëbashku me mjetin e tij janë duke punuar për normalizimin e situatës dhe mbajtjen në kontroll.

Gjithë ky operacion i vështirë për fikjen e zjarrit dhe kthimin në normalitet tek vend-grumbullimi i mbetjeve u ndoq nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha, Zv/Kryetari Klevis Kaso si dhe nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Policia Bashkiake me të gjitha strukturat përkatëse.

Për kryerjen e misionit dhe detyrave që ka D.M.C hasë vështirësi pasi ka mungesë të theksuar mjeteve dhe bazë materiale.

	Bashkia	Emër Mbiemër	Fatkeqësia	Vlera e dhënë
--	---------	--------------	------------	---------------

Nr				
1	Vlorë	Renato Sullaj	Djegje në banes	202.735
2	Vlorë	Shpresa Barjamaj	Djegje në banes	298.289
3	Vlorë	Jurgen Loli	Djegje në banes dhe humbje jete	1.184.826
4	Vlorë	Kristaq Piperi	Djegje në banes	1.014.163
5	Vlorë	Denis Izetaj	Përmbytje banese	135.993
6	Vlorë	Rivaldo Hekurani	Përmbytje banese	84.200
7	Vlorë	Engjëll Kolila	Djegje në banesë	241.032
8	Vlorë	Bardhyl Meli	Djegje në banesë	982.698
9	Vlorë	Robert Shëllegaj	Djegje në banes	611.514
10	Vlorë	Evisa Mamushi	Djegje në banesë	271.584
11	Vlorë	Sose Zhezha	Djedie në banesë dhe humbje jete	541.105
12	Vlorë	Aleksandër Kamberaj	Djegje në banesë	501.465

DREJTORISË SË BASHKËQEVERISJES

Prej periudhës Janar – Gusht 2024, pranë Drejtorisë së Bashkëqeverisjes janë realizuar detyrat e mëposhtme:

Për Drejtorinë e Urbanistikës janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për planin e përgjithshëm vendor, kopje dokumentacioni të sistemit e-leje.

Për Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për shpronësime, për konfirmime të kufitarëve në lidhje inventarin e pronave të paluajtshme.

Për Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, dokumentacion për leje transporti, për leje vendparkimi, për rinovim leje karburanti, autorizime të ndryshme. Janë marrë kërkesa të qytetarëve për bonus qiraje (subvencionimi i qirasë), për procedura privatizimi, për ndriçim.

Në lidhje me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion/dokumentacion, ankesa për cënim prone, ndërtime pa leje.

Për Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion në lidhje me buxhetin, konfirmime dokumentesh.

Për Drejtorinë Juridike janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion dhe vërtetime

Për Drejtorinë e të Ardhurave Vendore janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për rishikim të taksave vendore, për shfrytëzim të hapësirës publike me qëllime biznesi, dorëzim të fletëve të regjistrit të subjekteve hoteliere.

Për Sektorin e pyjeve dhe kullotave, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion/dokumentacion si dhe autorizim për ndërhyrje në fondin pyjor.

Për Drejtorinë Burimeve Njerëzore, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për kopje dokumentacioni nga arkiva, aplikime për punësim dhe vërtetime.

Për Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimit Social, janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, kërkesa dhe ankesa mbi ndihmën ekonomike.

Për Këshillin Bashkiak janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion, për tituj nderi, për emërtim rruge.

Për Rajonet janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacione të ndryshme dhe ankesa të ndryshme për hapje rruge, lirim hapësire dhe probleme infrastrukturore nëpër banesa.

Për Zyrën e Gjendjes Civile janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion/vërtetime.

Për Policinë Bashkiake janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion dhe kërkesë ankesa për cënim prone, lirim të hapësirës publike..

Për Drejtorinë e Mbrojtjes Civile janë marrë kërkesa të qytetarëve për informacion dhe kërkesa në raste fatkeqësish natyrore.

Për Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi janë marrë kërkesa të qytetarëve për rinovim çertifikate nga DMZSH.

Eshtë kryer korrespondenca duke përpiluar konfirmime të shkresave të ardhura nga institucione të ndryshme si: Zyra Përmbarimore Publike, Private, Shpallje të Gjykatave, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorive të Doganave etj.

Gjithashtu, është ndjekur korrespondenca dhe dhënia e përgjigjeve brenda afateve për kërkesat e ardhura nga institucionet, nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), sistemi elektronik e-albania.

Eshtë kryer shpallja dhe publikimi i akteve të ndryshme të institucionit, njoftime të drejtorive të ndryshme si shpronësime, njoftime vendim me gjobë, njoftime për mbledhjen e Këshillit, njoftime për konsultimin publik, vendimet e Këshillit të Bashkisë si dhe akte të tjera me interes të gjerë publik etj.

Përsa i përket numrit të kërkesave të regjistruara në regjistrin e posaçëm, sipas ligjit Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit” i ndryshuar të cilat publikohen dhe përditësohen çdo 1 muaj në faqen zyrtare të Autoritetit Publik në rubrikën

“Transparenca”, si dhe është implementuar regjistri elektronik i kërkesave për informacion, i cili është i aksesueshëm nga qytetarët për dërgim të kërkesave për informacion në portalin Pyet shtetin.al dhe që monitorohet çdo ditë nga ana e Drejtorisë.

Përsa i përket numrit të kërkesë/ankesave të depozituara pranë Drejtorisë së Bashkëqeverisjes

Për periudhën kohore Janar – Gusht 2024 nga ana e qytetarëve është si më poshtë:

1. Në muajin Janar numri i kërkesave është 346 (Treqind e dyzetë e gjashtë)
2. Në muajin Shkurt numri i kërkesave është 369 (Treqind e gjashtëdhjetë e nëntë)
3. Në muajin Mars numri i kërkesave është 382 Treqind e tetëdhjetë e dy)
4. Në muajin Prill numri i kërkesave është 482 (Katërqind e tetëdhjetë e dy)
5. Në muajin Maj numri i kërkesave është 389 (Treqind e tetëdhjetë e nëntë)
6. Në muajin Qershor numri i kërkesave është 396 (Treqind e nëntëdhjetë e gjashtë)
7. Në muajin Korrik numri i kërkesave është 376 (Treqind e shtatëdhjetë e gjashtë).
8. Në muajin Gusht numri i kërkesave është 323 (Treqind e njëzetë e tre).

Numri total i aplikimeve pranë Drejtorisë së Bashkëqeverisjes të hyra nëpërmjet sportelit dhe postës elektronike është 3063 (tremijë e gjashtëdhjetë e tre), prej të cilave 360 janë me përgjigje.

Performanca dhe statistika

Në periudhën Gusht – Tetor 2023 në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, si Sekretariat i Komisionit të Censit në nivel bashkie, njësia e statistikave ka mbështetur INSTAT-in në organizimin dhe drejtimin e punës përgatitore të censit në zonat e numërimit, brenda juridiksionit përkatës të bashkisë/njësisë administrative, në përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve, që do të përdoren gjatë fushatës së informimit, ka ndihmuar gjithashtu gjatë procesit të rekrutimit për punonjës terreni, sipas kërkesës dhe kritereve të vendosura nga INSTAT-i, ka propozuar burime njerëzore për stafin e terrenit, ka siguruar dhe vënë në dispozicion të personelit të censit ambiente të nevojshme për të mbështetur proceset e censit sipas kërkesave të INSTAT-it dhe/ose Komisionit Qendror të Censit, i ka ofruar mbështetje INSTAT-it për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë procesit të censit.

Matja e performancës të shërbimeve në nivel vendor është një prej prioriteteve të Qeverisë Shqiptare, e parashikuar në Strategjinë e Re Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030. Ngritja e një Sistemi të Matjes së Performancës (SMP) me qëllim përmirësimin e cilësisë të shërbimeve publike të ofruara në nivel vendor është e parashikuar në

Ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore” (ligj nr.139/2015) dhe në Ligjin nr 68/2017 “Për Financat Publike Vendore” (buxhetimi i programeve të orientuara drejt performancës dhe rezultateve).

Në këtë kuadër, Grupi ndërinstitucional i punës i ngritur me Urdhrin e Kryeministrit, nr.17, datë 20.02.2023 “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e propozimeve ligjore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet sistemit të matjes së performancës së shërbimeve publike”, ndryshuar me Urdhrin nr. 213, datë 13.12.2023, ka miratuar Sistemin e Matjes të Performancës (SMP), si dhe setin e indikatorëve për të matur performancën e kryerjes së shërbimeve publike që realizojnë bashkitë në nivelin vendor.

Gjatë periudhës korrik 2023 - gusht 2024 Njësia e Matjes së Performancës ka mbledhur të dhënat e nevojshme për secilin indikator të përcaktuar dhe ka përgatitur Raportin e Performancës së Shërbimeve Publike për vitin 2022 dhe për vitin 2023 për Bashkinë Vlorë. Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të Raportit të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2022, miratuar në Këshillin Bashkiak, të dhëna të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të web-it të Bashkisë Vlorë (Programi i Transparencës). Gjithashtu janë mbledhur të dhëna për masat e caktuara për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin dhe raportimin dhe është bërë raportim për vitin 2023 i realizimit të këtyre masave në planin e veprimit, si dhe realizimin e objektivave strategjik të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SNDQV) 2023–2030 dhe Planin e Veprimit 2023–2025, miratuar me VKM Nr. 252, datë 20.4.2023.

Raportim për 2024

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SNDQV) 2023–2030 dhe Plani i Veprimit 2023–2025, i miratuar me VKM Nr. 252, datë 20.4.2023, ka planifikuar masa dhe aktivitete me qëllim arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike, lidhur me

- (i) Nxitjen dhe forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm vendor,
- (ii) Përmirësimin e cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve vendore,
- (iii) Zgjerimin e qeverisjes digjitale në nivel vendor,
- (iv) Rritjen e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta,
- (v) Përmirësimin e demokracisë vendore dhe përparimin e agjendës së integritetit evropian në nivel vendor dhe
- (vi) Zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore. Zbatimi i këtij vendimi, në pikën 2, ngarkon me përgjegjësi edhe NJVV-të.

Sipas Planit të Veprimit 2023–2025, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë përgjegjëse për zbatimin e 40 masave dhe 40 financimeve dhe arritjen e 13 indikatorëve strategjikë për periudhën 2023–2025. Plotësimi me përgjegjësi i të dhënave të kërkuara në nivel mase, produkti dhe buxheti, duke përcaktuar dhe nivelin e riskut, do të ndihmojë Agjencinë për

Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në përgatitjen e Raportit 6-mujor dhe vjetor të monitorimit të SNDQV-së, bazuar në Planin e Veprimit të periudhës përkatëse.

KONKLUZIONE:

Pavarësisht sa është parashtruar më sipër, nga ana e Drejtorive të Bashkisë Vlorë vërehet se nuk ezaurohen me përgjigje shkresore kërkesë/ankesat e dorëzuara pranë DB-së, si kërkesat për informacion dhe kërkesë /ankesat e përgjithshme, duke mos dhënë arsytet e refuzimit të kërkesës, të pezullimit të kërkesës apo dhënies së pjesshme të përgjigjeve, duke sjellë vonesa ndaj kërkuesit, në marrjen e shërbimit në kohë sipas afateve të përcaktuara në ligj.

Puna e vazhdueshme e Drejtorisë së Bashkëqeverisjes, është komunikimi me qytetarët dhe bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë e Bashkisë Vlorë sipas problematikave për realizimin në kohë të kërkesave.

AUDITIMIT

Analiza e misioneve të auditimit për periudhën 01.01.2024 deri në 31.08.2024

Veprimtaria audituese është bazuar në vlerësimin e përshtatshmerisë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit duke u fokusuar kryesisht në:

- Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike
- Përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin regullator
- Besueshmerinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional
- Kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet
- Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

Duke u bazuar në programin vjetor të auditimit të ndryshuar dhe planin strategjik për këtë periudhë janë audituar:

1. Zbatimin e rekomandimeve të lëna
2. Sektori i bordit të kullimit (Ndërmarrja e shërbimeve publike)
3. Policia Bashkiake
4. Drejtoria e Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Veterinarisë (në proces evadimi)
5. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
6. Qendra e kulturës (në proces evadimi)

(Teatri “Petro Marko”)

1. Kërkesat për leje të zakonshme të behen me shkrim nga ana e punonjesve dhe të konfirmohen nga drejtori i institucionit.

Drejtori i Teatrit “Petro Marko”, menjëherë

2. Drejtori dhe financa të sigurohen për planifikimin në buxhet të oreve shtese në fondin e pagave dhe me pas të trajtohen financiarisht me ore shtese punonjesit e Institucionit.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”, në vazhdimësi

3. Të rishikohen oret shtese duke u siguruar që është respektuar Kodi i Punës Nr.7961 date

12.07.1995 i ndryshuar me Ligjin Nr.136/2015 ,neni 35 pika 2.

Drejtori dhe financierja e Teatrit “Petro Marko”,menjehere

4.Financa te ndermarr veprimet e nevojshme korrigjuese per llogarine 327 ,te cilat te reflektohen ne bilancin e vitit 2023.

(Teatri “Petro Marko”)

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit, kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, dhe ka punuar per permiresimin e tyre. Rekomandimet jane pranuar nga titullaret e insitucioneve dhe jane percaktuar dhe afatet e realizimit te tyre.

Për pesë auditimet e kryera për këtë periudhë janë lënë gjithësej 14 rekomandime.

Gjetjet e konstatuara nga strukturat e auditimit të me baze sistemi paraqiten si më poshtë:

- Sistemi i kontabilitetit dhe rap.financiar 4
- Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit 6
- Sistemi i planifikimit dhe buxhetimit 2
- Sipas qëllimit të institucionit 2

Auditimi në Qendrën e Kulturës është në proces evadimi.

Ndërmarrja e shërbimeve publike

Rrugët rurale

Sektori NSHP rrugë–trotuare-plazhe

Riparim Trotuare në rrugët:

-Riparim Rruga Gjergj Araniti

-Rruga Hasan Kushta

-Rruga Zenel Murra

-Rruga Miss Durhan

-Rruga Fejzo Gjomema

Rrugët në blloqet e banimit:

-Skarifikim Rrugët tek blloku banesave Drejtoria e Pyjore

-Skarifikim Rruga Fan Noli

-Skarifikim Rruga pas ish-Mapove

-Skarifikim tek Nën/stacioni elektrik

-Skarifikim Rruga Babaçe Faiku

-Skarifikim Rruga Hysni Muka

- Skarifikim Rruga Ahmet Selenica
- Skarifikim Rruga Arben Zylyftari

Sinjalistikë horizontale-vetikale:

- Rruga Demokracia
- Rruga Anita Bitri
- Rruga Hysni Alimerko
- Rruga At Krito Negovani
- Rruga Janaq Kilica
- Rruga Dervish Hekali
- Rruga Hajredin Haxhiraj
- Rruga Sulejman Delvina

Pastrimet në plazhe:

- Plazhi i Ri
- Plazhi përballë Shkollës së Marinës
- Plazhi i Vjetër
- Plugim dhe pastrim i sipërfaqeve me makineri

- Urgjencat ditore të dala sipas urdhërave të Bashkisë
- Realizuar aktivitete sportive në periudha te ndryshme
- Shënime:Shërbime dhe riparime në shkolla dhe kopështe.

➤ **Sektorin e Gjelberimit**

Lulishtia në hyrje të qytetit:Është shërbyer me korrje sip.bari,krasitje shkurresh dhe gardh të gjelbër si dhe higjenizim të të gjithë hapsirës.

Rruga Demokracia:Punim drurësh ,krasitje shkuresh grumbullim te degëve dhe barit dhe pastrim.

Lulishte te Pallati I Kulturës dhe Universiteti:Krasitje drurësh,qethje shkurresh për dhënie forme,çapitje lulesh te Universiteti dhe zona e Portit krasitje gardhi I gjelbër punim toke për mbjellje lulesh sezonale te hapësirat e gjelbërta.

Lulishte para Policisë:Korrje sip.bari,krasitje drurësh dhe shkurre,pastrim dhe higjenizim.

Lulishtia te Hollidey dhe te Xhamia:Korje sip.bari,punim drurësh dhe shkurre për dhënie forme decorative I dhe patrim dhe higjenizim të zonës.

Shkallët në Kuzum Baba:Qethje shkurresh,korrje sip.bari,fshirje të shkallëve,pastrim dhe grumbullim te mbaturinave mbas procesit të punës.

Rruga Osman Haxhiu,Zaho Koka dhe Enver Jaho:Punim drurësh dhe krasitje,pastrim I troturit nga barërat e kqijë,grumbullim dhe higjenizim.

Lulishte te Qendra Shëndetësore:Korrje sip.bari,punim drurësh grumbullim bari dhe pastrim me fshesë.

Lulishte te Marigo Posio:Korrje sip.bari,krasitje gardh I gjelbër,qethje shkurresh si dhe pastrim dhe higjenizim I zonës.

Lulishte te Selia e PS:Punim druri,qethje dhe shkurresh e gardh I gjelbër,punim toke dhe mbjellje lule sezonale,pastrim dhe higjenizim.

Lulishte te 3-Racat:Korrje sip.bari,punim dru dhe shkurresh,pastrim nga barërat e këqija grumbullim dhe pastrim mbas pune.

Lulishte te Liqeni:Korrje sip.bari,krasitje drurësh,qethje shkurresh dhe pastrim.

Rruga Dhimitër Konomi:Çapitje lulesh dhe hedhje plehu te lulet te ballkoni,korrje sip.bari ,shkurresh si dhe pastrim dhe higjenizim përgjatë rrugës.

Rruga Transballkanike:Korrje sip.bari,kraitje gardh I gjelbër,punim të trafikndarëse,punim në kampatet ,punim me frez dhe mbjellje farë bari.

Rruga Sazani:Punim drurësh,prerje ferrash,korrje sip.bari,pastrim I trotuarit nga barëart e këqija si dhe pastrim dhe higjenizim.

Rruga At Kristo Negovani:Punim drurësh,punim gardh I gjelbër,krasitje ,grumbullim bari dhe degësh si dhe pastrim dhe higjenizim.

Blloku te Rruga Demokracia:Punim druri,korrje sip bari,punim gardh I gjelber dhënie forme,pastrim dhe higjenizim.

Rotondo në hyrje te Rr.Tranballkanike:Punim toke dhe mbjellje lulesh në rotond ,ujitje,korrje sip.bari,plehrim me pleh kimik si dhe patrim dhe higjenizim.

Bulevardi Vlorë –Skelë:Është shëbyer me punim drurësh,punim gardh I gjelbër,çapitje lulesh ,korje sip.bari pastrim dhe grumbullim të barit dhe pastrim.

Fidanishte:Punohet në mirëmbajtjen e teritorit nga barërat e këqija,punim drurësh,krasitje formuese,mbushje qeskash për tranpantim fidanësh,mbushje kubikësh me lule për përgatitje mbjellje në qytet,prodhim fidansh me farë e me kalema,përgatitje kurorash ,vadtje të bimësise.etj

Muzeu I Pavarësisë:Korrje sip.bari,punim toke për mbjellje lulesh,pastrim dhe higjenizim .

Blloku Kapele-Posta:Punim I shkurreve,punim drurësh,higjenizim,grumbullim bari dhe pastrim.

Rruga te Bashkia dhe lapidari te Rruga e Spitalit:Korje sip,bari,pastrim të trotuarit nga barërat e këqija,punim dru,korje te lapidari si dhe mbjellje pemsh te rruga e spitalit,grumbullim bari dh patrim përgjatë kaj rruge.

Lungomare:Shërbyer me korje sip,bari,plehrim,prerje palmash ,punim drurësh dhe krasitje,eliminim drursh të thatë,punim me frezë te sip.e dëmtuara,vaditje me impiant.Pastrim me fshesë dh lopata për të hequr dheun nga pjesa e shëtitorës te krijuar ng akushtet atmosferike.pastrim të fugave,pastrim I luleve në vazo betony nga barërat e këqija.Mirëmbajtje të terreneve sportive,punim drurësh në Unazë.

Shkollat+Kopshtet:Është shërbyer në të gjitha shkollat dhe kopshtet e qytetit me korje sip,bari,punim dru+shkurresh,qethje shkurresh e gardh I gjelbër,mbjellje fidanësh të rinj,krasitje palmash,grumbullim bari dhe degëve dhe pastrim te teritorit.

Gjithshtu është ndërhyr permbjellje pemësh ne fshatin Poro dhe në landfilli në Orikum,gjithashtu kanë qenë present në shume aksione te bëra në qytet,si ne pyllin e Sodës etj.

Administrimi i Pyjeve Kullotave

Struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat ka këto objektiva:

- ✓ qeverisjen tërësore të pyjeve dhe të tokave pyjore;
- ✓ ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor;
- ✓ përgatitjen e projekteve për investimet në pyje e kullota;
- ✓ drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;
- ✓ sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;
- ✓ mirëmbajtjen dhe funksionimin e infra-strukturës në fondin pyjor bashkiak;

Objekti parë i punës tonë ka patur të bëj me :

- Mbikqyrjen dhe kontrollin e fondit pyjor dhe kullosor.

Kullotat - *Venia nën kontroll dhe rregullimi i aktivitetit të kullotjes.*

- Janë bërë kontrole mbi zbatueshmerin e ligjit dhe akteve nënligjore të kullotave, mbi fermerët:
 - Që ushtrojnë aktivitetin e tyre me bagëti në kullotat dimërore dhe verore dhe nuk paguajnë detyrimet tarifore.
 - Që aktualisht “përmiresojnë kullotat“ me ane të zjarrit.
- Janë bërë monitorime mbi mundësin e nevojave për meremetim lerash dhe vepra të tjera hidrike, me synim te riaftësimit të kapacitetit ujëmbajtës të tyre për sigurimin e ujit të pijshëm për

blegtorinë gjatë një sezoni kullor dhe krijimin e “rezervave ujore“ (hidranteve) në rastet e rënies së zjarreve.

Treguesit/pritshmëritë - *Mundësi përmirësimi dhe rehabilitimi.*

- Puna jonë ka rezultuar në takime të realizuara me fermerët, që meren me mbarështrimin e blektorisë, për ato zona apo fshatra ku dhe tendenca e shmangies ndaj pagesës së kullotës ka patur shfaqjet e saja, si në fshatin Dukat dhe Tragjas. ***Ai që kullotë duhet të paguaj.***

Për këtë periudhë, të ardhurat nga aktiviteti kullor janë **359.100 leke**. Të ardhura këto nga kontratat e kullotave si dhe sipërfaqe në përdorim.

- Ka dal nevojja për **meremetim e veprave ujëpëruese malore** në kullotat, me synim të riaftësimit të kapacitetit ujëmbajtës të tyre për sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë gjatë një sezoni kullor prej 6 muajsh.

Ndërkohë në kuadër të shkresës së Ministrit të Ministrisë së Brëndshme, nr. 3754 prot dt. 13.07.2021 me lëndë: ***“Kujtesë mbi detyrimet ligjore..... për marrjen e masave parandaluese për zjarret e stinës në sipërfaqet pyjore dhe kullota“***, nga ana e sektorit u rishikua edhe një herë përcaktimi i nevojave për ndërhyrje emergjente në kuadër të sigurimit të rezervave ujore. Në kuadër të kësaj shkrese, përcaktimi i veprave ujore për rehabilitim/ndërtim vëpër të re, u bë jo vetëm në funksion të gjëndjes aktuale të tyre, por edhe në kuadër të nevojës/rëndësis së habitatit.

Për sa më sipër sektori vendosi që shuma prej 2.700 000 lekë (nga të ardhurat e siguruar nga aktiviteti i kullotjes), caktuar nga Bashkia do të përdoret konkretisht në masivin pyjorë mbi fshatin Tragjas dhe kullotat dimërore mbi fshatin Rradhimë dhe Tragjas.

Janë përgatitur dy projekte për:

- ✓ Rehabilitimin e lerës Ali Maçit në ngastrën pyjore nr. 6 të ekonomisë Tragjas – Shengjergj
- ✓ Bërjen e një lere të re (çimentoje) në ngastrën nr. 48, EK Dukat-Tragjas-Shashicë

Pyjet - *Të vihet nën kontroll aktiviteti i ndërhyrjeve ilegale në pyje (prerje, zënie fondi, ndërtime)*

- Janë kryer kontrolle rutinë në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore që janë aktualisht në fuqi, për pyjet.
- Kemi bashkëpunuar me Njësitë Administrative dhe kryesitë e fshatrave në nivel Bashkie.

Treguesit/pritshmeria - *Kontroll i aktiviteteve ilegale.*

- Mbrojtje më e mirë e formacioneve pyjore.
- Janë minimizuar aktivitetet pa leje, si prerje, zënie fondi, ndërtime pa leje e tjerë.
- Kemi realizuar dhe do realizojmë në vazhdimësi një pyll të pastër.
- Ka përfunduar Plani i Mbarështrimit për grup ngastrat pyjorë 15.02.2022 – 15.02.2032, Për Ekonomine Pyjore ‘Kume Shashicë’ të Pylli I Sodës, si dhe pjesa tjetër e kësaj Ekonomie (Uje i Ftohtë), i cili do të pasqyroj gjëndjen aktuale të këtij pylli, masat silvo teknike, që me realizimin e tyre do të çojnë në përmirësimin e situatës fito sanitare të tij, si dhe parashikimin e objektivave të tjera menaxheriale, gjithmon brenda legjisllacionit shqipëtar për pyjet dhe statusit që i ka dhënë plani i përgjithshëm vendor.

Nuk kemi patur nderhyrje me prerje në fondin pyjorë.

Zjarret - Të vihet nën kontroll mbrojtja e pyjeve dhe kullotave nga zjarri, vecanërisht prej atyre të vëna me qëllim nga barinjët.

- Eshtë përgatitur një program masash parandalimi dhe përgjigjja ndaj situatave emergjente që mund të krijohen nga zjarret për vitin 2024.
- Janë bërë takime për sensibilizimin e komunitetit të zonës, kryesisht të komunitetit të blegtorëve, me qëllim rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të tyre, **për të ndryshuar konceptin se zjarret përmirësojnë kullotat (të cilat janë në proces të papërfunduar).**
- Në kuadër të mbrojtjes nga zjarri, është bërë studimi në pyllin e Sodës (në kuadër të planit të mbarshtrimit), mbi krijimin e korridoreve antizjarr. Ky studim do të konkretizohet me një projekt i cili do të paraqes në menyre të detajuar krijimin e korridoreve antizjarr në pyllin e Sodës.
- Eshtë bërë projekti për pastrimin i pyllit të Sodës nga të gjithë drurët e thyer, rrëzuar apo shkukur nga era. Dokumentacion i nevojshëm për vazhdim procedure është dorëzuar në Bashki i cili është miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe jemi në pritje të zhvillimit të ankandit.

Treguesit/pritshmeria: *Sa me pak raste të venies së zjarreve me "dashje".*

- Ngritja e strukturave të posacme për fikjen e zjarreve në nivel Njesie Administrative dhe fshati.
- Caktimi i pikave të vrojtimit-sinjalizimit, të levizshme, për zjarret në pyje e kullota. U caktuan 6 pika vrojtimit sinjalizimi, të cilat mbulohen nga 5 punonjesit, që sektori ka në terren.

Pikat janë:

- ✓ Shata dhe Fushe Dukat, mbulohen nga inspektori zonës Veledin Celoaliaj.
- ✓ Tragjas fshat/vjeter, mbulohen nga inspektori zonës Gaxho Baco.
- ✓ Shashicë, Mallangas Radhimë mbulohen nga inspektori zonës Batjar Canaj.
- ✓ Pylli Sodës mbulohet nga inspektori i zonës Adriatik Tafili.
- ✓ Beshisht-Trevllazër mbulohet nga inspektori i zonës Vladimir Ganaj.
- Sensibilizimi i komunitetit për mbrotje të pyjeve nga zjarri. Janë realizuar dy takime, në fshatrat Dukat, Tragjas, Radhimë dhe Kaninë. (Në bashkpunim me MNZSH (zjarrfiksjë Vlorë) dhe SPZ (inspektorët e policisë).
- Janë vendosur postera në pyllin e Sodës, Beshisht, Dukat, Tragjas, Kaninë dhe Radhimë për sensibilizimin e opinionit publik.
- Sinjalizimi i rënies së zjarrit dhe shkuarja në vendngjarje në momentet e para të rënies së tij, ul ndjeshëm rrezikshmerin e përhapjes.

Tabela e mëposhtme jep qartësisht situatën e zjarreve në pyje e kullota bashkiake për periudhën 1 Korrik 2023 - 2024.

- Rastet e zjarreve – 3
 - ✓ Pyje 1 raste
 - ✓ Kullota 2 raste
- Sipërfaqia e pershkruar nga zjarret, 24 ha
 - ✓ Në pyje 1 ha

- ✓ Në kullota 23 ha
- Pronësia
 - ✓ Bashkiake
 - Pyje 1 ha
 - Kullota 23 ha
 - ✓ Private 0 ha
 - Kullota 0 ha
- Dëmi ekonomik ---- lekë
- Material drusor i djegur, por i përdorshëm -- m³

➤ Objektivi dyte ka të bëj me :
- Planin financiar

Treguesit/pritshmeria: Sigurimi i të ardhurave nga kullotat.

Në periudhën Janar - Gusht, ne realizojmë lidhjen e kontratave për kullotat verore dhe në vazhdim ato dimërore. Për periudhën Janar – Gusht 2024 janë lidhur 28 kontrata blektorësh, që kanë të bëjnë me aktivitetin kullosor për sezonin 6 mujor .Shuma e të ardhurave në kullota për këtë 8 mujor është 359.1000 lekë.

Të ardhurat për periudhën Korrik 2023 – Korrik 2024:

			Vlefte lekë
Nr	Bashkia	Aktiviteti	Janar – Gusht 2024
1	Vlorë	Kullotje	359.100
2	Vlorë	Sipërf. Përdorim	31.500
3	Vlorë	Dru zjarri	-----
5			
6		Shuma tot	390.600 lekë

➤ Objektivi i trete, ka te bëj me:

Struktura Përgjegjëse Pyje e Kullota Bashkiake

Në zbatim të shkresës të AKP e cila na ngarkon me detyrën e inspektimit dhe kontrollit bazuar ne ligjin 57/2020 Për Pyjet, doli nevoja e plotësimit të struktures pyjore me punonjes të rinj. të Struktura e sektorit u shtua me VKB për 5 specialist. Aktualisht janë emëruar 3 specialist dhe 2 pononjës mbështetës.

- Objektivi i katërt dhe i fundit

Lufta kundër bimeve narkotike

Struktura përgjegjëse pyje-kullota Bashkia Vlorë ,ka mare pjesë në takimet e realizuara nga Drejtoria Vendore e Policisë te Qarkut Vlorë ,me njesitë Administrative Orikum,Novosel,Llakatund dhe Qëndër.U është dhënë detyrë specialistëve të zonave të cilet po bashkpunojnë me inspektorët e policisë (SPZ) në kontrollin që ushtrohet në fondin pyjor – kullor.Specialistët tanë janë pjesë e grupeve të punës të policisë për kontrollin e bimeve narkotike në fondin pyjor-kullor.

Në takimet e organizuara me blegtoret në fshatrat Kanine,Radhime,Tragjas,Dukat ,krahës problemeve të tjera si : zjarret ,kullotjet pa leje, prerjet pa leje është trajtuar dhe problemi i minimizimit të bimeve narkotike.

Ujitja dhe Kullimi

- **Spektori i Bordit te Kullimit**

a) **Pastrimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse**

Gjatë këtij viti janë kryer këto volume pastrimi të kanaleve kulluese dhe ujitëse nga sektori i Bordit të Kullimit me mjete të renda eskavator nga vetë ndermarrja.

Duke u mbështetur me planifikimin vjetor të 2024, pastrimet me mjetet eskavator nga vetë ndërmarrja me 2 Volvo, 1 Fiat-Hitachi krahëgjatë si dhe Cat305 është planifikuar:

Pastrim i kanaleve kulluese të II dhe të III	km	m3
---	-----------	-----------

Volumet e kryera janë në:

Njësitë Administrative Novosel është pastruar 0.3 km kanal.

Nj.A. Shushicë janë pastruar 0 km kanal.

Njësitë Administrative Qëndër janë pastruar 0 km kanal.

Njësitë Administrative Orikum 0 km kanal.

Mjeti Volvo 1 ka punuar në mënyrë të vazhdueshme në vendgrumbullimin e mbetjeve, për fikjen e zjarreve të shkaktuara si dhe rregullimin e rrugës për tu aksesuar nga mjetet e emergjencës. sipas Urdhërit të brendshëm i Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr.258, dt: 24.07.2023 dhe Nr. 9047 Prot , dt: 24.07.2023 me hyrje në ndërmarrje me Nr.383 Prot , dt: 26.04.2023 ,si dhe Urdhërin e brendshëm Nr.35 dt: 25.07.2023 me Nr. 377 Prot dt: 25.07.2023, Urdhëri i

Brendshëm i Titullarit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr .45 ,dt:10.10.2023 Për përballimin e situatës emergjente të krijuar në fushën e grumbullimit të mbetjeve dhe rrezikun nga zjarret ku përcaktohet mjetei “Volvo 1” të vihet në dispozicion të situatës për emergjencat e krijuara me zjarret.

Për arsye të angazhimit të mjeteve në emergjencat e shkaktuara nga zjarret sasia e naftës u ezaurua përpara afatit të përfundimit të kontratës

Eskavatori Fiat-Hitachi ka qëndruar në gadishmëri pranë hidrovorit të qytetit për pastrimin e vaskave të hidrovorit nga llumrat dhe mbeturinat.

Eskavatori Volvo 2 ka qëndruar në gadishmëri për pastrimin e kanaleve në Novoselë .

Mjeti Cat 305 Cr ka qëndruar në gadishmëri për pastrimin e kanaleve në zonën Llakatund.

b) Gatishmëria e Hidrovorit të qytetit

Gatishmëria e hidrovorit të qytetit nga Janari deri në Prill ka qenë e mirë

Është përballuar rënia e reshjeve si dhe ujërat e përditëshme që dalin nga qyteti i Vlorës.

Për sa i përket pompave aksiale të hidrovorit:

-Nga 4 pompa punojnë 3 në kapacitet të plotë

-Kapaciteti nga 16m³/s në 11.5m³/s

-Gatishmëria 72%

Arsyet janë këto:

-Amortizimi i lartë i pompave

-Difekt i rëndë në pompën 2, Ganz500

- Struktura

Përsa i përket strukturës së sektorit kemi bërë gjithmonë kërkesa që sipas ligjit ky sektor të marrë formën e plotë nga reformimi:

- 1- 1 Inxhinier Topograf
- 2- 1 Mekanik mjetesh të rënda
- 3- 1 Kujdestar për saracineskat

➤ Sektori DDD

Sektori i shërbimit DDD realizon dezinfektimë dezinfektimë dhe deratizimë në çerdhe, kopshte, shkolla, vendstrehime, lulishte, parqe, dhe mjedise publike., sic janë shkollat, kopshtet dhe çerdhet, si edhe në rastet kur ka ankesa nga këto institucione publike..

Janë kryer dezinfektive të bodrumeve të pallateve fillimisht duke inspektuar vatrat e infeksionit si bodrume e mcr dhe më pas ndërhyrja me preparat për dezinfektimin e tyre. Inspektimet dhe desinsektimet kryhen çdo ditë të javës në vatrat e evidentuara më parë dhe në rast konstatimi të reja.

Në Rajonin 1 është realizuar inspektim, dezinfektim dhe dezinfektim si më poshtë:

- Banesë pranë Shkollës 9 vjeçare "**4 Heronjtë**"
- Pallat pranë Spitalit me parkim të kontaminuar me prezencë uji të ndotur në katin e nëndheshëm..
- Pranë AKU është higjenizuar hapsira brenda dhe jashtë koshave të mbeturinave.
- Pranë Shkollës 9 vjeçare "**28 Nëntori**" është higjenizuar dhe dezinfektuar hapsira rreth koshave të mbeturinave.

Në Rajonin 2 është realizuar inspektim përgjatë kanalit të Siavit dhe është ndërhyrë për dezinfektim në hapsirat që janë evidentuar problematike.

- Zona e ish ndërmarrjes dhe oficinës "Perlat Rexhepi" ose Kanali ish fabrikës së çimentos
- Vendgrumbullime mbeturinash të tilla si: kontenier me mbeturina, kosha si edhe mjediset perreth tyre
- Koshat të Lagjia Isa Boletini
- Koshat të Rr.Pelivan Leskaj
- Koshat të Rr.Zenel Murra
- Koshat të kryqëzimi i rrugës Aristill Kokoshi dh Rr. Naim Frasheri pranë Shkollës Mustafa Qemal Ataturk
- Rr.Shyqyri Ali Merka pranë Qendres së Zhvillimit PAK

Në Rajonin 3 është dezinfektuar Mcr, banesa të braktisura e parkime të nëndheshme si më poshtë:

- Rruga "Lef Sallata" pranë Shkollës "Naim Frashëri"
- Zona përreth Shkollës "Musa Çakëri" mcr të kontaminuara me ujë të ndotur
- Zona të Konadi, dezinfektim në vendgrumbullim mbeturinash pranë koshave
- Koshat të Rr.Hajredin Haxhiraj pranë Shkollës "Ali Demi"
- Koshat të Rr."Misto Mele" të Alsa ,
- Koshat të Rr."Hasan Kushta" të Albano Romina
- Koshat të Rr."Gjergj Kastrioti" Rr. e Çipajve
- Koshat të Rr."Kosova" të Universiteti

Në Rajonin 4 janë dezinfektuar ndërtesa por edhe ambjentet rreth pallateve, të cilat janë:

- Ndërtesa rreth zonës së quajtur Kapino pallat me numër 1258
- Pallate rreth Postës së Çoles përkatësisht pallati me nr.1267, zona mbrapa Shkollës 9 vjeçare “**Jani Minga**” pallat nr.1286 me ujë të ndotur në bodrum.
- Pallate me bodrume pranë Shkollës "15 Tetori"
- Koshat përgjatë Rr."Enver Jaho"
- Koshat përgjatë Rr."Mis Durham"
- Rr.Zaho Koka te Shkolla "Jani Minga"

Në Rajonin 5 kemi evidentuar problematika në pallate të ndërtuara para viteve 90 dhe kemi ndërhyrë për minimizimin e problematikës përkatësisht:

- MCR pranë Kopshtit Nr.3
- Pallati 6 katëshi
- Pallati te Posta Qendrore
- Vendgrumbullime mbeturinash te tilla si: kontenier me mbeturina, kosha si edhe mjediset perreth tyre
- Koshat te Rr.Demokracia
- Koshat te Rr.Janaq Kilica te Shkolla "Halim Xhelo"
- Koshat te Rr."Zigur Lelo"
- Koshat te Rr."Dervish Hekali" ish Fusha e Aviacionit

Ne kuader të profilaksisë për infeksioneve respiratore u realizua dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim në institucionet arsimore te cilat do te jene te frekuentueshme ne qytetin e Vlores si edhe ne Njesite Administrative në **Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë, Shushicë**. Institucionet arsimore janë pajisur me dëshmi DDD.

Gjinnaze	Kopshte		Çerdhe	Shkollë 9 vjeçare	
Gjinnazi "Shaban Demiraj"	1.Kopshti Nr.1	1.Kopshti "Loni Mone"	Çerdhja Nr:2	Shkolla "Lef Sallata"	Shkolla "Pilo Prifti –Novoselë"
Gjinnazi "Halim Xhelo"	2.Kopshti Nr.2	3. Kopshti "Ismail Qemali – Fitore	Çerdhja Nr:4	Shkolla" Musa Çakëri"	Shkolla" Loni Mone-Poro"
Gjinnazi "Ali Demi"	3.Kopshti Nr.3	4. Kopshti " Reshat Hoxha" Akërn	Çerdhja Nr:15	Shkolla "4 Heronjtë	Shkolla Kafil Malaj Bishan

Gjimnazi "Jani Minga"	4.Kopshti Nr.5	5. Kopshti "Pilo Prifti"- Novoselë		Shkolla "Zigur Lelo"	Shkolla Reshat Hoxha Akerni
Gjimnazi "Mustafa Ataturk"	5.Kopshti N: 7	6. Kopshti Skrofotinë		Shkolla Zenel Murra	Shkolla "Taulla Xhafaj Hoshtime"
Shkolla Industriale "Pavarsia"	6.Kopshti Nr:8	7. Kopshti "Perlat Rexhepi" - Cerkovinë		Shkolla" Ibrahim Kushta"	Shkolla Xhemil Bregu -Panaja
Shkolla Profesionale "Tregtare"	7.Kopshti Nr:9	8. Kopshti "Avni Rustemi "- Trevllazër		Shkolla Rilindja	Shkolla Perlat Rexhepi- Cerkovine
Gjimnazi "Naim Frashëri"	8.Kopshti Nr:10	9. Kopshti " Taulla Xhafaj" Hoshtime		Shkolla" Muço Delo"	Shkolla "Avni Rustemi "Trevllazër
Gjimnazi "Fasli Danaj" Llakatund	9.Kopshti Nr:11	10. Kopshti "Xhemil Bregu "- Panaja		Shkolla "Avni Rustemi"	Shkolla Hajredin Haxhiraj Kerkove
Gjimnazi "Pilo Prifti"	10.Kopshti Nr: 13	11. Kopshti "Hajredin Haxhiraj" Kerkove		Shkolla 15 Tetori	Shkolla" Ismail Qemali "Fitore
Gjimnazi " Hasan Mëhilli"	11.Kopshti Nr:14	Kopshti " Nikolla Xhuveli"		Shkolla "Marigo Posio"	Shkolla "Fasli Danaj Llakatund
Gjimnazi "Hasan Pulo"	12Kopshti Nr:15	Kopshti "Rrapo Hasimi"		Q.Zh.P.A.K	Shkolla "Festim Hoxha Sherishtë"
	13.Kopshti 1 Maj			Shkolla "Jani Minga"	Shkolle Lili Gori Xhuherinë
	14.Kopshti Lef Sallata			Shkolla "Ismail Qemali"	Shkolla" Idris Rustemi Risili

	15.Kopshti Musa Çakërri				Shkolla "Fasli Danaj" Llakatund
	16. Kopshti 4 Heronjtë				Shkolla "Hamit Lumi" Babicë e Vogël
	17.Kopshti Zigur Lelo				Shkolla "Selam Musai" Babicë e Madhe
	18.Kopshti Zenel Murra				
	19.Kopshti Z.Murra 7 pallatet				

Pastrimi

Spektori i Pastrimit

Spektori i Pastrimit pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike veprimtarinë e saj e ka për heqjen e mbetjeve urbane nga kontenierët me mjete teknologjike, skrep, kamion, kamioncina dopio kabinë për heqjen e inerteve , fshirjen e rrugëve dhe trotuarevë me autofshesë dhe fshesë me punëtor, larjen e rrugëve dhe kontenierëve, pastrimin dhe plugimin e plazhit.

Gjatë periudhës Janar-Prill Spektori i Pastrimit ka punuar me 2 turne (I dhe III) për pastrimin e qytetit. Puna është kryer me mjete teknologjike me kapacitet 20 m³, 10 m³, 6 m³ për pastrimin e mbetjeve urbane nga kontenierët.Gjithashtu është punuar edhe me kamioncina për pastrimin e mbetjeve jashtë kontenierëve si psh divanë,dërasa,inerte etj.Në disa pika të nxehta ku sasia e inerteve ka qenë shumë e madhe dhe e pamundur për tu hequr me punëtorë, pastrimi i tyre është bërë nga skrepi dhe kamioni.

Në turnin e I kemi punuar me 5 makina teknologjike, 5 kamioncina per heqjen e mbetjeve inerte dhe 1 kamion dhe 1 skrep për pikat ku sasia e inerteve te depozituara ka qenë shumë e madhe dhe nuk mund te hiqej me punetore dhe kamioncinë.

Në turnin e III kemi punuar me 6 makina teknologjike, 2 autofshesa dhe 1 bot uji për larjen e rrugëve.

Që prej muajit gusht 2024 është kryer dhe shërbimi i pastrimit për Njësitë Administrative Novoselë, Qëndër, Shushicë me mjete teknologjike 20 m³, 10 m³ dhe 6 m³.

Mjetet e Pastrimit kanë dalë bazuar në planin e punës së mëposhtëm:

- 5 kamioncina në 5 Rajone nga ora 7:30 deri në 14:00
- 6 makina teknologjike në 5 rajone nga ora 11:00 deri në 17:00
- 2 kamioncina nga ora 16:00 deri në 22:00
- 5 makina teknologjike nga ora 22:00 deri në 04:00
- 1 makinë teknologjike nga ora 15:00 deri në 21:00
- 1 makinë teknologjike 10m³ në Njësinë Administrative Qëndër
- 1 makinë teknologjike 20m³ në Novoselë.
- Skrep+kamion: Pikat më të nxehta janë ish SMT, Ujësjellësi, Karafilajt, Kaminat, Stadiumi, Rruga e Pyjores, Fabrika e Tullave, Kalaja, Fusha e Druve, Fabrika e Cimentos.

Sasia mesatare vjetore e mbetjeve urbane të evaduara është 53,407 ton/vit

$$w = c \times d \times t \times l \times 365$$

ku: c – kapaciteti mesatar i kamionit (m³ / automjet);

d – densiteti mesatar i mbetjeve bashkiake në një kamion (ton/m³);

t – numri mesatar i rrugëve që bëhet çdo ditë nga kamioni (rrugët/ditë);

l – numri mesatar i kamionëve që grumbullojnë në territorin e bashkisë (nr. kamionë/ditë);

w – sasia e mbetjeve vjetore e gjeneruar (ton/vit).

$$w_1 = 20 \times 0.65 \times 1 \times 4 \times 365 = 18,980 \text{ (mjete teknologjik me kapacitet 20 m}^3\text{)}$$

$$w_2 = 10 \times 0.65 \times 2 \times 6 \times 365 = 28,470 \text{ (mjete teknologjik me kapacitet 10 m}^3\text{)}$$

$$w_3 = 6 \times 0.17 \times 4 \times 4 \times 365 = 5,957 \text{ (mjete teknologjik me kapacitet 6 m}^3\text{)}$$

$$w = w_1 + w_2 + w_3 = 53,407 \text{ ton/vit}$$

Për periudhën 4-mujore janar-prill sasia e mbetjeve është:
53407ton/vit:3=17,802ton

Fshirja e rrugëve, trotuarëve dhe shesheve me punëtorë dhe autofshesë:

Është bërë fshirja e rrugëve, korsive të bicikletave dhe trotuarëve me autofshesë të Lungomares, rrugës Dhimitër Konomi, rrugës Sazani, rrugës Gjergj Kastrioti, Bulevardi Ismail Qemali, rruga Ali Demi, rruga Sulejman Delvina, rruga Sadik Zotaj.

Fshirja e rrugëve, trotuarëve dhe shesheve me fshesë me punëtorë është bërë sipas një grafiku të caktuar nga mbikqyrësat ku në përditshmërinë e tyre pastrohet tregu i madh, tregu i orizit, tregu i coles, Bulevardi Ismail Qemali, rruga Gjergj Arianiti, rruga Mis Durhan, rruga Zaho Koka, rruga Enver Jaho, rruga Hasan Kushta, rruga Dhimitër Konomi.

Problematikat

1. Vendgrumbullimi i mbetjeve i cili i shërben qytetit prej 30 vitesh është në limitet e tij.

Problematikë e madhe është sasia e madhe e mbetjeve duke e bërë të pamundur krijimin e hapësirave të reja në këtë vendgrumbullim.

Kjo sasi e madhe mbetjesh ditore bën që ne ti afrohem sa më shumë qendrave të banimit duke qenë një rrezik i shtuar për infeksione si dhe rreziqet nga zjarri.

Vendosja në punë e landfillit të ri është prioritet dhe duhet ndërhyrje emergjente për rehabilitimin e vendgrumbullimit ekzistues dhe depozitimim të mbetjeve në landfillin e ri të Sherishtës.

2. Papërgjegjshmëria qytetare:
 - a. Në hedhjen e mbeturinave në koshat e vegjel
 - b. Hedhja e mbeturinave jashtë kontenierëve
 - c. Parkimi i makinave në pikat e kontenierëve duke krijuar vështirësi deri në mos heqjen e mbeturinave duke krijuar dhe trafik për shkak të pritjes së zhbllokimit të pikës së kontenierëve.
 - d. Papërgjegjshmëria e bizneseve. Hedhja e mbeturinave, kartonave të pa sistemuar sidomos nga supermarketet në orare të papërshtatshme duke i tejmbushur kontenierët dhe duke krijuar vështirësi për qytetarët.

Gjatë peridhës Janar-Prill të vitit 2024 Sektori i Varrezave në veprimtarinë e saj ka mbuluar pastrimin e ambjenteve të varrezave të qytetit të Vlorës, pastrimin e kanaleve, heqjen e mbeturinave, korrjen dhe pastrimin e barërave për një sipërfaqe rreth 270,000 m².

Përveç punëve që janë kryer në varrezat e qytetit ky sektor është marrë dhe me mirëmbajtjen e Varrezave të Dëshmorëve që ka si veprimtari kryesore pastrimin e ambjentit, mirëmbajtjen e luleve, ujitje, korrje bari, krasitje bimësh, mirëmbajtjen e varrosheve më një sipërfaqe rreth 12,200 m².

Kjo është një punë e përditshme që kryhet sipas një plani pune javore ku në secilën ditë të javës përcaktohen detyrat që duhet të kryejnë punëtorët e sektorit.

Gjithashtu ky sektor ka mirëmbajtur dhe rrugët e parcelave duke i skarifikuar dhe mbushur gropat me cakell si dhe pastrimin e kanaleve anësore kulluese.

Që prej 1 Shkurtit është kryer edhe shërbimi funeral ku në procesin e saj janë të përfshira prodhimi i pllakave, hapja dhe mbulimi i gropave, betonimi sipërfaqesor.

Gjatë kësaj periudhe nga 1 Shkurti deri në fund Prilli janë kryer 160 shërbime funerale.

Sektori i Varrezave në organikën e saj përbëhet nga 22 punonjës nga të cilët 1 përgjegjës i sektorit që merret me organizimin dhe nevojat e punës, 1 brigadier që merret me mbikqyrjen, 1 shofer, 1 roje, 1 teknik ndërtimi dhe 17 punëtorë.

Aktualisht në hapësirën e organikës më 22 punonjës janë 4 vende vakante, ku kërkojmë të bëhet i mundur plotësimi i strukturës me 4 punëtorë.

Duke qenë së organika është bërë vetëm për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave, është e nevojshme ndryshimi i kësaj organike me pozicione pune të reja si 1 Specialist për mbajtjen e

të gjitha dokumentacioneve të Sektorit dhe 6 punëtorë për kryerjen e shërbimit funeral (hapjen e gropave, prodhimin e pllakave, betonizim sipërfaqësor).

Problematikat e evidentuara janë:

1. Pajisja me të gjitha dokumentat, hartat, që i shërbejnë sektorit.
2. Shtrimi i rrugëve të parcelave me asfalt pasi në periudha rreshjesh krijohet shumë baltë duke e vështirësuar kalimin.
3. Ndricimi është një element shumë i rindësishëm dhe emergjent pasi nuk ka ndricim fare.
4. Kangjellat që kanë vendosur vet qytetarët për rrethimin e varroshëve na krijojnë vështirësi për pastrimin e mbeturinave dhe korrjen dhe heqjen e barërave.
5. Ndërhyrja në marrjen e lejes për të orientuar subjektet e ndryshme që operojnë në rregullimet dhe meremetimet e varroshëve pasi është vërejtur që deri me tani inertet janë lënë të pa hequra duke krijuar vështirësi në punën tonë të përditshme.
6. Vendosje tarifash për procese pune të ndërthurura si varim në të njëjtin vend ku bëhet zhvarrimi, zhvendosje eshtrash në varrosh tjetër pa u hapur , varroshet e bëra 2 katëshe nga familjarët .
7. Rritja e strukturës nga 22 në 29 punonjës.

MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane gjatë 8 muorit të vitit 2024 ka pasur në fokus:

- përgatitjen e komponentëve të Planit të Biznesit të MIM Vlorë për vënien në funksionim të impianteve dhe aktiviteteve rajonale
- ndërtimin e strukturave në qendrën rajonale të menaxhimit të mbetjeve në Sherishtë,
- organizimin e marrjes në dorëzim të pajisjeve dhe mjeteve të reja në kuadër të programit *Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta në Vlorë, Shqipëri,*
- mirëmbajtjen preventive të infrastrukturës, pajisjeve dhe mjeteve të vendosura në Landfillin e Sherishtës
- zhvillimin e kapaciteteve të stafit
- rritjen e ndërgjegjësimit të publikut

1. Raportimi financiar

Me V.K.B Nr.87 datë 23.12.2022 'Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara - 2023' për Ndërmarrjen Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane janë miratuar 39 punonjës.

Për të përmbushur funksionet e ndërmarrjes MIM Vlorë në administrimin e vend depozitimit sanitar dhe impiantit të rikuperimit të materialeve, aktualisht janë rekrutuar 17 punonjës për disa pozicione, në përputhje me aktivitetet e parashikuara në fazën e parë të funksionimit, duke paraprirë aktivitetet gjatë periudhës së vënies në punë, testimit, dorëzimit/marrjes dhe fillimit të operimeve në landfill.

Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane për 8 mujorin e vitit 2024 ka kryer transaksione financiare sipas tabelës së mëposhtme:

Grupi	Titulli	Kapitulli	Llog. Ekon	Plan	Fakt	Mbetje
0	5100	1	600	8,000,000.00	7,032,134.00	967,866.00
0	5100	1	601	1,950,000.00	1,174,373.00	775,627.00
0	1710	1	651	1,320,000.00	418,568.22	901,431.78
0	1710	1	166	9,000,000.00	4,500,000.00	4,500,000.00
0	5100	5	600	4,500,000.00	1,183,449.00	3,316,551.00
0	5100	5	601	470,000.00	197,638.00	272,362.00
0	5100	5	602	9,000,000.00	7,684,003.59	1,315,996.41
0	1710	5	651	0.00	0.00	0.00
0	1710	5	166	4,704,000.00	1,324,200.00	3,379,800.00
0	5100	5	231	392,000.00	196,239.00	195,761.00
Shuma				39,336,000.00	23,710,604.81	15,625,395.19

2. Ecuria e punimeve në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë

Ndërtimi i landfillit sanitar ka përfunduar 95% të punimeve ndërtimore të ndara sipas lot-eve si më poshtë:

LOT 1

- Qeliza 1 – Kanë përfunduar punimet e dherave në të gjithë qelizën 1. Kanë përfunduar shtrimi i shtresave të izolimit në skarpat dhe bazamet, shtresat që përbëhen nga Geo Sintetic Clay, HDPE, dhe Gjeotekstil. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar puna për mbushjen me material drenazhi (50 cm zhavorr lumi i larë). Ka përfunduar mbushja e qelizës 1.1 dhe qelizës 1.2. Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksiviatave. Rrethimi i të gjithë objektit ka përfunduar.
- Qeliza 2 – Kanë përfunduar punimet e dherave në gjithë qelizën 2. Ka përfunduar dhe shtrimi i shtresave izoluese. Ka përfunduar shtrimi i tubove të gazit në të gjithë perimetrin e qelizës. Ka përfunduar shtrimi i tubove HDPE PN 16 DN 355 që shërbejnë për mbledhjen e leksiviatave.

- Leachate storage pond (LTP) – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe shtrimi i shtresave të izolimit. Ka përfunduar dhe mbushjen e sheshit me cakull. Eshtë dorëzuar në kantier fabrika e trajtimit të leksiviatave. Kanë përfunduar lidhjet hidraulike të rrjetit të qarkullimit të ujit të ndotur në impiant. Kanë përfunduar lidhjet elektrike të impiantit të trajtimit të ujit. Është bërë testimi i lidhjeve elektrike. Eshtë punuar për testimin dhe kalibrimin e pjesës hidraulike dhe mekanike të impiantit LTP.
- Ndërtesa e Administratës – Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot dhe grafiato, aktualisht mungon lysterja, dyert dhe dritaret e objektit. Ka përfunduar shtrimi i trotuarëve me pllaka përreth godinës së administratës.
- Ndërtesa e Oficinës (workshop) - Kanë përfunduar punimet e betonit, elektrike, anti zjarri, kanalizimet dhe muratura. Kanë përfunduar linjat e brendëshme hidraulike dhe elektrike. Ka përfunduar instalimi i sistemit kapot, janë vendosur qepenat dhe aktualisht mungon vetëm grafiato, lysterja dhe dyert e dritaret e objektit.
- Ndërtesa e parkimit (Canopy Hangar) – Kanë përfunduar të gjitha punimet.
- Sheshi administratës dhe MRF – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave. Kanë përfunduar shtrimi i linjave nëntokësore si elektrike, IT, sistemi i kamerave, ujësjellësi, sistemi kundra zjarrit, kanalizimet. Ka përfunduar testimi i linjave të ujësjellësit, sistemit kundra zjarrit dhe sistemit të vaditjes, dhe po punohet me testimin e linjave kanalizimeve. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me asfalt.
- Rruga e aksesit – Kanë përfunduar të gjitha punimet e dherave dhe të strukturave mbajtëse (muret). Kanë përfunduar betonimet e kanaleve anësore dhe vendosja e shtyllave elektrike nga Sherishta deri në landfill. Ka përfunduar shtrimi i rrugës me asfalt.

LOT 2

- Ndërtesa MRF – Kanë përfunduar punimet e dherave dhe të betonit. Kanë përfunduar të gjitha punimet metalike. Ka përfunduar shtrimi i linjave elektrike, IT, kundra zjarrit, kanalizimeve etj. në brendësi të sheshit të MRF. Ka përfunduar shtrimi i sheshit me beton të armuar dhe rifiniturat përkatëse.
- Kanë ardhur dhe montuar në kantier në masën 95% makineritë e MRF.

LOT 3

- Janë porositur makineritë e parashikuara sipas kontratës për LOT 3 nga të cilat ka ardhur në kantier kompaktori, buldozeri, skrepi CAT dhe priten ardhja e të gjitha makinerive të mbetura.
- Po punohet për zhblokimin e mjeteve dhe kontenerëve që ndodhen në doganën e Tiranës në bashkëpunim me institucionet e pushtetit qëndror.

3. Monitorimi i mbetjeve

MIM Vlorë ka përpiluar qasjen konceptuale të monitorimit të mbetjeve referuar kërkesave ligjore për monitorim dhe raportim (Ligji për Mbetjet, VKM-të, Rregulloret specifike). Cikli i monitorimit vlerëson performancën dhe ndikimin mjedisor.

Monitorimi i parametrave do të realizohet nga një program kompjuterik, i cili do të shërbejë edhe për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes, për menaxhimin e të dhënave sasiore dhe financiare në sistem. Ka përfunduar vendosja, testimi dhe kalibrimi i peshores në landfill. Peshorja do të shërbejë për të matur sasinë e mbetjeve që gjenerohen nga rajoni Vlorë-Veri, sasinë e mbetjeve që riciklohen dhe sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill.

4. Riciklimi dhe kompostimi

Ndërmarrja MIM Vlorë është përfshirë në aktivitetet e planifikimit për skemën pilot të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve me kontenerë depo në rajonin nr. 3 të qytetit të Vlorës, të drejtuar nga ekspertët e Konsulentit Institucional. Në fazën e parë të testimit është propozuar të instalohen 10 stacione me 3 kontenerë depo për lloje të ndryshme materialesh (kanaçe, shishe, kartona, ambalazhe). MIM Vlorë ka ndërmarrë aktivitetet e para të ndërgjegjësimit mjedisor me disa shkolla në qytetin e Vlorës.

Në funksion të studimit të tregut për materialet e riciklueshme janë vendosur kontakte me disa kompani riciklimi në Tiranë për të parë interesin dhe potencialin për bashkëpunim kur të fillojë puna në impiantin e ndarjes së materialeve.

Ka përfunduar plani mbi pikat e vendosjes së kontenerëve për mbetjet e riciklueshme në Rajonin Numër 3. Kontenerët për mbetjet e riciklueshme kanë ardhur dhe po punohet për shpërndarjen e tyre në qytet.

5. Mirëmbajtje e infrastrukturës , linjave dhe mjeteve teknologjike në landfill

Mirëmbajtja preventive e cila zhvillohet në landfillin e Sherishtës është një proces i rëndësishëm për të siguruar që pajisjet dhe sistemet të funksionojnë në mënyrë optimale dhe të shmangen defektet e papritura. Kjo përfshin inspektime të rregullta, pastrime, lubrifikime.

Proceset e mirëmbajtjes në landfillin e Sherishtës kryhen në baza ditore dhe përfshijnë një spektër të gjerë aktivitetesh teknike. Këto aktivitete përfshijnë mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve të drenazhimit të ujit të shiut nga aluvionet e grumbulluara, si dhe kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme riparuese në zonat e dëmtuara. Gjithashtu, përfshihet pastrimi nga

vegjetacioni dhe mirëmbajtja dhe kontrolli i saraçineskave dhe komponentëve të tjerë të sistemit të largimit të ujërave sipërfaqësorë për tu siguruar që janë në gjendje funksionale optimale.

Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve përfshin kontrole të rregullta për identifikimin e dëmtimeve, testimin dhe vendosjen në punë me parametra minimale operative, për të shmangur avaritë dhe për të siguruar gatishmërinë e tyre të vazhdueshme për qenë operacionale në momentin e fillimit të aktivitetit në landfill.

Vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit dhe shërbimeve ndaj mjeteve teknologjike që ndërmarja administron, gjendja teknike e të cilave për specifikat që kanë si mjete, kërkon monitorim të vazhdueshëm deri në vënien në punë me kapacitet të plotë sipas funksionit që kryejnë.

6. Masa paraprake për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për personelin e MIM

Përveç aktiviteteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës, mjeteve dhe linjave teknologjike, të sistemeve të ndryshme të instaluar në impiant, është punuar në drejtim të sigurimit të kushteve optimale të punës për personelin që do të punojë në impiant, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, konform kërkesave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Ne kemi tashmë, të përcaktuar një set të plotë të pajimeve të mbrojtjes personale, me karakteristika teknike rigoroze konform standarteve ndërkombetare ISO dhe EN dhe atij shqiptar SSH, i cili do t’i garantojë përdoruesve mbrojtje të shëndetit dhe siguri në punë.

Përveç kësaj kemi të konsultuar me specialiste të fushës dhe të përfunduar skemën e mbulimit me shërbimin 3D të infrastrukturës dhe objekteve në impiant, e cila do t’i garantojë personelit përveç kushteve të punës dhe një ambient të mbrojtur.

Gjatë kësaj periudhe MIM Vlora, ka realizuar dhe prokurimin e disa shërbimeve dhe furnizimeve bazike për mundësimin e aktivitetit të saj, duke u kufizuar në shërbime që garantojnë sigurinë e impiantit, dhe në furnizime me materiale të nevojshme për aktivitetin administrativ dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, linjave teknologjike dhe mjeteve teknologjike në administrim.

6. Rritja e ndërgjegjësimit dhe marrëdhëniet me publikun

Ndërgjegjësimi dhe ndryshimi i sjelljes në raport me mbetjet urbane, është një sfidë por dhe një mision që ka marrë përsipër Ndërmarrja Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve Vlorë, nëpërmjet sensibilizimit të nxënësve të arsimit parauniversitar dhe fëmijëve të kopshteve të qytetit të Vlorës.

Këtë periudhe 8 – mujore, janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) në zonën e projektit pilot në Rajonin nr 3, ku ndodhen shkollat dhe kopshtet e mëposhtme :

- ✓ Shkolla Artistike “Naim Frashëri”
- ✓ Shkolla 9 vjeçare “Lef Sallata”

- ✓ Shkolla 9 vjeçare “Ismail Qemali”
- ✓ Shkolla 9 vjeçare “Teli Ndini”
- ✓ Shkolla 9 vjeçare “Muco Delo”
- ✓ Kopshti “1 Maji”
- ✓ Kopshti “ nr 10”
- ✓ Kopshti “nr 8”
- ✓ Kopshti “nr 11”
- ✓ Kopshti “nr 5”
- ✓ Aktivitet në Kampin Veror me Qendrën e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën e Familjen.

Temat dhe informacionet të cilat janë trajtuar me nxënësit :

- Prezantimi i Ndërmarrjes Publike Bashkiake për Menaxhimin e Mbetjeve, qëllimi dhe objektivat e saj
- Informimi për zonat në të cilat do të vendosen koshat për ndarjen e mbetjeve të diferencuara
- Informimi i nxënësve mbi mënyrën e trajtimit të mbetjeve
- Shfaqja e materialeve edukative dhe informuese për ndarjen e mbetjeve në burim
- Shpërndarja e fletëpalosjeve me informacione mbi riciklimin
- Krijimin e materialeve të reja me produkte të riciklueshme

Fushatat sensibilizuese, aktivitetet me nxënësit dhe informacionet që janë përcjellë audiencës për grumbullimin e veçantë të lëndëve të riciklueshme publikohen edhe në faqet e rrjeteve sociale instagram e facebook.

Me fillim e vitit shkollor këto aktivitete do zhvillohen më tej, duke përfshirë të gjitha shkollat dhe kopshtet e tjera të Bashkisë Vlorë, qendrat sportive, etj.

Do të vazhdojnë fushatat sensibilizuese nëpërmjet shpërndarjes të fletëpalosjeve tek banorët, bizneset, me objektivin për të krijuar gradualisht bindjen që Vlora duhet të jetë jo vetëm një qytet i bukur turistik por edhe një qytet i pastër banorë e të cilit kujdesen dhe për mjedisin.

- **Klubi Shumesportesh Flamurtari**

Gjatë 8- mujorit të vitit 2024 kanë vazhduar aktivitetet zyrtare në Pallatin e Sportit Flamurtari dhe puna për përfaqsimin sa më të denjë të Klubit dhe Bashkisë Vlorë dhe për arritjen e objektivit të përbashkët të masivizimit të sporteve dhe përfshirjen e sa më shumë të rinjve në to.

- Ekipi Femrave në Basketboll të rritura ka fituar Kupë e Shqipërisë më 24 Janar 2024 dhe ka zënë vendin e dytë në Kampionatin Kombëtar për sezonin 2023-2024. Ekipi

ishite pjesë e Ligës Unike, kampionat i përbashkët i Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Federata e Basketbollit të Kosovës duke u renditur në vendin e pestë.

- Ekipi i Basketbollit meshkuj të rritur në sezonin 2023-2024 përfaqëson klubin në Superligë ku sipas klasifikimit renditen në vendin e gjashtë.
- Ekipet zinxhir të basketbollit U18, U16 për femra dhe U18, U16 për meshkuj janë pjesë e Kampionatit Kombëtar për moshë.
- Ekipi Volejbollit Femra në kampionatin e sezonit 2023-2024 ka marrë vendin e dytë në Kampionatin Kombëtar dhe është pretendent për të fituar Kupën e Shqipërisë për Kategorinë e parë.
- Ekipi i Volejbollit femra U18 në sezoni 2023- 2024 ka nisur me përfaqësim të denjë për moshat U 18 dhe U 16, duke na bërë të jemi ekip pretendent për kryesimin e kampionateve,
- Ekipi i Minifutbollit (Futsal) është shpallur kampion në sezonin 2023-2024.
- Ekipi i Kickbox ka arritur të mbrojë titullin kampion Bote, dhe përgatit sportistë të talentuar të cilët përfaqësojnë klubin në çdo kompeticion sportiv.
- Ekipi i Mundjes ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Federata Shqiptare e Mundjes për vitin 2024.
- Sportistët e ekipit të Boksit kanë përfaqësuar denjësisht klubin duke i sjellë titujt e vendit të parë për moshat dhe Kampionatit të Boksit për të rritur.
- Në disiplinën e atletikës kemi kampion Kombëtar në hedhje disku dhe 100 metërsh. Gjithashtu dhe në peshëngritje kemi kampion kombëtar për moshat u18. Ekipi i qitjes falë punës së vahdueshme ka marrë vende të para dhe të dyta në kampionatet e organizuara përgjatë vitit. Ekipi i shahut, taekwondo, karate kanë marrë pjesë në aktivitetet zyrtare gjatë 8- mujorit të vitit 2024 me rezultate të kënaqshme.
- Në kuadër të titullit “Vlora, qyteti European si sportit 2024”, Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, është pjesë organizative e aktiviteteve sportive të organizuara në qytet, duke filluar me kampionatin Street Basket 3x3 organizuar në Lungomare me pjesëmarrjen më 23 Mars me pjesëmarrjen e sportistëve nga i gjithë ballkani ku kampione në kategorinë për femra u shpallë ekipi i Flamurtarit, organizimin e finaleve të Liga Unike Lajthiza më datat 27-28-29 Mars në ambientet e Pallatit të Sportit, organizimin e aktivitetit Night of the Champions më 13 Prill në ambientet e Pallatit të Sportit ku kampion u shpallën 2 sportista që përfaqësonin ekipin e Flamurtarit, organizimin e Maratona Vlora Run 2024 më 21 Prill dhe organizimin e Mountain Bike Kanina më 27 Prill 2024.

Më datat 07-11 Maj 2024 organizua “Festivali Sportiv”, me 9 disiplina sportive ku dy prej kampionateve, përkatësisht Kampionati i Qitjes Sportive dhe Kampionati i Bokst u zhvilluan në ambientet e Klubit Shumësportësh “Flamurtari”, sportistët e Klubit ishin pjesëmarrës dhe garues në të 9 disiplinat sportive të organizuara. 7-8-9 Qershor pjesë organizative e “Vlora Open Beach Volley 2024”, pjesëmarrës ekipe nga e gjithë Shqipëria dhe përfaqësues të qytetit ekipet e organizuara me sportistët e Klubit Shumësportësh “Flamurtari”. 19-20-21 Korrik 2024, “Steka e Artë 2024”, Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, pjesë organizative dhe përfaqësuar ekipin e Vlorës me Ekipin e Bilardos. 2-3 Gusht “Summer Up” Festivali Sportiv një aktivitet i larmishëm për të gjitha grupmoshat me pjesëmarrjen e sportistëve nga e gjithë Shqipëria ku sportistët e Klubit fituan cmime të para dhe të dyta në sportet e Beach Volley, Notë, Ping Pong. Street Basket, Shah.

Projekti	Plani vjetor	Fakt
		01.01.2024-31.08.2024
Ekipi basketbollit meshkuj te rritur	5,500,000	4,195,000
Ekipi basketboll meshkuj te rinje	300,000	245,875
Ekipi basketbollit femra te rritura	8,500,000	5,869,000
Ekipi basketbollit femra te reja	300,000	251,500
Ekipi I volejbollit femra te rritura	2,500,000	1,245,125
Ekipi I volejbollit femra te reja	400,000	262,420
Ekipi I boksit	4,000,000	2,662,500
Ekipi I ciklizmit	1,000,000	533,125
Ekipi I mundjes	1,200,000	810,000
Ekipi I Ping Pong	300,000	191,875
Ekipi I peshengritjes	800,000	568,750
Ekipi I karatese	300,000	175,000
Ekipi I minifutbollit	4,000,000	2,712,500
Ekipi I qitjes	800,000	538,750
Ekipi I taekwondo	300,000	180,000
Ekipi I bilardos	700,000	328,750
Ekipi I atletikes	300,000	178,750
Ekipi I shahut	350,000	231,250
Ekipi I kickbox	1,500,000	966,250
Ekipi futboll femra	300,000	178,750
Ekipi I notit	600,000	250,000
Projekte Shtesë	368,500	368,500
Energji elektrike	550,000	381,773
Ujë	180,000	123,022
Telefoni+ Sherbim interneti	80,000	30,800
Shperblime per ekipe dhe individ kampion	1,000,000	0
Grumbullim te ekipeve per trofe	1,000,000	0

Federime+ Gjyqtari sportive	3,100,000	2,532,125
Shpenzime te paparashikuara	200,000	51,475
Shpenzime publicieti	650,000	181,000
Udhetime dhe dieta personeli	400,000	54,500
Riparime te vogla+ shp. Te tjera	1,000,000	543,275
Materiale sportive	1,000,000	0
Sigurimi I lojtareve	600,000	0
231 Paisje teknike, tabela elektronike, Pc	1,000,000	0
Shpenzime bileta udhetime transferim lojtaresh te huaj	1,000,000	0

Qendra Kulturore dhe Teatri

Aktivite të realizuara në Muzeun Historik dhe Etnografik ,Pallatin e Kultures, Galerine,Teatrin e Kukullave dhe Bibloteken Publike “ Shevqet Musaraj”

Periudha (Janar – Gusht 2024)

- **Teatri “Petro Marko”**

Teatrin “Petro Marko” , pasurimin e jetës artistike e kulturore në qytetin e Vlorës, ju paraqesim aktivitetin e këtij Institucioni për periudhën 01 Janar 2024- 30 gusht 2024 si më poshtë:

Janar 2024

- “Estrada e të rinjeve(Jemi dhe ne)”, Regji të Artan Islamit, interpretojnë Anteo Salikaj ,Gabriela Azizaj,Gentjan Këllici,Dajana Shehaj,Fabian Duro,Albano Merkaj,Justinian Kissi,Emanuela Selimaj, me mbështetjen e Bashkisë Vlorë. Kjo estradë pati shume sukses dhe u duartrokit per 3 netë në Teatrin “Petro Marko”, gjatë muajit Dhjetor 2023, u vendos përsëri në 19 Janar 2024.
- Koncert “Fausto Leali”, grupi i njohur Italian, më 26 Janar 2024, Koncert që pati shumë pjesëmarrje në sallën e teatrit “Petro Marko”.

Shkurt 2024

- Në teatrin “Petro Marko” u zhvillua ceremonia e dhënies së titullit “Nderi i Qytetit” për ekipin e futbollit të viteve 80-90 ! 10 Shkurt 2024.
- Komedia “Një vrasje e vogël aksidentale” me Regjit të Marigona Bektashi Ferati,e sjellin në skenë aktorët Fisnik Ademi,Irena Aliu,Qendesa Kajtazi,Artan Hetemi. Komedi e duartrokitur u shfaq me shumë sukses në datën 22 Shkurt 2024 në teatrin “Petro Marko”.

Mars 2024

- Koncert pianisti Red Radoja, artisti me repertor të kompozitorve francez 1 Mars 2024.
- Mirënjohje për Artistët e Kinematografisë Shqiptare “Ibrahim Mucaj dhe Kristaq Mitro”, me Regji të Kristaq A. Skrami, Dirigjent Oleg Arapi, me pjesëmarrjen e aktorëve të mëdhenj Timo Flloko, Rajmonda Bulku, Ndririm Xhepa, Kristaq A. Skrami.
- Komedia “Natën e mirë me burrin tim”, një komedi e viteve të fundit, me Regji të Jorgaq Tushe, shfaqur me shumë sukses në teatrin “Petro Marko”, në datat 8,9,10,12,13,14,15,16,17,22,23,24 Mars. E luajtur nga trupa e aktorëve Artan Islami, Matilda Avduli, Ermir Hoxhaj, Eljona Thomaraj, Roland Minga, Alba Shtëmbari, Loris Sinaj.
- Koncert “Le Interviste Impossibili”, interpretoi Idalberto Fei dhe Eldorado Siravo, gjithashtu dy artiste italiane Gabriella Casali dhe Cloris Brosca në bashkëpunim me Konsullatën Italiane Vlorë, i mbajtur më 27 mars 2024.

Prill 2024

- Drama e trishtë nga Sofokli “Elektra”, me regjizor të Kico Londo, As Regjisor Olgert Mataj Greta Baci, Kevin Rrapaj, shfaqur me shumë sukses në teatrin “Petro Marko”, në datat 16,17,18 Prill 2024, me artist të mëdhenj Laura Nezha, Alert Celolaj, Gladiola Harizaj, Denisa Demaj, Engjell Hoxha, Medi Gurra, Asiana Koka, Melisa Manuka, Suela Prendi, Greta Baci Baci, Kevin Rrapaj.
- Trupa “Star Dance Academy” konkurs kërcimi modern, mbajtur më 20 Prill 2024.
- “Dita botërore e librit” morën pjesë shkollat klasat e 9-ta të qytetit “Lef Sallata” dhe “Muco Delo”, mbajtur 23 Prill 2024.

Maj 2024

- “Fest Art 2024”, spektakli i përvitshëm i talenteve të reja, nën vëzhgimin dhe trajnimin e më profesionistëve të fushës si dhe organizuar e realizuar nga Teatrit “Petro Marko”, në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë. Konkurs, çmime e vlerësime. Me talentet më të spikatur në të gjitha shkollat e mesme dhe klasave të 9 - ta të qytetit në zhanrin e këngës dhe kërcimit modern, mbajtur më 7 & 8 Maj 2024.
- Mirënjohje për Artistët e Kinematografisë Shqiptare “Piro Milkani”, me Regji të Kristaq A. Skrami, Dirigjent Oleg Arapi, me pjesëmarrjen e aktorëve të mëdhenj Timo Flloko, Rajmonda Bulku, Ndririm Xhepa, Kristaq A. Skrami. I ftuar Nik Xhelilaj, mbajtur më 18 Maj 2024.
- Comedy-Bar ‘Stand-UP’ me pjesëmarrjen e aktort të humorit Gent Hazizi dhe Besnik Mustafaj, shfaqje që u duartrokit nga publiku Vlonjat më 24 Maj.
- Koncert “Omaggio a Battatio”, luajtën muzikë me vepra të autorëve të shquar, në bashkëpunim me Konsullatën Italiane Vlorë, i mbajtur më 30 maj 2024.
- Komedi “Gruaja e burrit tim” me regjisor të Kico Londo, As Regjisor Olgert Mataj. Falë aktorëve të mrekullshëm të zgjedhur me kujdes shfaqja pati shumë sukses në teatrin “Petro Marko” për dy ditë rresht 31 Maj & 1 Qershor Qershor 2024.

Qershor 2024

1. Kocert recital i Parodistave të Vlores “Rrofte Parodia ,dy artistë aq të dashur për publikun vlonjat dhe jo vetëm që mbushën sallen e Teatrit për tre netë rresht me interpretimin e humorin e tyre brilant 7-8-9 Qershor 2024.
2. Antonio Motcia Mode & Lee Curreri,muzika Italiane 40 anni di “ Fame –Saranno Famosi” ne bashkëpunim me Konsullatën Italiane Vlorë, i mbajtur më 13 Qershor 2024.
3. ”Thuaja Këngës Rini” , aktivizim rinor i shprehur përmes artit nga Këshilli Vendor Rinor dhe të rinjtë e Vlorës më 21 Qershor 2024.

Korrik-Gusht 2024

1. Spektaklet verore argëtuese me këngë, humor dhe kërcime në sheshet më të frekuentuara të qytetit “Show Veror 2024”, në qendren historike të qytetit te Vlorës lagjja Muradie, në Lungomare, dhe në Orikum.

Situacioni 8 – mujor i shpenzimeve:

Plan 600 – 17.400 mije

Fakt 600 - 14.220 mije

Plan 601 – 2.950 mije

Fakt 601 – 2.366 mije

Shpenzime operative:

Plan 602 – 5.400 mije

Fakt 602 – 3.295 mije

Investime (231):

Plan - 2.000 mije

Fakt – 685 mije

Arsimi Parauniversitar

- **Arsimi**

Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit funksionon në bazë të Ligjit nr.69/2012 i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, V.K.M. nr.666, dt 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe

pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, VKM 511 dt. 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa të VKM 666”, Udhëzimit nr. 26, dt 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, VKB-ës nr.97, dt 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligji nr.9863, dt 28.01.2008 “Për ushqimin”, Udhëzimit, nr.22, dt 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligji nr.74/2013, dt 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, dt 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar.

- Staf për organizimin e çdo evenimenti të “Vlora, Qyteti European I Sportit 2024”.

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Ligjin nr.9863, dt 28.1.2008 “Për ushqimin”, Udhëzim, nr.22, dt 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor, Ligjin nr.74/2013, dt 14.02.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, dt 28.01.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar janë kryer ndryshime në dokumentacionin mbi të cilin bazohet procesi i monitorimit të kopshteve në Bashkinë Vlorë dhe Njësitë Administrative për zbatimin e kriterëve të ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit arsimor parashkollor, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Ngritja e një grupi pune brenda sektorit për analizën e situatës në kopshtet e Bashkisë Vlorë.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm nr.4 dt 10.01.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit edukativ individual për fëmijët me aftësi të kufizuara”, komisioni ka përditësuar planin PEI për 44 fëmijë me aftësi të kufizuara në kopshtet e bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me mësueset mbështetëse (përditësimi çdo 3 muaj).

- Pjesë e grupit të punës në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Vlorë–Himarë dhe finalizimi i veprimtarisë së festës së mësuesit. U nderuan 38 mësues me titullin “Mirënjohje e Qytetit”.

- Pjesë e grupit oranzues të aktivitetit “Dita e Verës”.

-Është zhvilluar procesi i mbledhjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bonusit financiar të nxënësve ekselentë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme që aplikojnë në Bashkinë Vlorë. Janë trajtuar për vitin **shk. 2023-2024** me bonus financiar 134 nxënës në shkollat 9- vjeçare publike dhe 128 nxënës në shkollat e mesme të përgjithshme publike.

-Pjesëmarrje në grupin e punës me Urdhër të Brendshëm nr 285 dt 22.08.2023 “Mbi ngritjen e grupit te punës per inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të Sektorit te Prokurimeve”

-Mbledhje, përpunim dhe sendërzim të të dhënave mbi problematikat infrastrukturore dhe bazë materiale në IA-të dhe çerdhet e bashkisë Vlorë

-Bazuar në Ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKB-ës nr.97, dt. 28.12.2020 “Plani i përmisimit të shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë”, ndiqet procesi i regjistrimit të vazhdueshëm në kopshte dhe çerdhe, si dhe adresimi i problematikave.

-Bazuar në Urdhërin e Brendshëm Nr.450, dt. 11.12.2023 “Për një ndryshim në Urdhërin nr.3 dt 07.01.2020 mbi ngritjen e komisionit për kolaudimin e mallrave ushqimorë, industriale dhe elektrike” është kryer kontroll ditor i ushqimit për çerdhet, kopshtet pranë magazinës së Qendrës Ekonomike.

-Pjesë e grupit “Për ngritjen të punës, për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit të tenderit Blerje- Ushqimore” në bazë të Urdhërit të brendshëm nr.48, dt. 22.02.2024

- Kthim përgjigje institucioneve të ndryshme.

-Pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete të ndryshme që organizojnë drejtori të tjera të bashkisë Vlorë.

-Trajnime dhe aktivitete për rritjen e kapacitetit të KVR-s.

- Ngritja e një database mbi situatën e të rinjve në territorin e bashkisë Vlorë.

- Ngritja e një database “Të rinjtë dhe sporti” në territorin e bashkisë Vlorë.

Qendra e zhvillimit P.A.K

Qendra e Zhvillimit për Personat me Aftësi të Kufizuar Vlorë si një institucion rezidencial i cili funksionon në përputhje me standartet dhe legjislacionin në fuqi për këtë target grup, edhe këtë vit ka organizuar aktivitetin e saj në përputhje me misionin dhe objektivat e vendosura.

Për 4-mujorin e parë për vitin 2024 pranë Qendrës së Zhvillimit PAK kanë marrë shërbim 29 rezidentë, 10 prej të cilëve janë në interesim nga familjari dhe pjesa tjetër, prej 20 rezidentësh janë të braktisur me vendim gjykate. Në organikën e saj Qendra ka një staf prej 40 punonjësish të ndarë në 2 sektorë: Sektori i Administratës dhe Sektori i Shërbimeve.

Aktualisht faktike janë 38 punonjes, pasi 2 punonjës janë me leje lindje.

Misioni i kësaj qendre është zbatimi i politikave sociale me synim : Ofrimin e Shërbimeve cilësore, të qëndrueshme dhe në përputhje me standartet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuara duke qënë gjithnjë në koherencë me legjislacionin në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë së jetës, nxitjen e pavarësisë, përfshirjes dhe respektimit të dinjitetit të rezidentëve, si dhe integrimin e tyre në komunitet në mënyrë sa më të natyrshme, nëse kjo e fundit është e mundur.

Qendra e Zhvillimit për Persona me Aftësi të Kufizuara ka për Objektiv të:

- Rrisë cilësinë e shërbimit që ju ofrohet rezidentëve në drejtim të riaftësimit fizik dhe mendor të këtyre të fundit.
- Nxitjen dhe zbatimin e programeve aktive me qëllim krijimin e një procesi sa më natyral të integritit të rezidentëve në komunitet.
- Krijimin i netëork-ve efektive me Institucione, Organizata Jofitimprurëse, Subjekte Juridike dhe Private të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e këtij target-grupi.
- Realizimin e Programeve edukativo-pedagogjike dhe riaftëtimit e personave me aftësi të kufizuara.

Detyrat :

- Ofrimi dhe krijimi i kushteve të favorshme dhe cilësisë për të jetuar dhe mësuar në bazë të programeve të riaftësimit.
 - Përpilimi i programeve të edukimit dhe të integritit në saj të bashkëpunimit të edukatoreve, specialistëve, monitorimi i të cilave bëhet nga Drejtoria.
 - Zbatimi i legjislacionit dhe Standarteve.
 - Hartimi i programeve për trajnimin dhe formimin e stafit.
 - Administron dhe menaxhon buxhetin e caktuar.
 - Raporton dhe informon Sh.S.SH dhe Bashkinë Vlorë mbi: statistikat dhe evidencat mujore, të ardhurat, transferimet e klientëve, raporte të realizimit të planeve mujore.
 - Mban lidhje korrekte për cdo problem me Bashkinë Vlorë dhe SH.S.SH.
- Si Institucion Shtetëror, social dhe rehabilitues pjesë e institucioneve të përkujdesit shoqëror në këtë Qendër ofrohen këto shërbime :
- Në nivel specialisti, të përfaqësuar nga punonjësi social, infermier, specialist logoped dhe fizioterapeut, edukatorët të cilat mbulojnë edhe nivelin edukativ-pedagogjik.
 - Në nivel shërbimi, të përfaqësuar nga kuzhinieret, kujdestaret, sanitaret, mirëmbajtësi, magazinieri etj.

Deinstitutionalizimi dhe kthimi në familje i rezidentëve.

Aktualisht në Qendrën tonë marrin shërbim 30 rezidentë, prej të cilëve 21 përfitues janë mbi moshën 21 vjeçare, 15 janë të braktisur me vendim gjykatë dhe 6 janë në interesim familjar. Shërbimi Social Shtetëror udhëzon që Qendrat Rezidenciale të ofrojnë kujdes dhe shërbim për rezidentët deri në moshën 21 vjeç, si dhe të kryhen të gjitha procedurat për kthimin në familje të personave me interesim. Konkretisht janë kryer të gjitha kërkesat dhe procedurat ndaj Shërbimit Social Shtetëror dhe Rajonal për sistemimin e këtyre rezidentëve, por situacionet social-ekonomike të familjeve të tyre nuk i plotësojnë kushtet për deinstitutionalizimin e këtyre përfituesve.

Realizimet e objektivave

1. Realizimet në sektorin social dhe pedagogjik

Në drejtim të këtyre sektorëve qëllimet, objektivat dhe aktivitetet përgjate vitit 2023 kanë qenë të orientuara në lidhje me moshën në rritje të rezidentëve, të vështirësive që ata paraqesin nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje me trajtimin e aftësisë së kufizuar dhe të zhvillimit të tyre në përputhje me kërkesat dhe plotësimin e standarteve të vendosura.

Në nivel pedagogjik për këto vit janë vlerësuar fillimisht nevojat, kërkesat dhe vetë rezidentët brenda institucionit është hartuar një projekt pilot duke organizuar aktivitete okupacioni në bazë të trajnimeve speciale të edukatoreve të orientuara në aktivitete specifike. Që do të thotë se tashmë janë shtuar aktivitete paraprofesionale në mini atelie pune si: *punime me letër dhe plastikë, punime leshi, pikturë, aplikacione-prodhim piktura të ndryshme.*

Aktivitet në Qendër janë zhvilluar normalisht, madje këtë vit mund të përmendim se ka patur një rritje në nivelin e organizimit të aktiviteteve

Rezidentët përfshihen në këto aktivitete në mënyrën që munden . Këto aktivitete zhvillohen paralelisht me programet individuale të zhvillimit për gjithë secilin nga rezidentët.

Theksojmë se të gjitha aktivitetet janë realizuar ne mbeshtetje te plote te edukatoreve specialiste te cilet organizojne punen ne baze te prirjve te scilit rezident.

Realizimi i objektivave pedagogjike

- Plotësimi i fishave të vlerësimit të AK, për të përcaktuar nevojat dhe prioritetet e ndërhyrjes.
- Hartimi, plotësimi i planeve individuale të zhvillimit.
- Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave të rezidentëve përsa i përket moshës dhe tipologjisë së vështirësisë që ata paraqesin, duke i orientuar aktivitetet në ato paraprofesionale.
- Hapja e 2 mini- atelieve të punës, e hekurosjes dhe e krijimtarisë me materiale të ndryshme sipas specifikave të rezidentëve.

2. Ecuria shëndetësore e përfituesve.

Përsa i përket gjendjes shëndetësore të rasteve, aktualisht janë 19 përfitues me mjekim ditor për shkak të çrregullimeve psikiatrike apo neurologjike. Mjekimi është i udhëzuar dhe dokumentuar nga mjeku specialist dhe menaxhohet nga infermieri i institucionit. Janë realizuar të gjitha ekzaminimet e udhëzuara nga mjeku.

Ushqimi është korrekt në lidhje me kuotën ushqimore të përcaktuar për secilin rezident dhe mund të vlerësohet një menu brenda parametrave normal përsa i përket kalorive duke përfshirë aty edhe moshën dhe dietën e rezidentëve.

Gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë relativisht e mirë, duke patur parasysh këtu kategorinë e personave, problemet dhe vështirësitë që ata kanë. Në periudha të ndryshme të

vitit janë shfaqur viroza të cilat janë trajtuar si në individ, po ashtu edhe kur rastet kanë qenë kolektive. Gadishmëria dhe dispozicioni i mjekëve ka qenë shumë i kënaqshëm dhe korrekt.

Është bërë në mënyrë korrekte vaksinimi i rezidentëve sipas kalendarit të vaksinimit, si dhe kontrollet rutine përsa i përket planifikimit nga ana e infermieres në lidhje me kontaktimin me mjekët përkatës.

3. Realizime në sektorin financiar.

Gjatë 2024 nga Bashkia na është akorduar një fond prej 16,202,000 lekë, i ndarë sipas zërave të mëposhtëm:

Zërat	Plani vjetor 2024	Fakt 8-mujor -2024
600	17,606	8,587
601	2,806	1440
602	4,655	2224
231	2,000	40
Totali	27,067	12,291

KRYETAR

Ermal Dredha

